

# Islam i dhe kriza e identitetit

Nexhat S. Ibrahimini





▲ ▲ ▲ ▲ ▲ ▲ ▲ ▲ ▲

©LOGOS-A  
2 0 0 3  
  
S H K U P  
P R I S H T I N È  
T I R A N È

Copyrighted material



▲ Nexhat S. Ibrahim

▲  
▲  
▲  
▲  
▲  
**Islam dhe  
kriza e identitetit**



St gërla të drejtat janë të rezervuar.  
Ky libri mund të kusojet përcaktikisht për përdorim personal dhe jo-fitimprurës.  
Kjo paraplyqet përfshin prononcencë të librit apo edhe përfshirje e  
kulturës së lesinës së përgjithësë. Për publikujet rreptarët,  
transmetuesit apo këqijëni i kësij librit pa luju paraprakohet Sht Logos-A



**Nexhat S. Ibrahim**

**Islam i dhe  
kriza e identitetit**



Nexhat S. Ibrahim  
ISLAMI DHE KRIZA E IDENTITETIT

Boton: Logos-A  
Biblioteka: Mendimi Islam

Për botimin: Adnan Ismaili  
Kryeredaktor: Husamedin Abazi  
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim

Redaktor gjithëse: Rexhep Zllati  
Redaktor artistik & Disenjator: Edi Agajishi  
Redaktor teknik: Sedat Ramadani  
Faqsi: Naser Ferri

Mbikëqyrës i shtypit: Imer Gojufi  
Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup  
Shtypi: Focus - Prishtinë

Copyright © Logos-A, 2003

Shënim i CIP katalogut i këtij libri gjendet  
në Bibliotekën Kombëtare Universitare  
ISBN 9989-58-089-8

[www.logos-a.com](http://www.logos-a.com)



# Përbajtja:

<u>Përbajtja:</u> .....	1
<u>Besimi në një Zot përjashton çdo politeizëm .....</u>	4
<u>Përmasat e besimit .....</u>	9
<u>Kuptimi islam i realitetit .....</u>	14
<u>Kriza morale e njeriut dhe edukata islame.....</u>	23
<u>Hyrje.....</u>	23
<u>Burimet themelore të edukimit islam: Kur'ani dhe Hadithi.....</u>	25
<u>Disa nga faktorët e edukimit të drejtë.....</u>	27
<u>Pasojat e edukimit jo të drejtë.....</u>	29
<u>Përfundim.....</u>	34
<u>Fuqia si vlerë dhe virtyt moral dhe domosdoshmëri e ekzistimit.....</u>	35
<u>Feja dhe shekullarizmi në shoqëri .....</u>	42
<u>Feja dhe shoqëria në vite.....</u>	50
<u>Drejt një konceptimi real të historisë islame .....</u>	56
<u>Hyrje.....</u>	56
<u>Islami – feja më 'e vjetër' dhe më 'e re'.....</u>	57
<u>Arabët gjatë historisë.....</u>	58
<u>Vëzhgime stereotipe jobesnike.....</u>	59
<u>Zonat gjuhësore dhe kulturore të botës muslimane .....</u>	60
<u>Ardhmëria e islamit dhe e Evropës.....</u>	62
<u>Historia islame dhe perspektiva .....</u>	63
<u>Obsesioni evropian ndaj osmanëve .....</u>	65
<u>Religjioni, shpirterorja dhe shëndeti mendor .....</u>	75
<u>Eutanazia – vdekje e mëshirshme .....</u>	82
<u>Hyrje.....</u>	82

<b>Eutanazia në rrjedhën e historisë .....</b>	<b>83</b>
<b>Përkuqizimi kuptimor i ‘eutanazisë’.....</b>	<b>87</b>
<b>Legalizimi e eutanazisë në botë .....</b>	<b>89</b>
<b>Akceset e zgjidhjes së problemit të eutanazisë.....</b>	<b>94</b>
<b>Eutanazia dhe ligji .....</b>	<b>97</b>
<b>Pikëpamjet teologjike mbi eutanazinë .....</b>	<b>99</b>
a. Kristianizmi .....	99
b. Budizmi .....	100
c. Islami.....	101
c. Shekullarizmi .....	106
<b>Zhvillimi i medicinës dhe ndikimi i saj.....</b>	<b>107</b>
<b>Pikëpamja sociologjike mbi eutanazinë.....</b>	<b>108</b>
<b>Argumentet për dhe kundër eutanazisë .....</b>	<b>109</b>
<b>Përfundim.....</b>	<b>111</b>
<b>Filozofia islam – pro et contra.....</b>	<b>112</b>
<b>Për artin islam - Skicë -.....</b>	<b>117</b>
<b>Hyrje.....</b>	<b>117</b>
<b>Vendi i artit në islam.....</b>	<b>118</b>
<b>Koncepti i lirisë dhe i artit .....</b>	<b>120</b>
<b>Karakteristikat themelore të artit islam .....</b>	<b>121</b>
<b>Raporti ndërmjet artit, filozofisë dhe misticizmit.....</b>	<b>122</b>
<b>Alegoria si manifestim i mendimit abstrakt.....</b>	<b>123</b>
<b>Tri shkallë të filozofisë .....</b>	<b>124</b>
<b>Vetëtahuajësimi .....</b>	<b>125</b>
<b>Njeriu në raport me Zotin.....</b>	<b>125</b>
<b>Përmasat.....</b>	<b>126</b>
<b>Ndikimi i artit islam .....</b>	<b>127</b>
<b>Përmbyllje .....</b>	<b>127</b>
<b>Kthimi në burimet – si të kuptohet selefizmi!?</b>	<b>128</b>
<b>Libri islam dhe perspektiva e tij.....</b>	<b>132</b>
<b>Hyrje.....</b>	<b>132</b>
<b>Libri në burimet islamë.....</b>	<b>134</b>
<b>Libri gjatë historisë islamë.....</b>	<b>135</b>
<b>Faktorët që ndikuan në indiferentizmin e muslimanëve ndaj librit</b>	<b>137</b>

<b>Perspektiva e librit ndër ne .....</b>	<b>138</b>
<b>Përfundim.....</b>	<b>141</b>
<b>Mësimi islam në shkollat laike, në mektebe dhe në mediume .....</b>	<b>142</b>
<b>Hyrje.....</b>	<b>142</b>
<b>    Mësimi islam në shkolla - plan-programi i mësim-besimit dhe i kulturës së religjioneve .....</b>	<b>142</b>
<b>        a. Zvogëlimi i vëllimit të plan-programit mësimor të mësim-besimit.....</b>	<b>143</b>
<b>        b. Motivimi i zhvillimit më të madh të intelektit dhe kultivimi i origjinalitetit te nxënësi .....</b>	<b>144</b>
<b>        c. Për ligjëruesit e mësim-besimit .....</b>	<b>145</b>
<b>        c. Kontradiktat rreth futjes së lëndës “mësim-besimi” nëpër shkolla?! .....</b>	<b>145</b>
<b>        d. Përbajtja e lëndës së “mësim-besimit”.....</b>	<b>146</b>
<b>    Mësimi islam në mektebe.....</b>	<b>146</b>
<b>        a. Mësimi i praktikës së jetës islame dhe domosdoshmëria e themelimit të institutit pëdagogjik të Bashkësisë Islamë .....</b>	<b>146</b>
<b>        b. Inicimi i mektebit për të rriturit .....</b>	<b>147</b>
<b>        c. Vendet e veçanta për mësimin e islamit për të rritur .....</b>	<b>148</b>
<b>        c. Kuadri për mësimin e të rriturve.....</b>	<b>148</b>
<b>    Mësimi islam në media .....</b>	<b>149</b>
<b>        a. Mediumet botuese .....</b>	<b>149</b>
<b>        b. Radioja dhe televizioni .....</b>	<b>149</b>
<b>        c. Vebi .....</b>	<b>150</b>
<b>        c. Përbajtja e përhapjes së mësimit islam nëpërmjet mediumeve .....</b>	<b>150</b>
<b>    Fjala përfundimtare .....</b>	<b>151</b>
<b>Literatura .....</b>	<b>152</b>

# Besimi në një Zot përjashton çdo politeizëm

Besimi se All-lahu është Një e Absolut - ﷺ - është parim themelor i mësimit islam, ashtu si i një pjese të religjioneve të tjera. Dëshmia e të qenët të Tij është mbarë gjithësia<sup>1</sup>, njeriu i përkryer<sup>2</sup> dhe vetë statusi i njeriut si zëvendës i All-lahut në Tokë.<sup>3</sup> Në anën tjetër, si qenie dualistike, i përbërë nga materia dhe shpirti, njeriu<sup>4</sup> ka nevojë për ndihmë të vazhdueshme nga Krijuesi<sup>5</sup>, Sunduesi, Furnizuesi i Tij, nga Ai i cili e mban në jetën animale, intelektuale, humane dhe spirituale. Këtë nevojë njeriu e manifeston, ndonëse në mënyra dhe forma të ndryshme, në varësi nga faktorët që e rrëthojnë dhe në varësi nga angazhimi i tij që t'i drejtohet Absolutit Suprem. Gjatë leximit krahasimtar të veprave të ndryshme fetare, hasim lajthitje dhe shtrembërimet e ndryshme për besimin e drejtë te Krijuesi Absolut, të cilin e kërkon ajeti i pakapërcyeshëm dhe bazor për këtë pikëpamje “*Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm nga Ti ndihmë kërkojmë*”.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> “Ne do t'ua tregojmë argumentet tona në horizont si edhe në vetë ata, deri sa t'u bëhet krejt e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt të jetë për çdo send dëshmitar”. Fussilet, 53.

<sup>2</sup> “Ne e kemi krijuar njeriun në formën më të bukur”. Et-Tin, 4.

<sup>3</sup> “...Unë në tokë po caktoj një mëkëmbës ...”. El-Bekaretu, 30.

<sup>4</sup> “... Ai me të vërtetë është i padrejtë dhe injorant”. El-Ahzab, 72

<sup>5</sup> Shih ajetin kur'anor. “*Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm nga Ti ndihmë kërkojmë*”. Gjerësishët lexo komentin: Husein Dozo, *Prijevod Kur'ana s komentarom*, I, Sarajevë, 1966, fq. 12.

<sup>6</sup> El-Fatihi, 5.

Mirëpo, për ta kryer me sukses dhe drejt detyrën e zëvendësit të Zotit në tokë dhe përgjegjësinë e këtij misioni të rëndë e të vështirë<sup>7</sup>, njeriut i nevojitet, krahas vetëdijes mbi llogarinë përfundimtare, edhe përforcimi moral dhe freskimi i kohëpaskohshëm shpirtëror. Islami e ka hetuar këtë nevojë ndaj ka përcaktuar mënyrë të veçantë të freskimit me anë të lidhjes së përditshme shpirtërore (namazi dhe format e tjera të adhurimit dhe të lutjeve) me burimin e Gjithëmundshëm të të gjitha fuqive - All-llahun. Kjo mënyrë është *ibadeti* nëpërmjet të të cilit njeriu i ripërtrin forcat e veta, e përforcon besimin në sukses, sepse ka bindjen se Ai e ndihmon atë.<sup>8</sup>

Gjatë këtij komunikimi të të mundshmit (njeriut) me të Domosdoshmin, Absolutin (All-llahun) gjatë historisë krijoen raporte që do të mund të përkufizoheshin në tri mënyrat vijuese:

“Uniteti i Qenies absolute”

“Uniteti i respektit të Qenies absolute”

“Uniteti i atributeve të Qenies absolute”.

Dy parimet e para i miraton dhe me to pajtohet thuajse në tërsi, edhe islami. Në këtë pikëpamje islami nuk dallon në asgjë nga religionet e tjera. Mirëpo, dallimi ndërmjet islamit dhe religjoneve të tjera konsiston në parimin unikal, që e ka vetëm islami, e ky është “uniteti i atributeve të Qenies absolute”. Nëpërmjet këtij parimi, d.m.th. nëpërmjet atributeve që afirmohen në këtë

---

Kushejrin dhe Huxhviri sentencën *Ijake na'budu'* e kuptojnë si *Ligj*, kurse sentencën ‘*we ijake neste'in*’ e kuptojnë si *realitet hyjnor*. (Gjerësisht sipas: Anemarie Schimmel, *Odgonetanje Božijih znakova - Fenomenoloski pristup islamu*, Sarajevë, 2001, fq.414).

<sup>7</sup> “Ne u kemi dhënë obligim qiejre, tokës dhe malere, por ato refuzuan të pranojnë këtë se u frikësuan, kurse njeriu e mori mbi vete. Ai me të vërtetë është i pa drejtë dhe injorant”. El-Alzab, 72).

<sup>8</sup> Gjerësisht: Husein Đozo, *Prijedor Kur'ana s komentarom*, I, op. cit., fq. 11 - 12.

Krhs.: Al-lameh Es-Sejid Muhammed Husejn Et-Tabatabai, *El-Mizanu fi tefsir'il-Kur'an*, I, botimi III, 1393 h./1973, pa vend botimi, fq. 15-27.

parim, All-lahu e manifeston veten dhe këto atribute i përkasin vetëm e vetëm Atij. Këtë parim hyjnor (atributet) me Të nuk e ndan askush. Pjesëmarrja e kujtdo tjetër në këto atribute do të thotë rrënim, shkatërrim i Unititetit të Tij.<sup>9</sup>

Në religionet popullore, filozofike dhe në judeo-kristianizëm<sup>10</sup>, “uniteti i Qenies absolute”, pastaj “uniteti i respektit të Qenies absolute” dhe “uniteti i atributeve të Qenies absolute” ka qenë i ndarë. Për këtë arsy, në besimin e tyre hasim Zotin suprem dhe perënditë e vendit, perënditë me kompetencia të pjesërishme në Tokë dhe në hapësirë, pastaj njerëzit shpirtëror, ndërmjetësuesit dhe njerëzit me ndikim, të cilët respektohen si edhe Zoti suprem<sup>11</sup>. Mosuniteti i këtyre tre komponentëve qenësorë në të besuarit korrekt të Zotit rezultoi lindjen e institucionit privilegjues të “klerit”, përkatësisht të institucionit “të priftërisë”, lindjen e instituciuonit privilegjues, institucionit ndërmjetësues ndërmjet masës, nga një anë, dhe klerikëve, në anën tjetër.<sup>12</sup> Kësaj dukurie nuk i shpëtoi as muslimanizmi, që mund të vërehet lehtë nga e kaluara dhe nga aktualiteti ynë. Kur’ani e luftoi ashpër këtë gjendje, i zhduku të gjitha paragjykimet dhe proklamoj se njeriu është ai që i drejtohet drejtpërdrejt

---

<sup>9</sup> “Sikur me Tokën dbe qiejt të drejtonin zotat tjere, e jo All-labu, ata do të shkatërrohen ...” (El-Enbija, 22).

Shih: Husein Eshfak, *Suština islamia – Komentar Fatibe*, botimi II, Sarajevë, 1986, fq. 59. Krhs.: Rešid Hafizović, *Teoloski traktati – O načelima islamske vjere*, Sarajevë, 1996, fq. 9 – 26; Adnan Silajdić, *Filozofska teologija Abu al-Hasana al-As'arija*, Sarajevë, 1999.

<sup>10</sup> Vuko Pavičević, *Sociologija religije sa elementima filozofije religije*, botimi II, Beograd, 1980; Čedomil Veljacić, *Razmedja azijskih filozofija*, I-II, Zagreb, 1978.

<sup>11</sup> Gjendja e periudhës së ashtuquajtur “paraislamike” (asr’ul-xhahilijeh) e dëshmon më së miri këtë, por një gjendje e ngjashme ka mbretëruar edhe në nënkontinentin e Indisë, Persisë së vjetër, Greqisë së vjetër.

<sup>12</sup> Husein Eshfak, op. cit., fq. 60.

Nerkez Smailagić, *Klasična kultura islama*, I, Zagreb, 1973, fq. 34.

All-llahut absolut<sup>13</sup>, seështë në kundërshtim të ashpër me “unitetin e Qenies së Zotit” dhe në kundërshtim me mëshirën hyjnore t’i drejtohem i për ndihmë e t’i lutemi dikujt tjetër përveç All-llahut, Një të vetmit.<sup>14</sup> Raporti i vetë njeriut dhe i Zotit, që del nga atributet e Tij, e që është “*Zoti krijon, vigilon dhe mbron*”, është raport i drejt-përdrejtshmërisë së mirëfilltë. Së këndejmi, në konceptimin e tillë konsekuent monoteist, ndërmjetësuesit nuk janë të domosdoshëm, qofshin ata engjëjt apo njerëzit,<sup>15</sup> sepse “*kur në shpirtin tonë ta mësojmë dashurinë dhe kujdesin e All-llahut, mëshirën e Tij si edhe drejtësinë, ky është rezultat i drejtpërdrejtë i asaj se me aktin e adhurimit i përulemi dhe e kuptojmë edhe gabimin tonë edhe suqinë gjithëpërfshirëse të Tij.*<sup>16</sup>

Në jetën e individëve ka periudha të krizave shpirtërore dhe materiale, periudha kur të gjitha burimet e optimizmit dhe të suksesit shteren, kur njeriu ndihet i paaftë, i shkretë, kur nuk ka ligj ku të mbështetet dhe të kërkojë ndihmë, ndihmë që të dalë nga labirinti i tij.<sup>17</sup> Në këtë gjendje njeriu u drejtohet instinktivisht forcave të tjera, alternative, perëndive, engjëjve dhe shenjtërise për ndih-

<sup>13</sup> Ibid., fq. 61.

<sup>14</sup> Ibid., fq. 21.

<sup>15</sup> Ibid., fq. 36.

Kurse M. Abdulhu, në lidhje me këtë çështje, thotë: “*Të gjithë ata që shpresojnë në ndihmën e të vdekurve dbe mendojnë se me ndërmjetësimin e të vdekurit do të përmbushet dëshira e tyre ose ndonjë punë do t’ju shkojë mbarë, do të lajthitet nga rruga e vërtetë dhe nuk besojnë në një Zot*”. Muhammed Abduhu, *El-Kur’ani'l-hakim*, libri III, Sarajevë, 1932, fq. 55.

Mufesiri i njohur islam S. Kutub këtë çështje e shpreh kështu: “*Udhëkryqi ndërmjet çlirimt absolut nga çdo lloj robërimi dbe ndërmjet robërimit absolut të njeriut paralajmëron krijimin e çlirimt të plotë, të tërësishëm, njerëzor, çlirimt nga robërimi i iluzioneve, çlirimt nga robërimi i sistemeve, nga robërimi i gjendjeve*”. Shih: Sayyid Qutb, *U okrili Kur'ana* (Fi dhilal'il-Kur'an), 1, Sarajevë, 1996, fq. 19.

<sup>16</sup> *The Glorious Kur'an*, Translation and Comentary by Abdull-lah Jusuf Ali, Libya, 1393 h./1937, pp. 14, poshtëshënim 21.

Krhs.: *Tefsir Ibn Kesir*, Botim i shkurtuar, Zgjodhi versionet më të drejta M. N. er-Rifai, Sarajevë, 1420 h./2000, fq. 32.

<sup>17</sup> *Religioni, shpirtërorja dbe shëndeti mental*, kaptinë e këtij libri.

më. Gjatë këtyre veprimeve njeriu nuk e fut në veprim cilësinë, përmasën e tij hyjnore<sup>18</sup>, por ndjek epshet, përmasën e tij animale<sup>19</sup> dhe fundoset në mëkatet e tij<sup>20</sup>, e përcmon vetveten dhe e shkatërron “*unitetin e Qenies absolute*”.<sup>21</sup>

Mund të përfundojmë se njeriu, si qenie e pamjaftueshme, e varur dhe e nevojshme për Drejtues Absolut, të Drejtë dhe të Përherëshëm, përmbrush nëpërmjet ibadetit, mangësinë thelbësore të natyrës së vet, jo vetëm formalisht, nëpërmjet ‘pesë sharteve’, por me angazhim të plotë në të gjitha fushat e jetës, gjithnjë duke e pasur parasysh fuqinë e All-llahut:

“*All-llahu. Me rullnetin e tij, ju ka nënshtuar detin në mënyrë që nëpër të të lundrojnë lundrat, të mundeni të kërkonimirësitë e tij. Ndoshja jeni mirënjobës. Dhe ju ka nështruar çka ka në qiej dhe në tokë. E tëra është prej tij. Në këtë ka argumen-te për njerëzit që mendojnë*”. (El-Xhathijetu, 12-13).

---

<sup>18</sup> “... dhe i kam dhënë edhe shpirt (... min ruhi ...)”. El-Hixhr, 29.

<sup>19</sup> “... ata janë sikur kafshët ...” (... ulaike ke'l-en'a-mi...). El-A'raf, 179.

<sup>20</sup> “*Pastaj e shtyjmë në fund të fundit*” (Thume reded-nahu esfele safilin). Et-Tin, 5; “... Ata janë si kafshët, madje edhe më të humbur ...” (Bel hum edal-lu). (El-A'raf, 179).

<sup>21</sup> M. Abduhu thotë se ‘*Njeriu në çdo punë duhet t'i përdorë të gjitha mjetet e lejuara dbe ta vëré téré fuqinë dbe mundësinë e tij, por nëse kjo e kalon fuqinë e njeriut, duhet që këtë punë t'ia besojë të Gjithëfuqishmit dbe nga Ai të kërkojë ndihmë sepse All-llahu i madhëruar është Shkaku i Parë dbe krijues i çdo gjëje*’. M. Abduhu, op. cit., fq. 55.

## Përmasat e besimit

Çështja e ‘besimit’ (el-iman) nuk ka pushuar të jetë aktuale, frysmezuese dhe instruktive edhe në kohën tonë. Muhammed El-Gazaliu, dijetar i madh egjiptian nga shekulli XX, duke shkruar për çështjen e ‘besimit’ në stilin e krijuesve të njohur, pohon:

*“Nuk them dicka të re në këtë fushë, por unë zbras në logjikën e provave, për të perfituar nga vërtetësia e ngjarjeve të ndryshme të historisë islamë dhe me qëllimin e vetëm për të ecur sipas udhëzimit në rrugën e drejtë, të shprehur në tekstet e Kur'anit e të hadithere të Muhammedit s.a.v.s.”<sup>22</sup>*

Mirëpo, gjatë trajtimit, te ne por edhe në botën muslimane, kjo temë nuk arrin të ngrihet, t'i kapërcejë skemat tradicionale të sunizmit apo të mu'tezilizmit dhe të vendosë relacione të mirëfillta në konceptimin dhe në perceptimin e *Qenies së Zotit* (dhat'ull-ll-lah). Kjo manifestohet sidomos në ngatërrimin e “të vërtetave shkencore” në horizontet religjioze, në gjykimin e *jashtëshkencores* me *shkencoren*, që manifeston pasqyrën e plotë të apo logjetikës islamë si teologji e vdekur, që nuk ndjek ritmin dhe rrjedhat e jetës.

E megjithatë, disa dijetarë, me akribi të veçantë, arritën të dëshmojnë se sistemet ekzistuese të koncepte-

---

<sup>22</sup> Shejh Muhammed el-Gazali, *Besimi i muslimanit* (Akidet'ul-muslimi), Shkup, 1421 / 2001, fq. 7.

ve teologjike nuk kanë më vlerë për ata me formim intelektual tjetërfare.

Shkencës bashkëkohore duhet t'i afrohemë me plot respekt, por të mëvetësishëm, duke mos rënë nën ndikimin e racizmit scientistik, duke mos dështuar logjikisht me shqyrtimin e ateizmit, siç ndodh shpesh me shumë autorë, kur dihet se ateizmi është i vonshëm, ndërsa feja është paraekzistenciale dhe metahistorike.

Në shumë vepra, kur flitet për ajetet kur'anore mbi Zotin, nuk harrohet të theksohet tërthorazi se ato theksojnë *dijen negative* për Zotin, sepse dija në domen të ontikes nuk miraton kurrfarë metode eksperimentale, apo përvoje pozitive, empirike, që e sendërton mendja pozitiviste, gjë që paraqet paradoks logjik.

Dija negative mbi Zotin është me karakter transhendental, kurse atributet janë negacion i transhendencës absolute, që përndryshe do ta reduktonte në plan të abstraktësisë së pastër (siç është rasti edhe me Absoluten e Hegelit).

Në shumë vepra mbi çështjen e besimit ndarja ndërmjet Qenies dhe atributeve nuk ekziston. Ndarja duket e tillë vetëm në rrafshin teorik. Qenia është unike në vete, kurse në dukjen e jashtme manifestohet në shumësi formash ekzistenciale. Ky unitet nuk ka ndodhur sipas parimit të Engelsit të *negacionit të negacionit*, as sipas parimit të dialektikës *si evolucion linear*, por si sintezë e gjithëkuptimit, e të gjitha mundësive që nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, por korrespondojnë në një harmoni dhe krijojnë gjithëkuptimin e pashtershëm të mundësive të pafundme. Kjo përjetohet vetëm kognitivisht, por nuk dëshmohet dhe nuk argumentohet kurrsesi me dëshmi rationale: ontologjike, gnoseologjike, teleologjike dhe kozmologjike. Zoti i dëshmuar është Zoti i krijuar, i personalifikuar (kristian dhe filozofik). Ai, në të vërtetë, nuk

është Zot, ose është Zot në minus, Zoti në përfytyrimin negativ njerëzor, e jo Zot në dijen negative mbi Të, që krijon cilësitë e mendimit pozitiv në mendje.

*“Dëshmitë mbi ekzistimin e Zotit ngaherë në tërësinë e vet janë dokument madhështor. Por, nëse dëshmitë mbi ekzistimin shkencor të Zotit janë dëshmi obligative në kuptim të matematikës ose të shkencave empirike, atëherë ato janë të gabueshme. Zoti i deshmuar nuk është Zot, por do të ishte vetëm një nga gjësendet në botë. Dëshmitë e ashtuquajtura për ekzistimin e Zotit burimisht nuk janë dëshmi fare, por rrugë të vetëdijesimit ideor. Dëshmitë për ekzistimin e Zotit, që me mijëra vjet janë trilluar dhe përsëritur në variante të ndryshme, në të vërtetë kanë karakter tjeter nga dëshmitë shkencore. Ato janë dëshmim ideor i përjetimit të ngjitjes së njeriut drejt Zotit”*<sup>23</sup>.

Çështje tjeter me rëndësi që përshkohen në veprat mbi çështjen e ‘besimit’ është karakteri i fesë (ed-din) dhe i besimit (el-iman). Feja, sipas natyrës së saj *autentike*, është mbinatyrore, sepse është dhuratë e Zotit, kurse sipas natyrës së saj *tokësore* është natyrore, sepse është profanizuar nëpërmjet ligjësive kozmike dhe në poret e të gjitha llojeve të jetës së njeriut. Domeni i saj është i shtrirë në dy rrafshe dhe njëkohësisht shtrihet në kozmos dhe në metakozmos, në rrafshin qiellor dhe tokësor.

Polet fare të dallueshme të fesë janë Zoti dhe njeriu, kurse midis tyre janë bota engjëllore (angjeologjike), shtazore (animale), bimore (vegjetative) dhe minerale, me çka mbaron vertikalja ekzistenciale e rendit zbritës – dëftues në domenin përbajtësor të nocionit *fe*.

Në rrafshin horizontal të fesë, ku nuk mbizotëron vetëm diktati i simpatisë hyjnore ndaj botëve... po kaq është i pranishëm edhe ritmi i *përgjigjes* njerëzore në pro-

---

<sup>23</sup> Karl Jaspers, *Filozofija egzistencije*, Beograd, 1973, fq. 153 – 154.

vokimin e fesë të dhuruar nga Zoti, ritëm të cilin e profilizon gjeniu shpirtëror i njeriut.

*Besimi* si gjendja më e lartë e mëshirës hyjnore dhe parathemeli teomorf i natyrës së njeriut, i rehatuar në zemrën njerëzore si tempull i Frymës së Zotit dhe në shpirtin e njeriut si në teatrin shpirtëror të Vullnetit ndodhues hyjnor, është plotësia dhe mbarimi i përkryer i vertikales së Frymës shpirtërore brenda vertikales së natyrës njerëzore.

Natyrën themelore të vertikales së frymës hyjnore e njohim në cilësinë e nocionit *Sophia perenis* (el-hikmetu el-ladunijetu), ndërsa natyrën themelore të vertikales së shpirtit të njeriut e njohim në cilësinë e nocionit *Religio perenis* (ed-din ed-daim).<sup>24</sup>

*Sophia perenis* shënon rrënjen qellore të fesë (imanit) kurse *religio perenis* shënon vendosjen tokësore të fesë (imanit).

Islami është tradita tokësore e Mesazhit, ruhi i saj historik, leximi i saj metalogjik në diskursin logjik tokësor, aktualizimi etik brenda teatrit natyror të njerëzisë së njeriut dhe njëmendësimi estetik brenda portretimit të gjithëmbarshëm historik të atij synimi themelor të fesë si të tillë “*që njeriu të mitet deri te masa (fotografia) e Frymës hyjnore*”.

*Imani* është intuitë qellore e natyrës burimore njerëzore, kurse *islami* është institucion i tij historik. *Imani* është *feligj* (el-hakikatu) sipas Frymës hyjnore, kurse *islami* është *feligj* (esh-sheri'atu) sipas natyrës makrokozmike dhe mikrokozmike.

*Imani* si veprim shënon nxjerrjen e frymës (ruh) sonë *jashtë* dhe portretimin e gjeniut tonë të brendshëm të besimit në pëlburën e njëmendësisë sonë të përdit-

---

<sup>24</sup> Gjerësisht mbi ‘*Sophia perenis*’ dhe ‘*Religio perenis*’ shih: Nevad Kahteran, *Perenjalna filozofija (Sophia Perenis)*, Sarajevë, 2002, fq. 5-37 dhe 291-307.

shme jetësore. Mirëpo, kjo mund të arrihet vetëm me angazhimin dhe fuqinë tonë mendore të kapërcimit tonë metafizik, por po kaq edhe me fuqinë e virtytit tonë të njëmendtë në fushën e *feligjit* (el-islam) dhe të *religionit praktik* (ed-din), gjithnjë me urtësinë e besimit, praktika amshuese e mendimit (hadith) dhe mendimi i praktikës (suna) të të cilave janë dhënë përgjithnjë në përsosmërinë shpirtërore dhe morale të personalitetit të Pejgamberit a.s. dhe në jetën e tij të virtytshme prej besimtarit dhe pejgamberit.

## Kuptimi islam i realitetit

Çdo *homo sapiens*<sup>25</sup> në botën fenomenale do ta shtrojë pyetjen se çka e përbën realitetin; çdo *homo sapiens* në botën fenomenale, jeton *me/pa* vetëdije, me konceptimin vetjak se çka e përbën tërësinë e ekzistencës. Ky kontemplim dhe konceptim i realitetit përcakton në masë të madhe raportin e njeriut ndaj kozmosit, konceptin e njeriut për qëllimin e ekzistencës dhe rolin e paracaktuar të njeriut në këtë botë. A është kozmosi fizik – ai që e shohim, e prekim, e masim apo e vrojtojmë me aftësitë njerëzore apo me aparaturë – çdo gjë që ekziston dhe a ekziston edhe diçka më tepër? Prej nga ka ardhur njeriu dhe ku do të shkojë prej këtu? A është e gjitha rezultat i rastit dhe i kotësisë, apo është pjesë e planit dhe e sistemit të gjithëdijshëm dhe të gjithëqëllimshëm.<sup>26</sup> A ekziston diçka që administron çdo gjë? Cili është në vetvete realiteti përfundimtar? Sa të gjera janë shkaqet dhe kuptimi i fundit i vetë jetës së njeriut? Apo njeriu është vetëm qenie kalimtare që do të marrë fund si çdo gjë

---

<sup>25</sup> *El-Insan’ul-akil* (Njeriu që ka mend, njeriu i arsyeshëm), në: Xhemil Saliba, *El-Mu’xhem’ul-felsefij*, I, Bejrut, 1414 h./1994, fq. 175.

<sup>26</sup> El-Kur'an:

“Ne nuk e krijuam qiellin, tokën e çdo gjë çka ka në mes tyre shkel e shko (*pa qëllim të caktuar*)”. El-Enbija, 16;

“Dhe i cili përvaktoi e orientoi” El-A’la, 3.

Shih: Susane Haneef, Islamsko vidjenje stvarnosti, Nur – časopis za kulturu i islamske teme, nr. 1/1991, Beograd, fq.26. Krhs.: M. M. Sharif, Historija islamske filozofije, I, Zagreb, 1988, fq. 159-175.

tjetër që jeton? A është kjo jetë jeta e vetme apo pas saj do të vijë ndonjë mënyrë tjetër e ekzistencës? Nëse është ashtu, atëherë çfarë ekzistence është kjo? <sup>27</sup>

Konceptimi i realitetit nga ana e njeriut, përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe pyetjeve të ngjashme, nuk janë më pak të rëndësishme se drejtimi i tij në kozmos, se perceptimi i vendit dhe i rolit që duhet ta luajë në të. Në këto postulate zë fill tërë konceptimi: çka është qenia njerëzore dhe çka synon të jetë. Në to është e njësuar lidhja e karakterit të qenies së vet me botën që e rrethon dhe, mbi të gjitha, me Krijuesin.<sup>28</sup>

Edhe sot shumë njerëz pyesin: a ekziston për njëmend Dikush atje apo jo? Nëse ekziston, sa është kjo e rëndësishme? Këto pyetje kanë pasqyruar tëhuajësimin më të plotë të njeriut nga vetvetja, nga Burimi i vet dhe, për rrjedhojë, nga totaliteti i botës dhe i njerëzisë. Mjedis i orientuar, i teknologizuar i botës perëndimore i ka mësuar shumë njerëz të mos besojnë në atë që cilësohet si ‘mbinatyrore’ madje edhe kur këta njerëz deklarohen si besimtarë. Shkenca, si një prej hyjnive më të mëdha të njeriut të sotëm, na mëson se e vërtetë është vetëm ajo që mund të shihet, të vërehet, të matet apo të ndihet me anë të shqisave, të aftësive mendore ose të shpikjeve të njeriut.<sup>29</sup> Për këtë shkak shumë njerëz në Perëndim kur nuk janë të aftë ta mohojnë tërësisht diçka që momentalisht nuk janë në gjendje ta absorbojnë, sillen sikur kjo edhe nuk ekziston. Tërë këtë e injorojnë, e herë-herë, edhe pse pranojnë në heshtje se diçka ekziston, sipas

---

<sup>27</sup> Për aspektet e ndryshme të besimit (metafizik, moral, akaidologjik, historik shih studimin tejet interesant dhe kontemplativ: R. Hafizović, *O načelima islamske vjere*, Zenicë, 1996.

<sup>28</sup> Susane Haneef, op. cit., fq.26. Krhs.: Abu-Hamid Muhammed Al-Gazali, *Znamenja u All-lahovim stvorenjima*, Sarajevë, 2001, fq. 7-118.

<sup>29</sup> Ismet Ozel, Tri çështjet: *Shkenca, teknika dhe tëhuajësimi*, Shkup, 1998.

tyre kjo është e parëndësishme për rendin e përgjithshëm të gjërave.<sup>30</sup>

Shumë njerëz deklarojnë se ‘besojnë’ në Zotin, por kjo shpesh është besim statik, bindje e thatë se Zoti ekziston, për të mos thënë se Ai nuk ekziston, që nuk rezulton kurrfarë pasojash praktike dhe nuk ndikon në asnje mënyrë në sistemin e jetës së tyre vetjake. Ka të tjerë që besojnë fuqimisht në të ‘mbinatyrshmen’. Mirëpo, besimi i tyre nuk është i plotë, i denjë dhe është kryesisht i kushtëzuar me supozime. Rregullësia dhe vlefshmëria e këtij besimi nuk mund të varet në asnje rast nga fakti që ai zë fill në përvojën subjektive të dikujt, dhe nuk mund të pranohet si premisë serioze në konceptimin korrekt të realitetit sipëror të ekzistencës, veçan të Zotit, si pikëqendër dhe burim të këtij realiteti, as për konstituimin e udhëzimit të vlefshëm për sendërtimin e jetës njerëzore.<sup>31</sup> Preokupimi aktual me fenomene eks-trasenzore do të mund të ecë në hap me pranimin e realitetit, i cili e ngadhënjen kozmosin, por ai përbëhet në masë të madhe prej spekulimeve dhe tentimit që fenomenet materiale t'u nënshtronhen analizave shkencore të cilat, në fund, për shkak të natyrës së studimit material, e eliminojnë vetveten. Në këtë mënyrë nuk mund të merren kurrsesi përgjigjet e pyetjeve mbi natyrën dhe atributet e Zotit, madje as të ekzistencës së Tij.<sup>32</sup> Ekziston mundësi e madhe që me këtë kundërshti shpirtërore të vendoset lidhja me shejtinan dhe se ai i nxit për këtë. Së këndejmi, këto shfaqje janë baza mjaft të pasigurta dhe të rrezikshme për besim dhe për jetesë dhe nuk kanë lidhje me përvojat shpirtërore të lidhura me Zotin.

---

<sup>30</sup> Muhammed el-Gazali, *Besimi musliman*, Shkup, 2001.

<sup>31</sup> Resid Hafizović, op. cit., fq. 49-55.

<sup>32</sup> Martin Lings, op. cit., fq. 67-68.

Islami merret në mënyrë fare të qartë dhe haptazi, me të gjitha këto probleme. Në realitet, vetë islami i shtron të gjitha pyetjet e cekura dhe kërkon që secili që ka arsyen të gjejë përgjigje përkatëse për to, përgjigje që janë të lidhura me shfaqjet e dukshme në kozmos dhe me arsyen.<sup>33</sup>

Islami proklamon se ekziston fushë e jetës që nuk është e kapshme për shqisat e njeriut, as për vetëdijen njerëzore dhe nuk është e përcaktuar as me kufijt e intelektit njerëzor. Kjo botë, që është jashtë fushëveprimit të percepcionit njerëzor, quhet *el-gajb*, që do të thotë: “ajo që është e fshehtë”, apo “ajo që nuk shihet”, kurse ajo që është e njohur dhe që mund të shihet quhet “esh-shehadeh”, “ajo që është e dukshme”, apo “ajo që është e qartë”. Në islam besimi në ekzistencën e asaj që nuk shihet është parakusht për besimin në Zotin dhe për të kuptuarit e Zotit dhe të asaj pjese të realitetit të Zotit të cilën shqisat dhe aftësitë njerëzore nuk mund t'i kuptojnë, por të cilat janë me rëndësi themelore për ekzistencën e njeriut. Në kapitullin mbi konsituencat e fesë kemi aktualizuar problemin e këtyre botëve të padukshme.<sup>34</sup>

Islami pohon se ajo që është e dukshme dhe e kapshme për aftësitë e njeriut, esh-shehadeh, është vetëm një pjesë, ndoshta pjesa e vogël dhe e parëndësishme e asaj që ekziston. Ndonëse njeriu nuk mund ta kapë tërësinë e ekzistencës, kjo nuk e mohon në asnjë mënyrë realitetin e asaj që ai nuk është i aftë ta kuptojë - ashtu siç nuk mund ta determinojë një buburrec ose një elefant tërësinë e asaj që ekziston në bazë të përvojave të veta të kufizuara dhe aftësive të percibilitetit. Shumica jonë e pranojnë me dhembje faktin se njeriu është tërë-

<sup>33</sup> Mahmud Ebu'l-Fajd El-Menufi, *Filosofija islama*, Sarajevë, 1983, fq. 45-74.

<sup>34</sup> Muhammed Ikbal, *Obnova vjerske misli u islamu*, botimi II i plotësuar dhe i ndryshuar, Sarajevë, 2000, fq. 85-117.

sisht qenie përfundimtare dhe e kufizuar, me aftësi dhe arsyë që kanë mundësi të njohin dhe të kuptojnë vetëm në suaza të caktuara dhe asgjë më shumë. Kurse kjo ‘më shumë’ është ai realiteti më i gjerë, ai totalitet i cili është i njohur vetëm për Krijuesin e tij. Për ekzistencën e këtij realiteti më të gjerë, ndonëse është e pamundur të perceptohet drejtpërdrejt, ekzistojnë një varg dëshmish për ne të njohura. Ndër to është edhe vetë gjithësia fizike, që ofron shumë dëshmi mbi fuqinë, urtësinë e paimagjinueshme dhe mbi forcën krijuese të Zotit. Qenia njerëzore është edhe një shembull i qartë. Ajo vjen prej diku nga hiçi në ekzistencë dhe, kur vdes, kuptohet se pjesa më vitale e saj fiket. Në virtytet shpirtërore dhe në sakrifiki-met e tij njeriu synon drejt më të thellës dhe më të lartës se fusha materiale, tek parandien ekzistencën e botës jomateriale me rëndësi më të madhe, me të cilën qenia njerëzore është e lidhur në një mënyrë të panjohur aq afërsisht – sa injorimi dhe refuzimi i saj patjetër do të manifestohet negativisht në individin dhe në shoqërinë në të cilën jeton.<sup>35</sup> Ndjenjat religjioze, mënyrat e manifestimit të tyre dhe lëvizjet e përbashkëta me të gjitha qeniet njerëzore kanë forma dhe karakteristika të ngjashme. Sidomos religionet e mëdha monoteiste – judaizmi, kristianizmi, islami - manifestojnë ngjashmëri mjaft të qarta, duke dëshmuar kështu prejardhjen e përbashkët nga Burimi i njëjtë, nga Zoti i Lartësuar.<sup>36</sup> Dhe, më në fund, fenomenet e shumta ekstrasenzore, ndër të cilat mund t’i përmendim ëndrrat dhe parandjenjat lidhur me ndodhitë e ardhshme dhe shumë tregues të tjerë ekspressive të ekzistencës së botës jomateriale na ofrojnë pikëmbështetje për Njëmendësinë e Padukshme.

---

<sup>35</sup> Muhammed Ikbal, op. cit., 119 e tutje.

<sup>36</sup> Susane Haneef, op. cit., fq. 27.

Në islam Zoti është pika qendrore e këtij realiteti. Ai në të vërtetë është ky realitet: Zoti është i vetmi që mund të bijë çdo gjë, Krijues dhe Mbajtës i së krijuarës, Furnizues i së krijuarës me atë që nevojitet për të ekzistuar. Është ai që ndan natën dhe ditën, Ai që krijon çka dëshiron në mitrën e nënës, Ai që ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe bën që, me ndihmën e shiut nga qelli dhe ushqimit nga toka, të rritet ajo që është ushqim për njerëzit dhe kafshët. Është ai që ua vë kufijtë e jetës kriesave të Veta ashtu si mendon ai se duhet. Është Ai që do t'i nxjerrë në shesh nga varret trupat e njerëzve dhe do t'i bashkojë me shpirrat e tyre atë Ditë të tmerrshme, për të cilën nuk ka kurrfarë dyshimi, kur bota të arrijë në fund. Është ai që do t'ju gjykojë sipas kritereve më të përsosura dhe më të drejta të drejtësisë dhe të mëshirës. Ai është më i madhi. Është ai të cilit nuk mund t'i rezistohet. Ai di çdo gjë. Ai është më i mençuri. Është ai Që askujt nuk i përgjigjet, por të cilit të gjithë i japin llogari. Ai bën ç'dëshiron me kriesat e veta dhe para Tij çdo gjë përulet. Ai është njëkohësisht i mëshirshëm dhe mëshirëplotë, Ai që dashuron dhe që fal.<sup>37</sup>

Ky është konceptimi islam i realitetit. Atë e ndjekin muslimanët anekënd botës. Perceptimi i tillë formon që nga ditët e para të fëmijërisë një pjesë mjaft të rëndësi- shme të vetëdijes së besimtarit.<sup>38</sup> Besimtari rritet me vetëdijen për ekzistencën e Zotit dhe për fuqinë, bujarinë dhe mirësinë e Tij ndaj kriesave të Tij, i vetëdijshëm se kjo jetë është vetëm një pjesë mjaft e vogël e ekzistencës dhe se intelektin e tij njerëzor nuk mund ta kuptojë

---

<sup>37</sup> Shih qëndrimet e Imam Maturidiut rrëthi Zotit në besimin islam: Imam El-Maturidi, Jeta, vepra dhe mësimi, Prishtinë, 2003, fq. 43-93. Abu-Hamid Muhammed Al-Gazali, op. cit., fq. 115-118.

<sup>38</sup> “Çdo fëmijë lindet në fe të pastër, natyrore, kurse prindërit e edukojnë në hebraizëm, kristianizëm apo në zoroastrizëm”. Sipas: Jakup Memić, Izbor poslanikovih hadisa, Sarajevë, 1985, hadithi nr. 1193, fq. 276.

madje as pjesëza e tij më e vogël.<sup>39</sup> Krahas kësaj është e pranishme edhe njohja sejeta nuk është pikëpamje përfundimtare e jetës së njeriut. Sepse ka ekzistuar koha kur, sipas fjalëve kur'anore, “*Vërtet ka kaluar një periudhë kohore, që njeriu nuk ekzistonte fare si një diçka i përmendur*” (76,1). Zoti e nxori nga joekzistenca në ekzistencë, ... dhe që këtu ai shkon në botën tjetër, që do të bëhet gjendja përfundimtare e të gjithë njerëzve. Në këtë jetë ata që kanë pranuar Zotin për krijues të Tij, të cilët e kanë ndjekur udhëzimin e Tij dhe janë përpjekur që Ai të jetë i kënaqur me ta – do ta gëzojnë lumturinë dhe bekimin e amshueshëm çfarë intelekti njerëzor as nuk mund ta imagjinojë. Kurse ata që e kanë refuzuar dhe kanë kërkuar hyjni të tjera, duke refuzuar Udhëzimin e Tij dhe duke jetuar për këto hyjni, apo për kënaqësitë dhe epshet e veta, do të përjetojnë tmerrin e agonisë dhe të vuajtjes në përputhje me gjendjen e shpirtrave të tyre.<sup>40</sup>

Islami proklamon po ashtu se natyra njerëzore ka realitetin njerëzor. Derisa filozofitë dhe teoritë e ndryshme perëndimore e trajtojnë njeriun si një makinë të përkryer, qenie që reagon mekanikisht, sikur është “programuar” me emocionet, mjedisin ose me proceset e veta biokimike, apo, anasjelltas, si lloj më të lartë shtazor, pikëpamja islame e njeriut është plotësisht tjetër dhe trajtimet e tilla materialiste konsiderohen koncepte krejtësisht të gabuara për natyrën e mirëfilltë të njeriut, sepse në islam njeriu është kriesë unikale e Zotit,<sup>41</sup> që posedon fenomenalitetin e qartë të jashtëm: trupin fizik dhe pjesën e fshehtë, të brendshme të vetes: intelektin, emo-

<sup>39</sup> “Urdbërojini fëmijët tuaj të falin namazin kur t'i mbushin shtatë vjet. (Nëse nuk dëgjojnë) ndëshkojini dhe detyrojini kur t'i mbushin dhjetë vjet ...”. Sipas: Jakup Memiç, nr. i hadithit 1487, op. cit., 334.

<sup>40</sup> Susane Haneef, op. cit., fq. 28.

<sup>41</sup> “Unë po krijoj në tokë një zëvendës”. El-Bekare,30.

cionet dhe shpirtin. Njësia e natyrës së njeriut qëndron në faktin se ai është dhruar me lirinë e zgjedhjes<sup>42</sup> dhe të vendosjes ndërmjet të drejtës dhe të gabuarës, me aftësinë e persiatjes,<sup>43</sup> ndjekjes së diturisë, të ndjenjave dhe të veprimit, që, të gjitha këto, nuk u janë dhënë krijesave të tjera, dhe me shpirtin e pavdekshëm, që vazhdon të jetojë pas vdekjes së trupit fizik. Njeriu është, sipas kësaj, sistem i shumë aspekteve, niveleve dhe funksioneve, gjithëpërfshtirja e të cilit është vetë realiteti i natyrës së njeriut.

Në islam mësojmë se Zoti e ka krijuar njeriun me një natyrë shumëfish të ndërlikuar në mënyrë që nuk mund të shpërthejë konflikt ose përçarje ndër sistemet e ndryshme, por të gjitha ato janë harmonizuar, me synim sipëror, në një tërësi funksionuese harmonike. Të jesh njeri, vetveti është obligim i madh dhe provokim kulmor. Çdo element i natyrës njerëzore ka rol me të cilin konfirmohen dhe ligjshmëritë me të cilat sendërtohen nevojat dhe të drejtat kongenitale në plotësimin e tyre. Që në mes tyre të arrihet harmonia të cilën ua destinon Zoti, njeriu do të sakrifikojë fuqinë e vullnetit vetjak dhe do të sundojë me të gjitha elementet e veta sipas ligjeve të cilat Zoti, i ka vendosur për të mirën e tij. Kështu, ai i mban tok brenda personalitetit të tij, duke sendërtuar sintezën dhe tërësinë e tyre të plotë. Ky është shkaku që islami nuk e ndan tërësinë jetësore në sakrale dhe profane, nuk merret vetëm me gjërat ‘religjioze’ dhe ‘shpirtërore’, por me të gjitha aspektet e jetës së njeriut, në kuptim të porosisë kur'anore “O Krijuesi ynë, na jep në

---

<sup>42</sup> “E ti thuaj: E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë le të besojë, kush të dojë le të mohojë”. El-Kehf, 29.

<sup>43</sup> “Në këto ka argumete për një popull që sheh”. En-Nahl; 11;  
“Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kur'anin)”. En-Nahl, 44.

*këtë botë të mirën dhe në botën tjeter të mirën*". Çdo pjesë është në suaza të religionit në kuptimin islam të këtij nocioni dhe njeriu merret si tërësi e pandashme, organike, në pajtim me realitetin e natyrës së tij unikale njerëzore. Perceptimi korrekt i natyrës së mirëfilltë njerëzore dhe i vendit të njeriut në rendin e përgjithshëm të gjërave (sunet'ull-ll-lah) ka, pra, rëndësi mjaft të madhe në islam. Me ndihmën e udhëzimit të Zotit, të përcjellë me anë të pejgamberit, njeriut i është dëftuar se si realiteti i natyrës së tij harmonizohet në realitetin absolut.<sup>44</sup> Ai është në dijeni për ç'pritet prej tij në aspekt të këtij realiteti, epiqendra e të cilit është Zoti i lartësuar. Në këtë mënyrë do të ketë mundësi të jetojë në harmoni dhe në baraspeshë e jo në konflikt dhe kaos gjatë udhëzimit të tij të shkurtër nga një fazë e këtij realiteti të kësaj jete tokësore, në fazën vijuese, në jetën e amshueshme të Botës tjeter. Kështu do t'i sendërtojë vlerat dhe sukseset e vërteta në këtë dhe në botën e ardhshme.<sup>45</sup>

---

<sup>44</sup> Namazi, agjërimi, zekati, haxhi, urdhri për të mirë dhe ndalimi i së keqes e të tjera janë rrugët e harmonizimit të botës humane me absolutin.

<sup>45</sup> Susane Haneef, op. cit., fq. 28.

# Kriza morale e njeriut dhe edukata islame

## Hyrje

Tëhuajësimi dhe izolimi i njeriut, filozofia e absurdit, pakuptimësia, degjenerimi dhe pesimizmi janë karakteristika tipike të shoqërisë bashkëkohore dhe paralajmërimë serioze për krizën shpirtërore dhe morale të njeriut bashkëkohor.<sup>46</sup> Këta tregues simptomatikë të krizës morale dhe të apatisë spirituale të botës bashkëkohore janë të pranishëm dhe imanentë në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore: në art, teatër, film, letërsi, politikë, ekonomi, shkencë ... E. From ka pohuar se ‘*përkundër përpianimit material, lirisë politike dhe seksuale, bota e mesit të shekullit XX është mendësisht më e sëmurë se në shekullin XIX*’.<sup>47</sup>

Po tani që e kemi kaluar shekullin XX dhe kemi shkelur në shekullin XXI, prej nga pakuptimësia, pesimizmi, anarkia morale që krijon vetëm breza të zhgënjyer, të zvetënuar, të kompleksuar, që rrënojnë individin dhe shoqërinë?<sup>48</sup> Statistikat pohojnë se Suedia, Japo-

---

<sup>46</sup> Punimi nuk pretendon të trajtojë hollësitë, as të përgjigjet në çështje fiklore, por synon vetëm t'i fokusojë disa probleme lidhur me këtë temë që meriton trajtim serioz si në cilësi ashtu edhe në vëllim.

<sup>47</sup> Sipas: Hasan Spahić, *Islamski odgoj i moralna kriza savremenog čovjeka*, në: Grup autorësh, *Dubovnost i mentalno zdravlje*, Sarajevë, 2002, fq. 228.

<sup>48</sup> Shih: Sayid Mujtaba Rukni Musawi Lari, *Islam i zapadna civilizacija*, Sarajevë, 1998, fq. 8-10.

nia, ShBA-të dhe shtetet e tjera perëndimore me standard dhe progres materialo-teknik më të lartë, por edhe me shfrenim dhe rënie shpirtërore morale më të lartë, janë vendet me përqindje më të lartë të suiciditetit (vetëvrasjeve).<sup>49</sup>

Kjo gjendje buron nga ndikimi i pseudo-ideologjive dhe i pseudo-lirive që po ofrohen dhe infiltrohen në thellësinë e shpirtit të njeriut dhe që shpien shpesh në dehumanizimin e personalitetit, humbjen e vlerave etike, mungesën e kritereve normale për vlerësim objektiv të njëmendësisë etj.

Nga ana tjetër, tëhuajësimi i njeriut nga vetvetja, tëhuajësimi nga vlerat e veta burimore, tëhuajësimi nga Zoti e të tjera, e privojnë njeriun nga baraspesha shpirtërore dhe mundësia e perceptimit dhe e qëndrimit korrekt të lirisë autentike vetjake.

Mohimi dhe përjashtimi i Zotit ngajeta individuale dhe shoqërore do ta shpie doemos bartësin e këtij mohimi dhe përjashtimi në kundërshti, në absurd dhe në pakuptimësi, sepse qenia njerëzore, edhe pa dëshirën e saj,

---

<sup>49</sup> Bindjet religioze, pastaj traditat religioze dhe tiparet socio-kulturore kanë ndikim edhe në pengimin e shpeshtësisë së suiciditetit, d.m.th. ndikojnë në ndryshimin e shkallës dhe në seriozitetin e mortalitetit suicidal. Këtë e dëshmon shkalla e lartë e suiciditetit, pastaj e perverzioneve dhe të degjenerimeve të tjera në vendet e zhvilluara industriale në Evropë, Japoni dhe SHBA. Krahaso: Alija Izetbegoviq, *Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*, Prizren, 1992. Dragos Kalajic, *Smak sveta*, Beograd, 1979.

“Sipas të dhënave policore nga viti 1976, në Gjermaninë Perëndimore kanë ndodhur 10.000 vetëvrasje, mbi 6000 meshkuj dhe 7000 femra kanë tentuar vetëvrasje pa sukses, sipas: Sayid Mujtaba Rukni Musawi Lari, *Islam i zëpadna civilizacjia*, Sarajevë, 1998, fq. 36.

Në “The Spirit of Man” faqe 32 lexojmë: “Në çdo 25 minuta në Amerikë ndodh ndonjë krim i madh, kurse në çdo 24 minuta ndodh vrasje me paramëdim, pesë sulme mbi pasurinë, 30 sulme të mëdha dhe 3000 vjedhje më të vogla. Sipas: Sayid Mujtaba Rukni Musawi Lari, op. cit., fq. 36.

natyrisht, e kërkon Krijuesin e saj, Zotin. Prandaj, për edukimin si proces të formimit të personalitetit të njeriut me të gjitha cilësitë fizike, intelektuale, estetike dhe të punës me synim të përgatitet të shërbejë për të mirën e shoqërisë dhe të vetvetes, ka kuptim të flitet vetëm nga aspekti i fesë. Edukimi s'është veçse kategoria në të cilën manifestohet baraspesha e materiales dhe e shpirtërores te njeriu dhe rrëth njeriut, në të cilën zë fill stabiliteti i individit, i familjes, i bashkësisë e edhe civilizimit dhe në të cilën liria njerëzore nuk është sprovë, por dhuratë e Zosit. Natyrisht, ky s'është qëndrim materialist, që shfyturon personalitetin e të edukuarit duke e përjashtuar nga qenia e tij bivalente komponentin e tij shpirtëror, por nga aspekti shpirtëror, i fesë, i cili, duke e marrë në konsideratë tërësinë e qenies njerëzore dhe prejardhjen e tij që bazohet në Fjalën e Zosit, zhvillon dhe kultivon te njeriu i ri pikërisht vlerat të cilat ai i bart si shenjë fillestare të Krijuesit të tij.<sup>50</sup>

## **Burimet themelore të edukimit islam: Kur'ani dhe Hadithi**

Kur'ani dhe Hadithi janë dy burimet themelore për edukimin e njeriut. Prej tyre mësojnë parimet, metodat dhe mjetet themelore të edukimit dhe funksionin edukativ si një ndër kategoritë thelbësore të shoqërisë njerëzore, kategoritë mbi të cilat zë fill stabiliteti dhe ekzistenca e një bashkësie.

---

<sup>50</sup> Shih observime të shkëlqyeshme për këto aspekte te: Alija Izetbegoviq, op. cit.

Çdo fëmijë me lindjen e tij priret nga besimi i drejtë. Është detyrë e edukatorit që me veprimin edukues ta shpie njeriun në jetë, në pastërtinë e vet natyrore<sup>51</sup>, në rrugën e virtuteve, të nderit dhe të përkryerjes natyrore, në të cilën na udhëzon Kur'ani dhe hadithi.

All-llahu i madhëruar thotë:

*“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lënda djegëse e të cilat janë njerëzit dhe gurët. ...”* (Et-Tahrim. 6).<sup>52</sup>

Kushti i parë që fëmija të fitojë një edukatë të mirë është shtëpia prindërore. Në të lind, fiton përvojat e para, bindjet, shprehitë e mirësjelljes, të cilat shndërrohen shkallë-shkallë në nevoja të tij mendore dhe fizike dhe përbëjnë bazamentin e personalitetit të tij të ardhshëm.

Në hadithet e Muhammedit a.s. gjejmë udhëzime të hollësishme se si duhet të jetë familja muslimane. Edukimi i muslimanit duhet të jetë mbi bazën fetare, ku do të përfshihen devotshmëria, sinqeriteti ndaj All-llahut, ruajtja nga mëkatet dhe sendërtimi i detyrimeve fetare. Madje, edukimi është edhe kriter për përzgjedhjen e të fejuarve<sup>53</sup>, që nëpërmjet anëtarëve të ndershëm, besnikë dhe

---

<sup>51</sup> “Kul-lu mevludin juledu ale'l-fitreti. Fe ebevalu juhevidanibi ev junessiranibi ev jumexhxisanibi”, që në përkthim do të thotë: “Çdo fëmijë lind në fenë e pastër, natyrore, e prindërit pastaj e edukojnë si hebraik, kristian apo zjarradburues”. (Jakup Memiç, *Izbor poslanikovih hadisa*, numri i hadithit 1193, Sarajevë, 1985, fq. 276).

<sup>52</sup> Ibn Abbasi, njëri prej komentuesve më kompetentë të Kur'anit lidhur me këtë ajet pohon: “Bëhuni të dëgjueshëm ndaj All-llahut të madhëruar, ruajuni dhe kini kujdes që të mos i thyeni rregullat e Tij. drejtojeni anëtarët tuaj në Kur'an, që All-llahu t'ju ruajë nga zjarri”. Shih: *El-Kur'an'ul-kerim ve bibamishihi Tenvir'ul-mikbasi min tefsiri ibn Abbasi* nga Ebu Tahir Muhammed ibn Ja'kub El-Fejruz Abadi Esh-Shafi'i, botimi I, Bejrut, Lubnan, 1409 h./1988, fq. 560-561.

Krhs.: *Prijevod Kur'ana sa tefsirom i komentarom na bosanskom jeziku*, Munchen, botimi I, 2001, vëllimi V, fq. 2461.

<sup>53</sup> Muhammedi a.s. ka thënë: “Femrën e martojnë katër gjera: pasuria, prejardhja, bukuria dhe feja e vërtetë. Përpiku të marrësh atë që ka fe – do t'i kesh të gjitha”. (Nga

përparimtarë të ndërtojë familje, bashkësi dhe shoqëri të shëndoshë. Për këtë qëllim Muhammedi a.s. i urdhëron prindërit t'i mësojnë fëmijët e tyre me besim, shkrim-lexim, not, kalërim, shkathtësi luftarake dhe përdorimin e armëve dhe t'i ushqejnë me ushqim hallall. Kur'ani kërkon që fëmija të mëndet (të mëkohet) dy vjet, sepse qumështi i nënës është i pazëvendësueshëm. Muhammedi a.s. thotë:

*“Atij që ushqehet 40 ditë me ushqim hallall, All-lahu ia ndriçon zemrën me dritë dhe e bën burim të urtësisë në mendim dhe në vepra”*<sup>54</sup>.

## Disa nga faktorët e edukimit të drejtë

Faktin se dija, urtësia, dashuria dhe butësia linden nga ushqimi hallall El-Gazaliu, dijetari i njojur musliman e shpjegon si vijon:

---

Ebu Hurejreh, Sahihu i Buhariut dhe Muslimit ... sipas: *Tejsir’ul-mesiri ila ehadithi’l-Xhami’is-sagiri* i përgatitur prej Salih Indžić, numri i hadithit 685, Travnik, 2001, fq. 238.

Muhammedi a.s., po ashtu ka thënë: “*Mos i merrni femrat për hir të bukurisë, sepse bukuria mund t'i shkatërrojë, mos i merrni për hir të pasurisë, sepse pasuria mund t'i bëjë të shfrenuara. Merrini ato për shkak të devotshmërisë, sepse, kështu do të keni bashkëshorte të edukuara mirë e të besueshme*”.

Gjerësisht shih për këtë temë: Hasan Çengiq, *Temat islame*, Shkup, 1413/1993, fq. 145 - 157; Ibrahim Amini, *Etika bashkëshortore*, Tetovë, 2000.

<sup>54</sup> Sipas: Hasan Spahić, *op. cit.*, fq. 230.

Xh. Rrumi pohon:

*“Ushqimi është farë, fryti i së cilës është mendimi,  
Cfarë fare është mbjellë i tillë do t'i mugullojë edhe fryti,  
Nëse mbillet farë haram, habet ushqimi haram,  
Mendimet e fëmijës së tillë do të jenë të dëmshme, të pasinqerta, të pandershme,  
Nëse hanë ushqimin hallall, do të ketë mendime të pastra.”.*  
(Sipas: Hasan Spahić, *op. cit.*, fq. 230).

*“Ushqimi ballall e pastron zemrën, e ndriçon dhe e aftëson për pranimin e njohjes: çdo gjë tjeterë është e parlerë në krahësim me edukimin islam. Çdo gjë që ka në këtë botë njeriut mund t’ia marrë djalli, t’ia rrëmbejë zjarri, t’ia vjedh vjedhësi, por edukimi i mirë dhe dituria është pasuri e amshueshme që na mbijeton në këtë botë, e sipas saj përcaktohet fati i përhershëm në botën tjeter”<sup>55</sup>.*

Rol të veçantë në edukim ka shembulli vetjak i prindërve. Fëmijët miratojnë thuajse çdo gjë që e shohin te prindërit apo te mjedisi me të cilin komunikojnë. Muhammedi a.s., duke i këshilluar prindërit, ka thënë:

*“Prindi nuk mund t’i lërë trashëgim më të mirë, më të qmueshëm dhe më të vlefshëm fëmijës së tij se edukimi i mirë”.*

*“Kush ka vajzë dhe e edukon, e ushqen dhe e shpenzon në mënyrën më të mirë për të pasurinë që i ka dhënë All-llahu, ajo për të do të jetë krah i djathtë dhe i majtë ndaj zjarrit drejt xhennetit”.*

*“Fëmija është fryt i zemrës, një nga lulet aromatike të xhennetit”<sup>56</sup>.*

Omeri r. a., halif tejet racional dhe largpamës në veprime, reagoi ashpër ndaj një prindi që iu ankua se i biri ishte i padëgjueshëm ndaj tij, duke e fajësuar prindin se nuk i ka plotësuar obligimet kundrejt fëmijës. Çdo prind është vetë përgjegjës për edukimin e fëmijës dhe asnjë dështim nuk do të mund ta arsyetojë nga mungesa e kohës, nga padija, ngaqë është i zënë me tregti, nga pleqëria, nga rinia.

Obligimi i prindërve për edukimin e mirë të fëmijëve është tredimensional:

1. Obligimi prindëror ndaj fëmijëve për të ardhmen e tyre më të lumtur e më të mirë;

---

<sup>55</sup> Sipas: Hasan Spahić, *op. cit.*, fq. 230.

<sup>56</sup> Tri tekstet e sipërme citohen sipas: Hasan Spahić, *op. cit.*, fq. 230.

2. Obligim prindëror ndaj vettvetes për përgjegjësinë vetjake për pasardhësit e tyre;

3. Obligim prindëror ndaj bashkësisë, sepse fëmijët tanë do të jenë në të ardhmen anëtarë aktivë të bashkësisë shoqërore, krijuar dhe organizatorë të jetës së saj.<sup>57</sup>

Atmosfera në të cilën edukohet fëmija dhe fryma e edukimit duhet t'i shmangen pesimizmit, humorit të errët dhe skajshmërive dhe duhet zhvilluar e kultivuar vlerat dhe virtytet me vlerë të përhershme. Ndërrimi i brezave është faktor me rëndësi për edukimin e drejtë, mungesa e harmonizimit të tyre shpeshherë thellon jazin çorientimin dhe lajthitet e rinisë. Prandaj zhvillimi i ndjenjës së përgjegjësisë është me rëndësi esenciale për brezin e ri. Vorbullat e jetës që do t'i shfaqen në formë të ndryshme një të riu (nëpërmjet sportit, modës, muzikës, mediumeve të shkruara dhe elektronike, teatrit, programeve shkollore laike dhe antitradicionale, literaturës në përgjithësi dhe shumë formave të tjera), nuk do ta befasojnë atë. Njeriu i ri do të jetë i armatosur me kundërarmët përkatëse dhe efikase – moralin e tij të fuqishëm kur'anor-sunetik, islam.

## Pasojet e edukimit jo të drejtë

Të gjitha rreziqet që i shfaqen njeriut në jetë kanë kryesisht një emërtues, e ky është epshi, instinkti i shfrenuar, degjenerimi moral. Nëse ai e infekton individin, do të infektohet tërë bashkësia. Për këtë arsy, edukimi duhet orientuar para së gjithash drejt zotërimit të epsheve. Epshi duhet t'i nënshtrohet arsyses, e kjo do të bëhet

---

<sup>57</sup> Shih: Hasan Spahić, *op. cit.*, fq. 231.

nëse njeriu ndjek udhëzimin e All-llahut. Nëse epshi i shmanget arsyes, ai do të bëhet i vrazhdë, mizor, do ta humbë baraspeshën e vlerave njerëzore dhe do ta degradojë njeriun<sup>58</sup>. Jemi dëshmitarë të realitetit se mbisundimi i epsheve shpie në mëkate, e krime të shumta. Në këtë rrafsh avancon prostitucioni dhe kurvëria me të gjitha pasojat e tyre mbi individin, familjen, bashkësinë dhe shoqërinë.<sup>59</sup>

All-llahu i lartësuar thotë:

*“Dhe mos iu afro ni imoralitetit (zinasë), sepse vërtet ai është repër e shëmtuar dhe një rrugë shumë e keqe”.* (El-Isra’, 32).

Për t’i parë në mënyrë sa më ilustrative pasojat e mosbatimit të këtij ajeti kur'anor do ta përkthejmë një citat të autorit të madh bosnjak, Munir Gavrankapetanoviq, i cili tërë jetën ua kushtoi idealeve të islamit:

*“Sikur varret e shumta të flisnin për të keqen e kurvërisë dhe përi sëmundjet që u sollën vdekjen zuzarëve, do të shkruhej një histori dëshpëruese për tragedinë e shumë njerëzve të rinj të cilët kanë mundur të kenë jetë të lumtur po të mos vepronin këto të këqija. Kjo histori do të ishte një akuzë dhe gjykim i rëndë i kurvërisë si një ndër mëkatet dhe të këqijat më të rënda të gjinisë njerëzore. Sikur të mund të dëgjoheshin në një vend pshëritim i klithmat e atyre që kanë vuajtur fizikisht dhe shpirtësht nga dhembjet dhe tmerret që ua kanë shkaktuar sida, sifilizi, gonorea dhe sëmundjet tjera veneriane, do të ishte kjo pshëritima e të përvuajturë që e provokuan vetë fatkeqësinë e vet. Sikur fëmijët e pafajshëm, të verbuar nga gonoreja, apo fëmijët të gjykuar me*

<sup>58</sup> “...Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, ...” El-A'raf, 179)

<sup>59</sup> Industrializimi i egër i Evropës dhe i nevojave të saj të ‘pangopura’ ndikuan që familja ta humbë rolin e vet në bashkësi. L. Tolstoj, shkrimitari i madh rus, këtë krizë e përshtkuani: “Një nga shkaqet kryesore të shkallës së lartë të shkurorëzimeve është liria e femrës të vendosë për shkurorëzim, duke e pasur parasysh natyrën e saj të ndjeshme dhie eksplozive ...”, Sipas: Sayid Mujtaba Rukni Musawi Lari, op. cit., fq. 54.

*idekje nga virusi HIV pozitiv nga nënati e infektuara, apo fëmijët me sëmundje të rendë dhe të degjenuar nga sifilizi, të mund tangrinë zërin, do të ishte ky zë i akuzave të tmerrshme, oshëtimi e të cilave do të jehonte në horizontet kozmike. Po të mund të pyeteshin fëmijët e mbytur në mënyrën më të ll-llahtarshme, të zhdukur pa mëshirë në barget e nënave përsë me këta të pafajshëm është vepruar aq irazhdë, do të tronditej çdo zemër dhe shpirt njerëzor... ”<sup>60</sup>*

Nëse pyesim përfatim e fëmijëve të lindur nga marrëdhëniet seksuale jashtëligjore / jashtëmartesore, përgjigjen do ta gjejmë lehtë në realitetin e hidhur, te fëmijët që u gjenden pa fajin e tyre në vorbullën e marrëzive të të rriturve, në absurdin e filozofisë moderniste dhe pasmoderniste perëndimore të aktualitetit tonë, në moton: seks i lirë, dashuri paramartesore, institucioni i familjes institucion i demoduar e të tjera, duke bëdhen rrugëve, apo duke u vendosur në shtëpitë përfshi edukim, nëpër burgje, pa kujdes dhe pa ardhmëri, duke kërkuar kuptimin e jetës në veprimet e tyre kriminale.

Përfatë arsyen, besimi dhe kurvëria nuk mund të jenë të pranishme njëkohësisht te njeriu.

Muhammedi a.s. e ka përkufizuar qartë gjendjen e kurvërisë me hadithet vijuese:

*“Kurvari sa kohë bën kurvëri nuk është besimtar”<sup>61</sup>*

*“Ruajuni nga kurvëria, sepse kurvëria sjell katër pakënaqësi: shmang bukurinë dhe dritën nga fytyra, pengon dhe ndërpren faktin, nxit urrejtjen e të Mëshirshmit dhe është shkaktare e vuajtjes së përbershme në zjarrin e xhehenemit”<sup>62</sup>*

---

<sup>60</sup> Sipas: Hasan Spahic, *op. cit.*, fq. 233.

<sup>61</sup> “Kush jepet pas kurvërisë (dhe vazhdon me këmbëngulje) i ngjan idhujtarit”. (El-Mukimu ale’z-zina ke abidi vethenin), sipas: Jakup Memic, *op. cit.*, numri i hadithit 1496, fq. 336.

<sup>62</sup> Sipas Taberaniut, nga Ibn Abbasi, Jakup Memic, *op. cit.*, numri i hadithit 596, fq. 133.

*“Kur All-llahu dëshiron ta shkatërrojë një vend, lejon të shfaqet kurvëria dhe imoraliteti në atë vend”.*<sup>63</sup>

*“Kur të përhapet kurvëria, do të shumëzohet numri i robërve”.*

“Kurrë nuk është shfaqur kurvëria te një popull e të mos janë shfaqur sëmundjet nga të cilat stërgjyshërit e tyre kanë vuajtur”.

*“Kur të paraqitet homoseksualiteti All-llahu ia priyon mëshirën atij populli. Dhe nuk është me rëndësi se çfarë fatkeqësie do të pësojë”.*

*“Lezbeizmi është prostitucion”.*<sup>64</sup>

Këto hadithe domosdo të shtien në mendime përgjendjen tonë të paraluftës dhe të pasluftës. SIDA / AIDS-i, sëmundje e importuar nga Amerika, po përhapet me të madhe edhe te ne, pikërisht për shkak të amoralit dhe shfrenimit të shoqërisë. Kjo gjendje të largon nga mëshira e Zotit dhe të çon në fatkeqësi dhe pësim.

Anarkia morale dhe prostitucioni në veçanti e rrënon plotësisht natyrën e njeriut, personalitetin e tij dhe shoqërinë. Shtetet me pseudo-liri seksuale kanë probleme të mëdha me moshën e pjekur që nuk e ruan martesën dhe me rininë që nuk lidh martesë. Shtetet me zhvillim të lartë industrial kanë probleme të theksuara me lindshmërinë, d.m.th. me produktivitetin e popullit, por edhe me problemen tjetër se në këto vende impotencia seksuale te të rinjtë është rritur shumë.

---

<sup>63</sup> ‘*Idha erada’ll-Llahu bikarjetin belaken edhbhere fibim’uz-zina*’. Sipas: Jakup Memić, *op. cit.*, numri i hadithit 246, fq. 60.

<sup>64</sup> ‘*Es-Sibaku bejne’n-nisai zinen bejnehune*’ (Taberani), Jakup Memić, *op. cit.*, numri i hadithit 912, fq. 212.

Meqë hadithet janë të njoitura, nuk u përpoqëm t’i sigurojmë burimet e tyre. Hadithet pa shënimë janë cituar sipas: Hasan Spahić, *op. cit.*

Vlen të theksohet edhe çështja terminologjike e ‘lirisë seksuale’, e cila në aspektin fetar, moral, juridik dhe filozofik është e paqëndrueshme! Nuk mund të quhet ‘liri’ diçka që nuk pajtohet me vetë natyrën njerëzore, diçka që u bëhet rob epsheve, pasioneve e instinkteve negative. Kjo ‘liri’ është ‘varësi jomorale dhe shfrenuese’. Njeri plotësisht i lirë është ai që zotëron epshet e veta dhe vepron në pajtim me natyrën dhe rregullat që i ka caktuar Krijuesi i madhëruar:

“*Thuaj: ‘Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshme, le të jenë të hapta apo të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë. ...’*” (El-A’raf, 33).

“*Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më pastër për ta ... Thuaju edhe besimtarëve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përvëç atyre që janë të dukshme ...*”. (En-Nur, 30-31). etj.

Sot në Evroperëndim është përhapur seksi grupor dhe heterogen. Ka humbur çdo ndjenjë e pastërtisë morale. Këta njerëz humbin çdo ndjenjë të besnikërisë martesore dhe të jetës së virtytshme. Për të tillëtjeta martesore pas një kohe bëhet monotone dhe e bezdissħme. Çdo rast i ri i vë ata në sprovë të re, para së cilës lëshojnë pe, duke iu dhënë emocioneve të shfrenuara. Këta nuk mund të lidhin martesë, e nëse lidhin e prishin shumë shpejt, sepse aty nuk qëndron as minimumi i dinjitetit njerëzor.

Po edhe sikur kjo martesë të jetë e qëndrueshme, çfarë edukimi do të ketë fëmija nga këta prindër, si do të zhvillohet në atmosferën e raporteve jonatyrore dhe jo të shëndosha njerëzore, si të ndërtojë dinjitetin e vet kur ky dinjitet shkelet e thyhet në mënyrën më të vrazhdë para syve të tij nga më të dashurit..

## Përfundim

Edukimi islam kërkon nga prindërit që fëmijëve t'ua tregojnë rrugën e Kur'anit dhe të hadithit lidhur me ndërtimin e besimit, të moralit dhe të mirësjelljes në qenien njerëzore dhe me rrugën e ruajtjes nga amoralitë dhe skajshmëritë e tjera. Bota perëndimore me gjithë përparimin e madh material, të parakushteve teknike-teknologjike që njeriu aktual t'i përkushtohet më shumë ndërtimit të tij moral e shpirtëror, ka rënë në krizë morale, në krizë të identitetit të përmasave të mëdha. Kjo lajthitje e madhe fetare dhe morale tregon se njeriu është larg udhëzimit hyjnor, përkatësisht tregon se njeriu anashkalon dhe përbuz udhëzimin hyjnor për procesin e edukimit dhe të formimit të tij.

Kapërcimi i kësaj gjendjeje kërkon që edukimi fetar të kthehet te individi, te familje, në shkolla të të gjitha niveleve dhe në institucionet e tjera. Po ashtu, edukimi nuk nënkupton vetëm mësimin teorik, por edhe aplikimin e tij. Arsimimi dhe edukimi duhet të ecin bashkë me individin dhe bashkësinë. Ngecja e njërit apo e tjetrit segment shpie në ateizëm ose në misticizëm.

*Islami është rrugë e mesme dhe ndjek mesin. Skajshmëritë i dënon dhe i gjykon të pasuksesshme.*

## Fuqia si vlerë dhe virtyt moral dhe domosdoshmëri e ekzistimit

“*Mbill mendim, do të korrësh vepër!  
Mbill vepër, do të korrësh shprebi!  
Mbill shprebi, do të korrësh karakter!  
Mbill karakter, do të korrësh fat!*  
(Samuel Smiles)

Nacioni i ‘fuqisë’, ‘i forcës’ gjatë historisë islame është konceptuar në mënyra të ndryshme. Në fillim nociioni ‘i fuqisë’ nënkuptonte “*aftësinë e njeriut të përbushë synimet që ia ka venë vetvetes ... dbe luftën me forcat e pamoralshme të botës së jashtme, të cilën njeriu mund ta fitojë në bashkëpunim dbe me ndihmën e Zotit*”<sup>65</sup> dhe kishte vend meritor në të gjitha pikëpamjet e jetës muslimane: në pikëpamjen fetare, politike, ekonomike, shkencore. Por, me kalimin e kohës nociioni i ‘fuqisë’ u la në harresë. Konceptimi dhe trajtësimi i vlerave dhe i virtyteve morale bëhej në mënyrë inferiore, të plogët, inerte dhe apatike.

Kemi disa përgjigje përse erdhi kjo gjendje:

---

<sup>65</sup> B. A. Dar, Etička učenja Kur'ana, në: M. M. Sharif, *Historija islamske filozofije*, I-II, Zagreb, 1988, fq. 179.

- Pafuqia reale historike e muslimanëve në botë kanë ndikuar që këta kanë harruar urdhrit moral islam të fuqisë dhe janë pajtuar kështu me pafuqinë e tyre;

- Pafuqia muslimane e shprehur në rraskapitje, inertësi, kotësi, molisje dhe inferioritet, erdhi si pasojë e harrresës së urdhrit moral islam të fuqisë.<sup>66</sup>

## II

Duke mbyllur dyert e ixтиhadit, ulemaja islame filloj të mbyllej në vete, të zbehej dhe të atrofizohej. Kërkesat gjithnjë e më të theksuara intelektuale, materiale dhe shpirtërore të islamit në rritje filluan të trajtoheshin formalisht, në mënyrë shterpe dhe pa studime të thella. Në vend që të merreshin me kërkesat dhe problemet reale, muslimanët filluan të izoloheshin dhe të getoizoheshin në gëzhojën vetjake. Si pasojë e këtij getoizimi, stagnimi dhe atrofizimi të mendimit islam, kemi shtrembërimet e mëdha në besim (akaid), moral (ahlak), jurisprudencë (fikh), histori (tarih), filozofi (felsefeh), sufizëm (tesawwuf) dhe në dituritë e shkencat e tjera (ulum ed-dunjevijeh).<sup>67</sup>

Kështu, në rrafshin moralo-etik, që në këtë rast na intereson më së shumti, përulësia (nga respekti) shndërrohet në pafuqi, modestia e jetës shndërrohet në varfëri. Si pasojë e këtij botëkuptimi të gabuar kemi mendimin absurd në mesin e muslimanëve se All-llahu e do varfërinë dhe se muslimani i mirë nuk duhet të jetë i pasur. Ky botëkuptim përhapej në shumicën e shtresave muslimane kundërshtim me porositë dhe kërkesat ultimative dhe

<sup>66</sup> Dževad Hodžić, Ka moći kao moralnoj vrijednosti i vrlini, në: *Islamski svijet danas*, Zbornik radova V medjunarodnog islamskog simpozija 1416 / 1995, Zagreb, 1995, fq.79.

<sup>67</sup> Muhammed Ikbal, *Obnova vjerske misli u islamu*, botimi II i zgjeruar dhe i ndryshuar, Sarajevë, 2000.

krejtësisht serioze të haditheve të Muhammedit a.s., të cilat dëshmojnë qartë se varfëria dhe padija janë një realitet me të cilin islami nuk pajtohet:

*“Dituria dhe pasuria e mbulojnë çdo turp, kurse padija dhe varfëria e zbulojnë”*.<sup>68</sup>

*“Varfëria është fare afër mosbesimit”*.<sup>69</sup>

Bindjen e gabuar për pasurinë do ta vërejmë edhe në literaturën etike, e ndër shqiptarët në literaturën e ashtuquajtur ‘të bejtexhinjve’<sup>70</sup>, ku modestisë dhe varfërisë i bëhen lëvdata.

Edhe pse sipas konceptit islam pasuria materiale nuk është burimi më i rëndësishëm i fuqisë, nocioni i varfërisë si ideal moral në etikën islame, sidomos i provinencës sufiste, ndoshta është shembulli më i shkëlqyer i lénies së fuqisë në harresë. Edhe vetë fritja e interesimit për tarikatet apo sektet e ndryshme sufiste shpreh mendësinë e gabuar të muslimanëve kundrejt fuqisë. Njëkohësisht ai manifeston pafuqinë, pasigurinë dhe ngushësinë shoqërore. Kjo gjendje i dha dorë varfërisë.<sup>71</sup>

Duhet theksuar se *pasuria* është një prej cilësive të All-llahut nga 99 cilësitë dhe besimtarët duhet ta arrijnë

---

<sup>68</sup> Ibn Abbasi, në: Jakup Memiç, *Izbor poslanikorib hadisa*, Sarajevë, 1985, fq. 243.

<sup>69</sup> Nga Enesi, te: Jakup Memiç, op. cit., fq. 269.

Arsyetimet se mbështetja e të varférve është vetëm shpirtërore nuk qëndron, sepse ky konceptim është i pranishëm edhe në fushat e tjera të jetës. Hadithet e Muhammedit a.s. dëshmojnë qartë se varfëria është realitet me të cilin islami nuk pajtohet:

*“O Hakim, vërtet kjo pasuri është e këndshme (për sy) dhe e ëmbël (për zemër), andaj kush e merr me bujari do të begatohet, kurse kush e mban me kryelartësi nuk do të begatohet. I atillë do të jetë ai që han e nuk ngihet. Dhe dora e epërme është më e mirë se dora e poshtme”*. Muttefekun alejh, në: Imam En-Neveviu, *Rijad'us-salihin*, botimi II, Shkup, 1418 / 1998, fq. 203.

<sup>70</sup> Shih vargje të ndryshme të këtij karakteri: Hajdar Salihu, *Poezia e bejtexhinjve*, Prishtinë, 1987; Mahmud Hysa, *Alamiada shqiptare*, I-II, Shkup, 2000.

<sup>71</sup> Muhammed El-Behij, *Imani – besimi në All-llahun xb. sb.*, Botimi II, Prizren, 2000/1421, fq. 41-50; Imam El-Maturidiu – Jeta, vepra dhe mësimi, Prishtinë, 2003, fq. 57-58.

këtë cilësi për ta fituar xhennetin. Pse është neglizhuar kjo pikë shumë e rëndësishme mbetet të hulumtohet sociologjikisht, por edhe nga aspektet e tjera.

Shembulli tjetër i harresës së imperativit moral islam të fuqisë gjendet në doktrinën shumë të përhapur të *determinizmit* dhe *fatalizmit* në botën islame, por edhe te shqiptarët. Në këtë mendësi nuk kishte vend për nacionin e ‘fuqisë’.<sup>72</sup>

Në shekullin XIX dhe XX, disa dijetarë muslimanë si Xh. Afganiu, M. Abduhu, M. Ikbali, S. H. Nasri e të tjerë e goditën doktrinën mbi *xheberin* (paracaktimin, predestinimin). Këta pohojnë se kjo doktrinë, e njohur edhe më herët, është futur qëllimi i shfrytëzuesve të popujve muslimanë.<sup>73</sup>

I ngjashëm me nacionin *e fuqisë* është nacioni i *durimit*, i cili në mendësinë e popujve muslimanë është perceptuar, komentuar dhe përjetuar në kundërshtim me parimet aktiviste të islamit, në kuptim të pafuqisë, të pasivitetit, si durim i qetë, si mosreagim ndaj çdo gjëje që i ndodh njeriut, ndonëse durimit Kur'ani dhe hadithi i jatin vend aktiv.<sup>74</sup> Për shkak të perceptimit të gabuar të doktrinës morale aktiviste, muslimanët janë preokupuar më tepër me problemen *çka nuk duhet bërë* se sa *çka duhet bërë*. Madje, edhe imami i madh Ebu Hamid El-Gazaliu parapëlqen *shmangien* e së keqes përparrë *bëries* së të mirës, që është në kundërshtim me parimin e njohur “urdhë-

---

<sup>72</sup> Resid Hafizović, *O načelima islamske vjere*, Zenicë, 1996, fq. 213-238. Shih ajetet kur'anore: VI, 148 dhe XVI, 35.

<sup>73</sup> Kur'ani përgënjeshtron dhe refuzon doktrinën mbi determinizmin absolut si jorealist dhe mendon se njeriu ka fuqi ta brumosë fatin e vet në dritë të së vërtetës së Shpalljes. Shih ajetet kur'anore: VI, 149; II, 38 etj. Shih: B. A. Dar, op. cit., fq. 188-189.

<sup>74</sup> Rreth domethënieve të ‘durimit’ (es-sabr) shih studimin: Jusuf El-Kardavi, *Sabur*, Konjić, 2000, fq. 5-42 dhe 43-131.

resa e së mirës dhe ndalesa e së keqes".<sup>75</sup> Kjo etikë është pasive dhe proklamon ikjen e njeriut nga e keqja, nga problemet, mbylljen në vetvete, në botën e vet psikologjike, e jo luftimin e së keqes.

### III

Nëse shekujt e kaluar janë karakterizuar me letargji, apati shpirtërore dhe morale, shekulli XXI kërkon moral aktivist islam, në të cilin fuqia do të jetë vlerë e rëndësi-shme morale dhe vlerë individuale dhe kolektive morale. Fuqia është cilësi e Zotit: "*Fuqia i përket Zotit, Pejgamberit dhe besimtarëve*". (El-Munafikun, 8).

Në filozofinë e vet, fuqia është bazë e tërë ekzistueses dhe na shpie në perceptimin e vetë qenies. Sipas kësaj filozofie, jeta është synim i pafund për të ekzistuar. Bota nuk na është dhënë e gatshme një herë e përgjithmonë, ajo nuk është diçka që vetëm mund të shihet ose të mësohet nëpërmjet nocioneve, por diçka që edhe vetë njeriu duhet ta ndërtojë dhe ta kryejë me veprim të pandërprerë.<sup>76</sup> Fuqia është e pranishme në çdo send, në çdo qenie. Mirëpo, fuqia te njeriu dallon nga fuqia te qeniet e tjera. Qeniet e tjera janë bashkëpjesëmarrëse në fuqi, me të rrojnë, por nuk e posedojnë atë. Nga ana tjeter, njeriu është i vetëdijshëm për fuqinë e vet, e kupton burimin, strukturën e vet, mund ta ndërrojë dhe

<sup>75</sup> Shih veprën e shkëlqyeshme të Munir Gavrankapetanoviqit me titull: Ismet U. Sehibrahimbegović, *Snagom ujere do savrsentiva duše*, Sarajevë, 1984. Es-Sejid Xhelaluddin El-Amri, *El-Emru bî'l-ma'rûfî ve'n-nehîjî anî'l-munker*, Bejrut, 1404/1984, fq. 350 etj.

<sup>76</sup> Dževad Hodžić, op. cit., fq. 81.

Shih: "O turmë e xhindëve dbe e njerëzve, nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës, depërtoni pra, po nuk mundeni vetëm me ndonjë fuqi të fortë". Err-Rahman, 33.

rritë, mund ta orientojë në caqe të caktuara.<sup>77</sup> Ai e posedon fuqinë dhe me këtë hyn në pozicion të rrezikshëm.<sup>78</sup>

Nëse fuqinë e kundrojme nga këndvështrime të tjera do të shohim se ajo zgjerohet dhe shtohet me zgjerimin dhe shtimin e dijes së njeriut. Me zhvillimin teknik-teknologjik modern fuqia e njeriut rritet në përmasa të pavlerësueshme.

Mirëpo, nëse kjo fuqi e pakufijshme e njeriut i kapërcen kufijt e normales, nëse në zhvillimin e vet shkencor, teknik dhe teknologjik nuk respekton rolin e vet, ajo kërcënët të shndërrohet në pafuqinë e njeriut. Njeriu nga pozicioni i tij i 'halifes' në botë rrezikon të shndërrohet në sundues despot, që e vë në pikëpyetje ekzistencën e tij në Tokë.<sup>79</sup> Si pasojë, në shoqëri kemi forma të ndryshme të dhunës, diktatura të ndryshme, regjime totalitare, shfrytëzuese, shkelëse, vrasëse. Në rrafshin fetar kjo shpjegohet kështu: shtrembërimi nga rruga e drejtë dhe përqafimi i rrugës së shejtanit shpie deri në rrugën e politeizmit.<sup>80</sup>

Për shkak të abuzimeve 'të fuqisë', disa filozofi filluan të abstenojnë nga fuqia, nga politika, sidomos kristianizmi dhe disa botëkuptime brenda sunizmit. Mirëpo, abstenimi nga fuqia ofron mundësi që fuqia të kalojë në duar të gabuara.<sup>81</sup> Ky botëkuptim në Perëndim solli tra-

---

<sup>77</sup> Dževad Hodzić, op. cit., fq. 81.

<sup>78</sup> ‘Ne ua ofruam emanetin qiejre, tokës dhe maleve, e ata nuk deshën ta marrnin përsipër atë dhe u frikësuat prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; vërtet ai i bëri padrejtësi vetes dhe ishte i padijshëm’. El-Alhzab, 72. Shih komentin e këtij ajeti nga Muhammed El-Gazali, *Tematski tefsir Kur’anskib sura*, Sarajevë, 1414/2003, fq. 460.

<sup>79</sup> ‘Ne krijuam shumë nga xhindet dhe njerëzit për xhebenem. Ata kanë zemra që nuk kuptojnë, ata kanë sy që nuk shohin dhe ata kanë veshë që nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillë janë ata të marrët’. (El-A’raf, 179).

<sup>80</sup> ‘Vërtet, ai (shejtani) nuk ka kurrfarë fuqie kundër atyre që besuan dhe që mbështeten te Zoti të tyre. Mbizotërimi i tij është vetëm mbi ata që, për shkak të tij, u bënë idhujtarë’. En-Nahl, 99-100.

<sup>81</sup> Shih: B. A. Dar, op. cit., fq.34-35.

gjedi të mëdha: dy luftëra të mëdha botërore, shumë luftëra lokale dhe dy sisteme totalitare: komunizmin dhe fashizmin.

Edhe në historinë islame në shekujt e fundit qe harruar porosia e hadithit, i theksuar këtu si moto se:

*“Kush nga ju sheh një të keqe - le ta ndryshojë me dorë, e nëse nuk mund ta bëjë këtë – atëherë me gjuhën e tij, e nëse nuk mundet këtë ta bëjë – atëherë me zemrën e tij, porse ky është imani më i dobët”*. (Muslimi)<sup>82</sup>.

Intelektuali i madh El-Mewdudi cek një hadith në të cilin Ebu Bekri r.a. qorton konceptimin abuziv të ajetit 105 të el-Maideh:

*“O besimtarë, kujdesuni për veten; nëse jeni në rrugë të drejtë, nuk do t’ju mashtrojë ai që ka lajthitur”,*

duke thënë:

*“O njerëz, ju silitni për këtë ajet dhe po e komenton i gabisht. Unë e kam dëgjuar Pejgamberin duke thënë: Kur një bashkësi e njerëzve të bëhet indiferente ndaj së keqes, kur shikon të keqen dhe nuk provon ta eliminojë, apo sheh një njeri të padrejtë se si bën padrejtësi dhe nuk provon ta pengojë, Zoti mund t’i dënojë të gjithë për këtë”*.<sup>83</sup>

## IV

Fuqia si raport aktiv ndaj vvetveteve, jetës dhe botës, fuqia si përdorim i dhuratës së Zotit, i lirisë, si mundësi e bashkëpjesëmarrjes në aktivitetin kreativ hyjnor, fuqia si aftësi e trajtësimit të jetës në të mirë, fuqia si aftësi e sigurimit të së Vërtetës, Drejtësisë, të Mirës, Bukurisë dhe vlerave të tjera – paraqet imperativin islam moral.

<sup>82</sup> Cituar sipas: Imam En-Neveviu, *Dyjet hadithe dbe shtoja e Ibni Rexhebit*, Shkup, 1413/1992, fq.80-81.

<sup>83</sup> Cituar sipas: Dževad Hodžić, op. cit., fq. 83-84.

## Feja dhe shekullarizmi në shoqëri

*Shekullarizmi* dhe *shekullarizimi*<sup>84</sup> janë çeshtje të rënda dhe komplekse që ngërthejnë në vete një spektër të tërë problemesh që i përkasin rrafshit individual, shoqëror dhe shtetëror. Ndonëse shekullarizmi përkufizohet si ‘dëshirë për këtë botë dhe botëoren’, duket se, megjithatë, përkufizimi më i mirë i kësaj shprehjeje është *ndarja e politikës nga feja*, përkatesisht themelimi i një sistemi qytetar në bazë të të përsiaturit shekullar<sup>85</sup>, edhe pse edhe ky përkufizim është i mangët dhe i kufizuar. Po ashtu, duhet pa tjetër të thuhet se në shekullarizëm racionalizmi është *masë* dhe *kriter* i veprimit. Po ashtu, *shekullarizmi* nuk është vetëm shprehje politike apo shprehje vetëm ideologjike. Suazat e tij, madje, mbasë e tejkalojnë edhe shprehjen e modernizmit, që është esenca e të përsiaturit, politikës, ekonomisë dhe raportit të botës perëndimore, të shtrira nëpër tërë botën. Sikur, për shembull, kur flitet mbi shekullarizimin e të përsiaturit, e gjatë kësaj nuk mendon se të përsiaturit profan është i ndarë nga religjioni. Në një libër me titull “*Shekullarizimi i të*

<sup>84</sup> Gjerësisht lexo: Syed Muhammed al-Naqib al-Attas, *Implikimet e procesit global të shekullarizmit* (nga vepra: *Islam and Secularism*, Kuala Lumpur, 1978), Takvim 1423-1424/ Kalendar 2003, Prishtinë, 2002, fq. 167-183.

Këtë shkrim mund ta lexoni edhe në: *Novi Mual-lim* – revistë për edukim dhe arsimim, nr. 6 / 2001, Sarajevë.

<sup>85</sup> M. Xh. Larixhani, *Shekullarizam je svetovno razmišljanje*, në: *Nur* – časopis za kulturu i islamske teme, nr. 11/ 1996, Beograd, fq. 35. Për përkufizimet e shekullarizmit shih: S. M. N. al-Attas, op. cit., fq. 24 – 25.

*përsiaturit*", autorë të së cilës janë një grup autorësh (më së shumti italianë), shekullarizmi është ndodhi, për të cilën çdo gjë e ka humbur kuptimin e vet, apo për njeriun çdo gjë është bërë e pakuptimtë. Por, si e kanë komentuar ata këtu një shprehje përgjithësisht të njojur në këtë mënyrë të pakuptueshme?

Zakonisht mendohet se *shekullarizmi* në historinë e njerëzimit është periudha e hyrjes në epokën e arsyes dhe të sendërtimit të progresit dhe të zhvillimit<sup>86</sup> (me këtë domethënje shekullarizmi identifikohet me modernizmin), dhe kjo nuk është përsiatje e keqe dhe jo-korrekte. Njeriu shekullar hulumton vazhdimisht në shkencë dhe dituri, sepse, sipas tij, vetëm shekullarizmi i jep strehim dhe mbrojtje dhe se analiza shkencore është analiza më e madhe, në nivel të dobisë dhe dëmit, që kujdeset për cakun dhe nuk zgjedh cakun, por kujdeset vetëm për mjetet për arritjen e cakut.<sup>87</sup> *Shekullarizmi* është rrjedha e historisë së Perëndimit dhe esenca e shoqërisë së re. Ai ka udhëhequr dhe, pak a shumë, gjithnjë udhëheq tërë botën perëndimore. Togfjalëshin 'pak a shumë', këtu e kemi përdorur ngaqë në zhvillimin intelektual, lirinë dhe zhvillimin e botës aktuale, sidomos gjatë dekadave të fundit, paralelisht me përpjekjen për zbulimin dhe themelimin e 'kuptimit', e pakuptimta gjithnjë e më shumë manifestohet deri në atë masë që, nëse zhvillimi dhe liria kanë qenë ndër idealet njerëzore

---

<sup>86</sup> Disa mendojnë se shekullarizmi kohësisht përkon me reformizmin gjerman..., sipas: Ekrem Murtezai, *Fjalor i fere*, Prishtinë, 2000, fq. 446; Të tjerët mendojnë se shekullarizmi rrjedh nga epoka e renesansës, duke u zhvilluar më tej. Shih: M. Xh. Larixhani, op. cit., fq. 35. Elemente të caktuara të të përsiaturit shekullar vërejmë edhe në Greqinë antike.

Për rrjedhën shpirtërore dhe historike të shekullarizmit gjatë historisë shih: S. M. N. al-Attas, op. cit., fq. 25 –28.

<sup>87</sup> Shih: M. Xh. Larixhani, op. cit., fq. 36.

në shekullin e XVIII, tani zhvillimi është sinonim i mirëqenies.<sup>88</sup>

*Shekullarizmi* nuk është kurrfarë forme e blasfemisë dhe e mosbesimit, atë nuk mund ta identifikojmë me asnjë ideologji dhe pikëpamje për botën, siç janë, për shembull: materializmi, realizmi, natyralizmi, ekzistencializmi. Po ashtu, atë nuk mund ta kufizojmë në suaza të diskutimeve filozofike dhe të ideve të politikanëve. Shekullarizmi i përket çdo vendi dhe tani ai ka gjetur truall në të gjitha viset e botës. Ai është pajtuar që sytë e veshët e njeriut të mos e vërejnë tërë atë që gjendet në suazat e shekullarizmit, ndaj në botën e re dëgjohet dhe kuptohet mjaft dobët fjala *fe*.

Në vendet dhe te popujt muslimanë shekullarizmi hyri kryesisht në dy mënyra:

1. Me anë të dominimit dhe presionit, gjatë luftërave të ndryshme, e sidomos gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, kur Perëndimi vuri nën kontroll botën muslimane dhe u përpoq ta largonte islamin nga këto vende, si në Turqi, Marok, Algjeri, Tunizi, Iran, Palestinë e të tjera, por edhe në Shqipëri, Kosovë, Bosnjë e vende të ngjashme.

2. Ballafaqimi i dijetarëve dhe intelektualëve muslimanë me ata perëndimorë rezultoi me dy reaksione brendamuslimane: a) ata që ngulin këmbë se duhet të hiqet dorë nga sistemet e deritashme dhe të aprovohet sistemi perëndimor; b) ata që insistojnë se për të shpëtuar nga sistemi perëndimor duhet të aprovohet sistemi socialist, në thelb materialist por jo shekullarist, në vend të shekullarizmit perëndimor. Të dy këto sisteme dështuant në botën muslimane, si p.sh. në Turqi, Egjipt etj.

---

<sup>88</sup> M. N. Esfahani, *Shekullarizam i kultura*, në: Nur – časopis za kulturu i islamske teme, vol. V, no. 11/1996, Beograd, fq. 4 – 5.

Ekziston edhe mënyra e tretë, e kjo është që jeton jonë qytetare të zë fill në islam, që nuk është aspak shekullar<sup>89</sup>, por në vete përfshin dimensionin vertikal dhe dimensionin horizontal, edhe atë sakral edhe atë profan, dhe ku kriter është devotshmëria<sup>90</sup>, e gjyqtar absolut All-llahu.<sup>91</sup>

Nëse kohëve të fundit jemi dëshmitarë se është zbutur ashpërsia e këtij presioni,<sup>92</sup> kjo ndodh ngaqë shtresa iluzore, që e kaloi shekullarizmin, lëshon pe shkallë-shkallë, dhe ajo që me ndihmën e kësaj shtrese ka qenë çdo gjë në një kohë, feja, përsiatja, ligji, dhe mënyra e jetës, vetë është bërë një fakt kohor dhe historik.

Ndokush mund të thotë se kundërshtimi i shekullarizmit nuk është i nevojshëm dhe nuk është efektiv, ndaj duhet të presim që ai të zhduket vetëvetiu. Madje nuk mund të thuhet se s'ka si të kundërshtohet shekullarizmi për shkak se nuk është ideologji dhe besim. Këtu nuk duam veçse të cekim se është gabim ta shpërfillim këtë problem të rëndësishëm dhe fondamental.

Në raport me shekullarizmin mund të kemi tri gjendje:

*E para:* që t'u dorëzohemi ndodhive dhe t'i zbatojmë urdhëresat e tyre, pavarësisht se sa janë kundër nesh. Ky fenomen është shtrirë dhe është përhapur si rezultat i inferioritetit dhe i defetizmit vetjak. Sipas këtij opzioni njeriu katandiset në një fenomen krahas shumë

---

<sup>89</sup> Shih: M. Xh. Larixhani, op. cit., fq. 38.

<sup>90</sup> “Më fisniku tek All-llahu është ai i cili më së shumti i ruhet Atij ...” (El-Kur'an, El-Huxurat, 13).

<sup>91</sup> “A nuk është All-llahu më i drejti gjykates”. (El-Kur'an, Et-Tin, 8).

<sup>92</sup> Presioni ka marrë dimisione të tjera, më shkatërrimtare, më rrënuese, më të drejtpërdrejta, sepse, siç duket, filozofia shekullariste, në emër të globalizmit, nuk ka kohë të presë rezultatet e shekullarizmit në mënyrë indirekte, dhe ua ka mësyrë aksioneve ushtarake, me moton biblike: *kush s'është me mua është kundër meje, kush është kundër meje, ai do të luftohet deri në shkatërrim*. Shembujt e Afganistanit, Irakut, Filipineve, Kosovës dhe i shumë shteteve muslimane janë tipikë.

fenomeneve, me të cilin njeriut i mohohet arsyetimi metafizik i ekzistimit të njeriut dhe i imponohet arsyetimi kozmologjik i ekzistenës së tij. Sipas këtij botëkuptimi njeriu mund të bëjë ç'të dëshirojë në aspektin individual, kurse pushteti nuk do të merret me orientimin dhe prirjet e njeriut, por me kontrollimin e lirisë njerëzore dhe personale, ka shkelur individi të drejtat e të tjera e me veprimet individuale ose grupit apo jo.<sup>93</sup>

*Raporti i dytë* na thotë të bëhem kundërshtarë të tij të rreptë dhe ta mohojmë me ashpërsi dhe agresivitet. Ky botëkuptim konstituohet tek ata që nuk mund ta durojnë shekullarizimin dhe e goditin atë nga bindja. Këta njerëz duhet të jenë të vetëdijshëm se shekullarizimi nuk është degë e zakonshme e hollë e një druri, që fërgëllon nga çdo ere, dhe se kundër vrazhdësisë dhe represionit, ai ka mjete të ndryshme represive, që do t'i përdorë kur do të jetë nevoja. Në të vërtetë, më mirë të tentojmë t'i shëmangemi shekullarizmit sesa të biem në konflikt me të dhe nga ana tjetër, duhet punuar që ai të zëvendësohet si nga pikëpamja ideore dhe intelektuale ashtu edhe nga pikëpamja strukturore. Kështu ai do të dobësohet dhe një ditë do të zhduket.<sup>94</sup>

*Raporti i tretë* konsiston në njohjen e shekullarizmit dhe në çlirimin nga mbisundimi i tij. Si mund të lirohem nga shekullarizmi dhe si mund ta njohim atë? Nuk mund t'i mësojë fshehtësitë e shekullarizmit dhe të shekullarizmit e të çlirohet prej tyre secili që i studion ata. Në çdo botë mund t'i njohim gjerat që i përkasin asaj bote dhe

---

<sup>93</sup> M. Xh. Larixhani, op. cit., fq. 36.

<sup>94</sup> M. N. Esfahani, op. cit., fq. 4 – 5; Krhs.: M. Xh. Larixhani, op. cit., fq. 37- 38.

John L. Esposito, në veprën e tij studioze, *Islamska prijetnja mit ili stvarnost*, Živinice, 2001, fq. 67 – 98, dallon katër gjendje të muslimanëve kundrejt kolonialistëve jomuslimanë: 1. Refuzimin, 2. Abstenimin, 3. Shekullarizimin dhe perëndimizimin dhe 4. Modernizmin islam.

për këtë arsyen në botën e shekullarizuar, për shembull, pyetja e shenjtë nuk kuptohet si duhet. Nga ana tjetër, çdo botë ka bazamentin e vet, të cilin nuk mund ta njo-him, edhe pse çdo gjë është e lidhur me këtë bazament dhe ky formon çdo gjë. Shekullarizimi është bazament i botës moderne. Sa kohë që kjo botë ecte rrugës së vet normale dhe natyrore, askush nuk pyeste ç'është shekullarizmi. Tani e vështirë të rrahësh këtë rrugë, prandaj disa nga banorët e shpellës platonike të Perëndimit arritën të shikonin edhe në anët e tjera, u trottulluan rreth vetes dhe dolën jashtë kësaj shpelle. Shekullarizmin dhe shekullarizimin mund ta njohim atëherë kur nuk jemi të varur prej tyre dhe kur nuk u përkasim atyre. Kjo është koha kur sytë, veshët, gjuhët dhe duart nuk shohin, nuk dëgjojnë, nuk flasin dhe nuk veprojnë sipas urdhëresës së tyre. Me fjalë të tjera, të çliruar nga ai mund ta njohim thelbin e shekullarizimit.<sup>95</sup>

Liria e botës perëndimore është liri nën protektoretin e shekullarizimit dhe kjo liri është e kufizuar, edhe pse ky mjedis nuk është i vogël dhe nuk mund t'i mohojmë dhe përcmojmë këto liri. Mirëpo, me paraqitjen e krizës në botën aktuale, edhe këto liri janë rrezikuar. Periudha në të cilën çdo gjë është shekullarizuar ka përparsi në raport me periudhat e tjera, por njëkohësisht nuk mund t'i shpërfillim edhe rreziqet të cilat mugulloj-

---

<sup>95</sup> M. N. Esfahani, op. cit., fq. 4 – 5.

Shumë lëvizje muslimane u përpoqën t'i kundërviheshin shkatërrimit sistematik evroperëndimor, por mendoj se deri tani nuk ofruan program serioz për çlirim të gjithanshëm. Këtë nuk e ofruan as modernizmi, as reformizmi, madje as socializmi aq i trumbetuar arab. Në rrafshin intelektual themele solide ofrojnë: Muhammed Ikbal, Fazlur Rahman, El-Mewdu-di, Hasan el-Bena, Sejid Kutub, Muhammed Nekib el-Attas, Sejid Husein Nasr e të tjerë. Në rrafshin praktik, politik dhe ekonomik, në kundërshtim me disa opçione, në horizont ende nuk kemi trajtime serioze. Shih një elaborim serioz të konceptimit të këtyre çështjeve: Ahmet Davutoglu, *Vetë-perceptimet e qytetërimeve*, Prishtinë, 2002.

në nga ajo absolutizimin e ideve perëndimore, siç është rasti me veprimet e ritmit të ri botëror, ku agresor është bota evroperëndimore apo Veriu i pasur e viktimë bota muslimane apo Jugu i varfër.<sup>96</sup> Edhe pse ky shekullarizim u ka kushtuar kujdes interesave të njeriut në suaza të mendimit të ri që gjurmon interesat, janë shpërfillur interesat e së vërtetës dhe është rrënuar shtëpia e gjuhës. Me këtë rrënim çdo gjë është në rrezik. Për këtë arsy, vëzhgimi i së vërtetës për shekullarizimin nuk është i ndarë nga njohja e së vërtetës për ardhmërinë dhe sado të hulumtohet dhe të studiohet çështja e shekullarizimit, kjo është korrekte dhe e domosdoshme.<sup>97</sup>

Ekzistojnë dy rrugë, dy mënyra për të dalë dhe për ta shmangur përsiatjen shekullare. *Mënyra e parë* është e dhunshme, që do të thotë se civilizimi shekullar, i mbarruar me probleme të shumta, siç është largimi i njeriut nga njeriu, përdorimi jokorrekt i potencialeve teknologjike më bashkëkohore, rrënohet dhe njerëzit largohen nga ky civilizim.<sup>98</sup> *Mënyra e dytë* është fryt i mësimit, i njohjes dhe i zgjimit të njerëzve, të cilët do të kuptojnë se civilizimi shekullar apo liberal është i keq dhe do të largohen nga kjo ideologji.<sup>99</sup> Ky është fundi i modernizmit, që për bazë themelore kishte racionalizmin liberal, dhe kalimi në pasmodernizëm. Nëse do t'u bënëm një analizë më të thellë lëvizjeve të tashme, do të shihnim se shenjat e rënies së civilizimit shekullar janë në dukje dhe,

---

<sup>96</sup> Ali Bulaç, *Islami dbe demokracia, teokracia dbe totalitarizmi*, Shkup, 1998; Krhs.: Muhammed Filipović, *Islam i teror*, Sarajevë, 1423/2002.

<sup>97</sup> Në aktivitetin brendamusliman në dy shekujt e kaluar S. H. Nasr identifikon forcat dhe trajtat, që mund të renditen në katër grupe kryesore: 1) Modernizmi, 2) Mesianizmi, 3) Fondamentalizmi dhe 4) Islamin tradicional. Shih gjerësisht për aspektet e islamit tradicional dhe modern dhe raportet e tyre me modernizmi dhe shekullarizmi: Seyyed Hossein Nasr, *Tradisionalni islam u modernom svijetu*, Sarajevë, 1994, veçan faqet: 281-284.

<sup>98</sup> M. Xh. Larixhani, op. cit., fq. 38.

<sup>99</sup> Shih: M. Xh. Larixhani, op. cit., fq. 38.

pas rënies së sistemit socialist në tërë skenën politike botërore, radhën e ka civilizimi perëndimor. Zhvillimi i lartë industrial dhe shkencor në Perëndim nuk tregojnë se rënia e këtij civilizimi është e pamundur.<sup>100</sup> Përkundrazi. Mundësia për t'u larguar nga shekullarizmi dhe struktura e tij e madhe shekullare është e gjasshme.

Le të theksojmë në fund se suksesi i muslimanëve nuk varet nga pranimi ose mospranimi i shekullarizmit apo i ...*iżmare* të tjerë, por nga çlirimi i njeriut para së gjithash nga tradita magjike, mitologjike, animistike, pagane dhe nacional-kulturore, pastaj edhe nga çlirimi i kontrollit shekullar i synimit të ekzistencës së tij<sup>101</sup>, e pastaj nga kthimi ynë brenda shariatit hyjnor, që do të thotë ta pranojmë All-llahun Një të vërtetë, Krijues, Drejtues dhe Vigjilues absolut.<sup>102</sup>

---

<sup>100</sup> Që prej kohësh disa intelektualë perëndimorë kanë tërhequr vërejtjen për prijet destruktive të kulturës dhe të civilizimit perëndimor dhe për pasojat destruktive të tij, siç janë Osvald Spengleri (Shkatërrimi i Perëndimit), Martin Hajdegeri, Rozhe Garodi e të tjerë.

<sup>101</sup> Gjerësisht lexo: Syed Muhammed al-Naqib al-Attas, op. cit., fq. 31,

<sup>102</sup> “*Vetëm Ty të adhurojmë dbe vetëm nga Ti ndihmë kërkojmë*”. (El-Fatihu, 5).

## Feja dhe shoqëria në vite

Gjendja intelektuale-kulturore dhe shoqërore, e pranishme ndër muslimanët dhe në të shumtën e vendeve muslimane, u imponon intelektualëve muslimanë e sidomos dijetarëve muslimanë të shkencave fetare domosdonë e shqyrtimit intelektual dhe konstruktiv dhe elaborim shumështesor të kësaj gjendjeje. Në pamundësi t'i përgjigjemi më gjerësisht e analitisht këtij provokimi, do të përpinqemi, nëpërmjet një analize të shkurtër të problemit të shtruar, të ofrojmë disa përsiatje dhe interpretime të disa fakteve dhe dukurive, që, sipas bindjes sonë, do të mund ta çonin përpara këtë çështje:

1. *Sendërtimi i rendit të ri botëror*, i cili është vetëm pohim rutinor, nuk është i mundur, përveç nëse shkatërrohen kulturat dhe nëse izolohen fetë që kanë orientim dhe akces në shoqëri. Ateizmi modern, i shfaqur përmes ideologjive me emërtime të shumta, duke paraqitur rendin e ri botëror planifikon të organizojë sulm të ri dhe gjithëpërfshirës kundër besimtarëve, si dhe të përjashtojë çdo përsiatje të mundur që kundërshton modernizmin, përkatësisht postmodernizmin perëndimor, të identifikuar si globalizëm.<sup>103</sup>

Modernizmi dhe modernizimi, si pushtoi dhe gjunjëzoi Perëndimin, që nisur drejt Lindjes; edhe historia

---

<sup>103</sup> Shih: Samuel P. Huntington, *Sukob civilizacija*, në: Haris Silajdžić, *Alban-ski nacionalni pokret*, Sarajevë, 1995, fq. 11 – 41.

botërore e shekujve të kaluar pasqyron historinë e konfrontimeve të ideve të Lindjes dhe të Perëndimit.<sup>104</sup>

Ky konfrontim, edhe pse në dukje kishte periudha të ndryshme, në të vërtetë është vetëm një proces i vazhdueshëm. Një herë e një kohë ky proces dhe këto rrjedhime i kundërviheshin fesë dhe flitnin mbi divergjencat ndërmjet fesë dhe shkencës, ndërsa pak më vonë, të frymëzuara nga idetë materialiste ateiste, ato e konsiderojnë fenë opium të popullit, kurse shpirtëroren dhe moralen prodhim të shtypësve, pastaj e sulmojnë fenë nga aspekti i shkencave humaniste dhe shoqërore, të mbështetura në omanizëm dhe, në fund, insistojnë për shekullarizimin e sistemeve të kësaj bote dhe për largimin e fesë nga skena jetësore.<sup>105</sup>

Sot në horizontet intelektuale kulturore të disa vendeve islame, pos ripërtëritjes së idesë mbi divergjencat ndërmjet shkencës dhe teologjisë, paaftësisë së përsiatjes fetare për sigurimin e nevojave të njeriut në fushën e shkencës dhe të jetës, shtrohen edhe pyetje të tjera, siç janë: liberalizmi kulturor, shekullarizmi politik dhe mungesa e harmonisë ndërmjet fesë dhe çëshjteve të kësaj bote, fesë dhe politikës, fesë dhe demokracisë, fesë dhe zhvillimit, fesë dhe lirisë, dhe fesë edhe ideologjisë.<sup>106</sup> Janë të pranishme edhe diskutimet: dyshimi për argumentimin dhe permanencën e esencës dhe të natyrës së njeriut; dyshimi për mundësinë e Shpalljes dhe mbrojtja racionale e bindjeve fetare; dyshimi për mundësinë e mrekullive (muxhizeve); zhvillimi i moralit pa fe, relativi-

<sup>104</sup> Shih: F. William Engdahl, *Stoljeće rata*, Zagreb, 2000; Krhs.: Ahmet Davutoglu, *Vetëperceptimet e qytetërimeve*, Prishtinë, 2002.

<sup>105</sup> Tarik Ramadan, *Biti evropski musliman*, Sarajevë, 2002.

<sup>106</sup> Tendencat evroperëndimore dhe të elementit të asimiluar thellojnë brendaperbrenda vazhdimisht hendekun ndërmjet muslimanëve për pyetje të ngjashme. (Shih në këtë libër kapitullin me titull: *Filosofia islamë pro et contra*. Shih: Ali Sheriati, *Njeriu dhe feja*, Tetovë, 1990.)

teti i moralit dhe gnosticizmi laik; shpjegimi historik, sociologjik dhe psikologjik i prejardhjes dhe i esencës së fesë; sugjerimi i bindjeve të pathemelta si p.sh.: rapporti ndërmjet dyshimit dhe fesë, fesë dhe çuditjes, përsosuria dhe gjithpërfshirja e islamit, ndikimi i përgjithshëm dhe absolut i konceptimit të fesë në bazë të dijes njerëzore, relativiteti i njohjes së fesë, moskuptimi i korrektësisë fetare dhe fesë korrekte, kufizimi i mendimit fetar për çështje të lidhura me botën tjeter, dyshimi për efektshmërinë dhe depërtueshmërinë e jurisprudencës fetare, shtruarja e pyetjeve të fesë dhe mosrespektimi i të drejtave njerëzore, dallimet ndërmjet mashkullit dhe femrës në të drejtat kushtetutare qytetare dhe ndëshkimore dhe... Këto pyetje dhe shumë të tjera filozofike, retorike dhe juridike, që në esencë janë rezultat i krizës së perëndimit të njohjes së fesë, aktualisht shtrohen në mënyra të ndryshme.<sup>107</sup>

2. Duke iu falenderuar lëvizjeve dhe përplasjeve të mëdha në botën arabe dhe islame në fund të shekullit XX<sup>108</sup>, është gjallëruar dhe shtrirë tradita e diskutimit dhe e shqyrtimit të ideve dhe mendimit dhe këta thesarë duhet shfrytëzuar për manifestimin e mundësive, aftësive dhe përparësive të kulturës dhe të mendimit fetar në ballafaqim me rivalët dhe kundërshtarët. Në këtë kuptim kemi edhe fjalët e All-llahut të madhëruar:

*“Ata dëshirojnë që dritën e All-llahut ta fikin me gojët e tyre, kurse All-llahu e përsos dritën e tij, edhe pse mosbersimtarët e urrejnë”.* (El-Kur'an, Es-Saff, 8).

---

<sup>107</sup> Shih: Sejid Husein Nasr, *Srce islama*, Sarajevë, 1423/2002; Muhammed Filipović, *Islam i teror*, Sarajevë, 1423/2002; Alija Izetbegović, *Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*, Prizren, 1990.

<sup>108</sup> Fikret Karcic, *Drustveno pravni aspekti islamskog reformizma*, Sarajevë, 1990.

Mirëpo, ekzistojnë edhe njerëz jokorrektë të cilët kapërcejnë në mënyrë joparimore të gjithë kufijtë e mundur duke paraqitur ide dhe të pikëpamje të reja në fushë të fesë dhe të jurisprudencës fetare, të cilat janë shqetësuese. Problemi qëndron në faktin se prezantimi i pikëpamjeve kryeneçe, këmbëngulja dhe thirrja për kundërshtim ekzagjerues, si edhe prezantimi i pikëpamjeve diletante paraqesin të këqija dhe sëmundje, dëmet e të cilave do të na përfshijnë të gjithë ne:

*“Dhe ruajuni nga shpjifja shkatërruese që nuk do t’i godasë në mënyrë të reçantë nga ju, vetëm ata që kanë bërë mëkate, dhe dijeni se All-llahu ka dënim të neptë”*. (El-Kur'an, El-Enfal, 25).<sup>109</sup>

3. Çlirimi nga kolonializmi perëndimor dhe tendencat për islamizimin e vendeve arabo-islame, u manifestuan në tri rafshe të jetës fetare:

a. Në jetën e individit. (Islamizimi i pikëpamjeve të ndryshme të jetës së njeriut: kultura e banimit, e ushqimit, e lindjes dhe e vdekjes, e martesës, e mirësjelljes, e punës, e afarizmit, e profesionit etj.);

b. Në raportet shoqërore. (Islamizimi i institucioneve shoqërore, kulturore, arsimore në disa vende, si p.sh.: krijimi i kushteve për aplikimin e fesë në burgje, në sanatoriume, në armatë, jetimore, spitale, çerdhe fëmijësh, shkolla dhe institucione të tjera publike);

---

<sup>109</sup> Disa lëvizje muslimane dhe disa individë intelektualë-politikanë me aspirata dhe kolorit 'selefist' në shekullin XX i bënë shumë dëm islamit me pohimet dhe veprimet e tyre, siç është rasti i bashkëpunimit të dinastisë saudite me anglezët, përkatesisht me të a. q. Lorencin e Arabisë apo ai i Mustafa Kemal Ataturkut me Perëndimin.

Britania fitoi përkrahje të pavlerësueshme ushtarake nga forcat arabe... Britania i bindi forcat arabe, që shërbën në komandimin e T. E. Lawrenc (Lorencit), që për ndihmën e tyre kundër turqve, pas luftës, Anglia do të sigurojë sovranitet dhe pavarësi të plotë për arabët. Sipas: F. William Engdahl, op. cit., fq. 75.

c. Në pushtet. (Islamizimi i institucioneve politike dhe shtetërore në disa vende muslimane si: Sudani, Irani, Malazia, Arabia, Pakistani, Mauritania e të tjera).

Këto dëshira dhe këto veprime krijuan dy antipode:

1. Pjesëtarët e fesë dëshirojnë ta kuqtojnë dhe ta aplikojnë me entuziazëm të madh praktikisht fenë dhe mësimin e All-lahut në jetën e tyre individuale;<sup>110</sup>

2. Kundërshtarët e fesë me shqetësim të madh dëshirojnë ta mënjanojnë fenë nga skena jetësore, nga çerdhet e deri në klubet e pensionistëve.<sup>111</sup>

Ky synim, ky entuziazëm dhe shqetësim shtrojnë shumë çështje para fesë dhe tani mendimtarët e shqetësuar për fenë duhet të preokupohen seriozisht me këto çështje, të hulumtojnë dhe të këmbejnë mendime me dijetarët e tjerë nga këto fusha, të kryejnë detyrën e tyre historike duke i shfrytëzuar thesarët e pasur kulturorë të Shpalljes dhe mundësitë e aftësitë e mëdha të shoqërisë muslimane.

Lëvizjet e mëdha islame të identifikuara me Xh. Afganiun e M. Abduhunë, me M. Ikbillin, me senusitë, por edhe luftërat çlirimtare të vendeve muslimane<sup>112</sup> dhe

---

<sup>110</sup> Rezultat i këtij entuziazmi dhe angazhimi është një plejadë intelektualësh të lartë dhe disa lëvizje të mëdha islame brenda Bashkësisë muslimane në shekullin XIX-XX. (Shih: Fazlur Rahman, *Dub islama*, Beograd, 1983, fq. 267 – 320.).

<sup>111</sup> Ideologjitet e ndryshme si materializmi, evolucionizmi, ekzistencializmi e të tjera dhe së fundi globalizmi, në shërbim të politikës evrocentriste, katoliko-centriste dhe ortodokso-centriste janë tejet aktive, pa dallime të mëdha nga gjyqet e inkvizicionit dhe luftërat kryqtare. Shih gjerësisht: Rasim Muminović, *Filosofija ideologije*, I-II, Sarajevë, 1421/2000; vepra e fundit e Sejid Husein Nasr, *Srce islama*, Sarajevë, 2002, fq. 428; N. Ibrahim, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, Shkup, 1998, fq. 17 – 178. Muhammed Iqbal, *Obnova vjerske misli u islamu*, botimi II i plotësuar dhe i ndryshuar, Sarajevë, 2000.

<sup>112</sup> Për filozofinë politike të këtyre lëvizjeve shih: Muhammed Asad, *Rruja për në Mekë*, Shkup, 2003; Muhammed Asad, *Islami në uzbekryq*, Prizren, 2002. Henry Laost, *Raskoli u islamu*, Zagreb, 1989.

lëvizja e Vellezërve muslimanë, jo vetëm që ndërruan disa pikëpamje me disa të tjera, jo vetëm që ndërruan një regjim me një tjetër, por, në kohën kur shkollat dhe ideologjite materialiste u futën në qorrashok, kur liberalizmi dhe modernizmi perëndimor, me gjithë përparrimin teknologjik dhe mirëqenien materiale, nuk arritën t'i sigurojnë, t'i plotësojnë dhe kënaqin nevojat e njeriut, këto lëvizje islame patën sukses që, me ringjalljen e islamit ndër besimtarë, të tregojnë rolin e vërtetë të fesë në pikëpamjet e saj permanente: në jetën individuale, në marrëdhëni shoqërore dhe në aspekt të pushtetit dhe qeverisjes.

# Drejt një konceptimi real të historisë islame

## Hyrje

Të shkruhet historia islame a historia e ndonjë religioni tjetër qiellor, është punë shkencore dhe morale me pikëpyetje të madhe. Krahas shkaqeve objektive duhet t'i theksojmë edhe disa të tjera:

- Sa mund ta shkruajë njeriu historinë e një feje e cila buron dhe vjen valë-valë nga thellësitë e kuptimeve dhe domethënieve që janë të pranishme nga ‘natyra’ e deri në ‘Tabula Secreta’<sup>113</sup>?

- A i është dhënë njeriut mundësia që të dijë dhe të ballafaqohet me dinjitet me tërë këto hapësira dhe me tërë këtë kohë dhe me tërë ndryshimet e historisë, pa e zënë në gojë amshueshmërinë?

- Në fund, çka shërbejnë tërë këto histori? A janë meritore këto histori, të shtruara nga e tanishmja e tyre me guxim, por njëanshëm dhe subjektivisht?

---

<sup>113</sup> Tabula Secreta (lat.) apo *Pllaka Qiellore e Ruajtur Mirë* (El-Lewhu'l-Mahfudh), e përmendur në Kur'an: El-Buruxh, 32. Shih: Nerkez Smailagić, Leksikon Islama, Sarajevë, 1990, fq.358-359.

## **Islami – feja më ‘e vjetër’ dhe më ‘e re’**

Kur’ani flet për felajmëtarët (nebij) dhe të dërguarit (resul) e Zotit si dorëzues të fjalës së Zotit në rrafshin fetar dhe institucionalizues të islamit në rrafshin historik. Në pajtim me këtë Kur’ani konfirmon se edhe vetë ata (ishin *muslimanë*).<sup>114</sup> Sipas Kur’anit, Ademi (Adami) është njeriu i parë dhe muslimani i parë në gjininë njerëzore, por edhe i Dërguari i parë i Zotit.<sup>115</sup> Pastaj vazhdojnë *muslimanët* dhe *të dërguarit e tjerë të Zotit*: Idrisi (Henoku), Nuhi (Noe), Hudi, Salihu, Ibrahimi (Abrahami, Avrami), Ismaili (Ishmaeli), Ishaku (Izaku), Jakubi (Jakovi), Musa (Mojsie) Haruni (Aroni), Isai (Jezusi)<sup>116</sup> dhe Muhammedi a.s.. Kishte edhe të dërguar të tjerë që nuk janë përmendur me emra e numri i tyre mendohet të jetë 124.000. Të gjithë këta kanë sjellë lajme hyjnore mbi një Zot, rregulla mbi jetën morale, lajme mbi botën tjetër, mbi namazin, agjërimin, haxhin etj., pastaj kanë mësuar si të besohet dhe si të veprohet sipas tyre... ky është islami, të cilin Muhammedi a.s. ia solli njerëzisë.

Kështu të konceptuar historinë e trajtojnë edhe historianët muslimanë. Ibn Xherir et-Taberiu, sigurisht

---

<sup>114</sup> Janë të shumta ajetet kur'anore që flasin për pejgamberët e kaluar. Ne do t'i cekim disa pa pretendim se ia kemi qëlluar përgjedhjes sonë: El-Ahkaf, 9; El-Hixhr, 10; El-Bekaretu, 136; Eel-Ankebut, 46; Junus, 37; Fatir, 28; Ali Imran, 19 etj.

Shih: S. H. Nasr, Srce islama, Sarajevë, 1423/2002, fq. 35-42. 2002

<sup>115</sup> El-Bekare, 30-32;

Për Ademin në botën e paraekzistencës, ekzistencës, si njeri, si i dërguar i Zotit, në Librat e Shenjta dhe në Kur'an shih studimin e hollësishëm: Al-Haj Mekael Maknoon, *The Universal Significance of Adam*, Londër, pa vit botimi. Krahaso: Hafiz Ibn Kesir, Kazivanja o vjerovjesnicima, Zenicë, 1420/1999, fq. 8-67; Abdu'l-vehhab En-Nexhxhar, *Kasas'ul-enbijai*, botimi III, Bejrut, pa vit botimi, fq. 1-23.

<sup>116</sup> Hafiz Ibn Kesir, op. cit.; Abdu'l-vehhab En-Nexhxhar, op. cit.

historiografi më i madh klasik musliman, në historinë e tij “Tarih’ul-umemi we’l-muluki” (Historia e popujve dhe mbretërve), fillon nga Ademi a.s., përmend pejgamberët e tjerë, pastaj flet për engjëjt, djatë dhe tema të tjera. Sipas tyre, monoteizmi është gjendje natyrore e besimit të njeriut, kurse politeizmi është shtrembërim, gjendje jonatyrore.<sup>117</sup>

## Arabët gjatë historisë

Arabia si nacion gjeografik hyri në histori herët. Tempulli i Kabes së dikurshme, përplot me hyjni të shfaqur në idhuj prej druri, argjile, nga metalet e atëhershme, guri, ishte element koheziv që i bashkonte arabët. Element uniteti, ndoshta edhe më i rëndësishëm ishte gjuha e pastër arabe dhe niveli i saj, i ngritur lart në poezi.<sup>118</sup> Por, vetëm me Muhammedin a.s. Arabia hyri në histori dhe mbeti aty deri në përfundimin e botës.<sup>119</sup> Arabia edhe para Muhammedit a.s. e njinte judaizmin dhe kristianizmin, por vetëm Muhammedi a.s. bëri ndryshime historike themelore.<sup>120</sup> Thellësia e Arabisë kurrë nuk u shkel as nga romakët, as nga Aleksandri i Madh, as nga persianët, as nga faraonët. Arabinë nuk e bënë të madhe perandoritë apo perandorët, por Islami dhe Muhammedi a.s.

---

<sup>117</sup> Enes, Karić, Kur'an u savremenom dobu, II, Sarajevë, 1997, fq. 663.

<sup>118</sup> Ukadhi ishte kongresi, panairi vjetor në të cilin poetët e oratorët arabë demonstronin të arriturat e tyre në poezi. Shih: Filip Hiti, Historija Arapa od najstarijih vremena do danas, botimi II fototip, Sarajevë, 1988, fq. 99-100.

<sup>119</sup> Muhammed Hamidull-llah, Muhammed a.s. – život i djelo, I-II, botimi II i plotësuar, Sarajevë, 1983.

<sup>120</sup> Muhammed Husejn Hejkel, Hajatu Muhammed, botimi XIV, Kairo, 1977.

## Vëzhgime stereotipe jobesnike

Në vitet e para pas vdekjes së Muhammedit a.s. u bënë shtrirjet e para serioze të islamit jashtë Arabisë. Këto shtrirje ishin kryesisht ushtarake, por ato prezantonin edhe vlerat e tjera të besimit dhe të sistemit të ri shoqëror. Lufta në Jermuk në vitin 634 ishte fillimi i fundit në viset jugore dhe lindore të Bizantit.<sup>121</sup> Edhe Persia ra në Nihavend në vitin 642.<sup>122</sup> Si i ndodhi kjo një Perandore aq të fuqishme në aspektin ushtarak, kulturor e qytetërues përballë një fqinji historikisht gjithnjë inferior në aspektin ushtarak, kulturor e qytetërues.

Nga kjo kohë në skenë të historisë së botës islame do të dalin dinasti të shumta, të mëdha apo të vogla, me preardhje arabe, persiane, mongole, turke, indiane, ndërsa në Ballkan disa dinasti shqiptare dhe boshnjake.<sup>123</sup> Në mesin e arabëve kemi emevitët dhe abbasitët<sup>124</sup>, në mesin e turqve selxhukët dhe osmanët<sup>125</sup> etj. Vlen të përmenden edhe dinastitë vijuese: murabitët, muvehiddët, fatimitët, idrisitët, zejditët, tulunitët, xhaferitët, gaznevitet etj.

Dinastitë i kanë zgjeruar kufijtë, kanë ndërtuar shumë qytete, por edhe kanë rënë në harresë pas përfundimit të tyre. Gjatë shtrirjes së kufijve nuk duhet përjashtuar absolutisht edhe dhunën, luftërat, gjakun dhe shpatën. Por, t'i jepet përparësi shpatës dhe gjakut gjatë

---

<sup>121</sup> Filip Hiti, Historija Arapa od najstarijih vremena do danas, botimi II fototip, Sarajevë, 1988, fq. 149-151.

<sup>122</sup> F. Hiti, op. cit., fq. 153-156.

<sup>123</sup> Joseph von Hamer, Historija Turskog /Osmanskog/ Cartsva, I-III, Zagreb, 1979.

<sup>124</sup> F. Hiti, op. cit., Emevitët: fq. 182-267 dhe Abasitët: fq. 268-446.

<sup>125</sup> Halil Inalxhik, Perandoria Osmane, Gjilan, 2002.

përhapjes së islamit është gabim.<sup>126</sup> Kemi shumë shembuj të përhapjes së islamit nëpër zona të ndryshme pa luftë dhe dhunë. Jerusalemi i kohës së mbisundimit musliman, i kohës së Salahuddinit<sup>127</sup> është shembulli më i mirë i jetës që sot e quajmë multilaterale, multikulturale dhe multireligjioze.<sup>128</sup> Nuk mbahet mend që zgjerimi islam në Lindje apo në Perëndim ka shkatërruar selinë patrikane të ndonjë sekti të krishterë. Edhe depërtimi islam në Andaluzi në vitin 711-712 ishte më tepër takim që e solli fati sesa fatkeq i tri feve monoteiste: judaizmit, kristianizmit dhe islamit apo i tre ekzemplarëve kulturore, qytetëruar të bazuar në këto tri fe.<sup>129</sup>

## Zonat gjuhësore dhe kulturore të botës muslimane

Ekzistojnë njoftime të shumta se disa popuj gjatë historisë kanë kontribuar më tepër e disa më pak. Historiani i njohur evropian A. Tojinbi konsideron se qytetërimi islam kategorizohet me dy pole: arab dhe persian. Në drejtim të Lindjes mbizotëron elementi persian, kurse në Perëndim elementi arab.<sup>130</sup> Intelektuali i madh musliman

---

<sup>126</sup> Thomas W. Arnold, *The Preaching of Islam*, Lahore, Pakistan, botimi III i riprintuar, 1968.

<sup>127</sup> Lexo: Grup autorësh, *Dosja Kuds*, Shkup, 1424/2003; Mehmed Karahodžić, *Jerusalim – Bejtul-Makdis*, Visokë, Bosnjë, 2002; Nerkez Smailagić, *Leksikon Islama*, Sarajevë, 1990, fq. 294-299; Imran N. Hosein, *Jerusalim u Kur'anu*, Sarajevë, 2003.

<sup>128</sup> Enes, Karić, *Kur'an u savremenom dobu*, II, Sarajevë, 1997, fq. 666.

<sup>129</sup> Ibid., fq. 668.

<sup>130</sup> Arnold Toynbee, *Istraživanja istorije*, Beograd, I - 1970, II – 1971, fq. 178. Shih: Nijaz Sukrić, *Povijest islamske kulture i civilizacije*, Sarajevë, 1989, fq. 22-26.

S. H., Nasri mendon se përgjithësimi i poleve në dy nuk pajton me realitetin<sup>131</sup>, sepse dallojmë disa tërësi specifike edhe në zonën arabe edhe në atë persiane, sekte islame apo joislame. Këtu duhet theksuar se krijimi i Lindjes dhe i Perëndimit islam nuk e fshiu Lindjen dhe Perëndimin e krishterë, por e pasuroi dhe fisknikëroi atë.<sup>132</sup>

Megjithatë, e miratojmë tezën se ekzistojnë disa sisteme kulturore që janë të përhershme dhe disa që kanë vepruar një kohë më të gjatë. Në këtë aspekt ndihmon studimi i Riçard Uksit me titull “Pasqyrë etnografike botërore e popujve muslimanë” (*Muslim Peoples – A World Ethnographic Survey*)<sup>133</sup>, i cili, krahas zonave të dhëna ofron edhe ndarjen gjuhësore, pastaj zonat kulturore, klimatike dhje gjeografike.<sup>134</sup>

S. H. Nasri ofron disa zona kulturore: arabe, iraniiane, turke, indo-pakistaneze, malaje, indoneziane-polineziane, zezako-afrikane, zona e vendeve e të ashtu-quajturit “islam periferik” dhe bashkësitë muslimane diasporiale.<sup>135</sup>

---

<sup>131</sup> Sejid Husein Nasr, *Islam u svijetu*, në: *Takvim 1400 b.* Sarajevë, 1980, fq. 115-132.

<sup>132</sup> Rozhe Garodi, *Islami dbe kultura*, Sarajevë, 1991.

<sup>133</sup> Richard V. Weekes, *Muslim Peoples – A World Ethnographic Survey*, sipas: Enes Karić, *Kur'an u savremenom dobu*, II, op. cit., fq. 669.

<sup>134</sup> Dallojmë disa zona gjuhësore: indo-evropiane, afro-aziatike, malajo-polineziane, uralo-altaje, nigero-konkoake, ibero-kaukaze etj. Sipas: Enes Karić, *Kur'an u savremenom dobu*, II, op. cit., fq. 669-671.

<sup>135</sup> S. H. Nasr, *Islam u svijetu*, op. cit., fq. 120 ...

Kemi edhe ndarje të tjera. Shih gjerësisht: Enes Karić, *Kur'an u savremennom dobu*, II, op. cit., fq. 671 - 673.

## Ardhmëria e islamit dhe e Evropës

Nëse vështrohet mozaiku aktual religjioz evropian vërehet se në aspektin religjioz Evropa tashmë 2000 vjet është kontinent i “kolonizuar”. Këtë realitet e vë në pah Mirçe Eliade, i cili pohon se Evropa nuk është vend-lindje autoktone e asnjë religjioni monoteist botëror. Judaizmi, kristianizmi dhe islami kanë ardhur nga Lindja. Qytetet dhe vendet e shenjta të të tri religjioneve nuk gjenden në Evropë, por në Lindje.

Veprat e hershme historike muslimane nuk e lidhin kristianizmin me Evropën. Për to si kristianizmi ashtu edhe islami sa janë lindorë janë aq edhe perëndimore. Atribuimi evrocentrist i islamit si ‘lindor’ dhe i kristianizmit si ‘perëndimor’ është i vonshëm, palian dhe politik, çesarik. Kështu i bëhet padrejtësi vetë kristianizmit, sepse duke e ngushtuar në Evropë, ai humb universalizmin e tij të proklamuar.<sup>136</sup>

Krahas frikës së dyanshme, kemi edhe diplomaci. Patriku i Kostandinopojës në shekullin X i drejtohet emirit musliman nga Kreta me këto fjalë:

*“Dy fuqi botërore, saracenët dhe romakët, shkëlqejnë si dy yje më të shkëlqyeshme qiellore. Prandaj, duhet të jetojmë së bashku si vëllezër, edhe pse dallojmë sipas traditave, shprehive dhe fesë”.*<sup>137</sup>

Edhe sot miliona muslimanë në Evropë e në Perëndim dhe miliona të krishterë në vendet arabo-islame presin dhe shpresojnë te dialogu ndërfetar islamo-kristian dhe respektimi absolut i lutjes së Zotit në mënyrën e tyre e jo përplasje qytetërimesh në rrugëllin tokësor.<sup>138</sup>

---

<sup>136</sup> Enes Karić, Kur'an u savremenom dobu, II, op. cit., fq. 675.

<sup>137</sup> Enes Karić, Kur'an u savremenom dobu, II, op. cit., fq. 677.

<sup>138</sup> Ahmet Davutoglu, Vetëperceptimi i qytetërimeve, Prishtinë, 2002.

## **Historia islame dhe perspektiva**

Ndonëse pushtues, islami nuk e rrënoi, nuk e shkatteredoi Evropën. Atë e rilindi duke i ofruar konkurrencë me besim monoteist, duke i ofruar politikë tjetër ekonomike dhe sociale, duke e përkthyer, valorizuar dhe transmetuar filozofinë dhe kulturën greke nga humbja në Evropë.<sup>139</sup>

Ndonëse e kaluara ishte më tepër në shenjë të luftërave dhe të mosmarrëveshjeve, islami dhe Evropa janë dy fqinj të rëndësishëm, që duhet të fqinjërojnë dhe të bashkëjetojnë.

Që nga shekulli VIII e këndej, me intensitet relativ, islami është i pranishëm në Evropë në mënyrë autoktone.<sup>140</sup> Aktualisht, shqiptarët me numrin më të madh të muslimanëve në Evropë, pastaj boshnjakët dhe të tjerët, por edhe konvertitët jo të paktë evropianë, janë faktorë që duhet respektuar.

Gjuha e dytë e muslimanëve të Evropës, pas gjuhës amtare, është anglishtja. Me të komunikohet, në të shkruhen librat fetarë, bëhen kontratat e ndryshme. Anglishtja po bëhet gjuhë islame.

Mirëpo, edhe pse kemi shumë muslimanë të shkolluar dhe me aftësi politike të dëshmuara, ata ende nuk i kemi të pranishëm në parlamentet e shteteve evropiane, qeveritë evropiane. Programet suplementare të muslimanëve në Evropë nuk financohen nga shteti, siç është rasti me hebrejtë dhe të krishterët. Janë edhe shumë çështje që muslimanët në Evropë nuk i gjeljnë. Çdo gjë të thotë se muslimanëve u mungon një institu-

---

<sup>139</sup> Ahmed Fuad El-Ehwani, *Filosofia islamë*, Prizren, 2002 fq. 38-58.

<sup>140</sup> Nexhat Ibrahim, *Islami dbe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar*, Shkup, 2003.

cion islam i nivelist evropian, që do ta zhvillonte evropianizmin islamik dhe islamin evropian – *bashkësinë islame gjithëropiane*. Ky institucion do të organizonte platformë mirëkuptimi dhe zhvillimi brendapërbrenda muslimanëve e pastaj edhe me organizatat e tjera fetare si hebraike, krishtera, budiste tj.

Ky institucion do të hartonte programe të zhvillimit material, por edhe shpirtëror. Do t'i angazhonte individët që ta lexojnë në mënyrë institucionale ‘edhe një herë’ Kur'anin për të gjetur përgjigje për problemet aktuale për vetveten dhe për të tjerët. Këtë ‘rilexim’ duhet ta bëjnë edhe fetë e tjera.

Duke u nisur nga pozita e vet në botë dhe nga kërkesat urdhëruese të Kur'anit, muslimanët duhet të jenë të gatshëm për *dialog metahistorik* dhe *istorik* me të tjerët. Ky dialog për muslimanët nënkupton njohjen si të islamit ashtu edhe të të tjerëve. Por, duhet ta bindim edhe ‘tjetrin’ se ne dimë. Ky raport rrit shanset e mirëkuptimit dhe të dinjitetit reciprok dhe të bashkëveprimit në botën aktuale.

Religionet botërore sot duhet të jenë përgjegjëse jo vetëm ndaj vetes, por edhe ndaj religjioneve të tjera. Pozita fatkeqe ose e përbuzur e një pjese të njerëzisë nuk do të duhej ta ‘kënaqte’ pjesën tjetër të njerëzisë!. Të goditur sot janë islami dhe muslimanët. Perëndimi kundrejt islamit sot luan rolin e ujkut në përrallëzën me qengjin.

## **Obsesioni evropian ndaj osmanëve**

Perandoria Osmane, përkatësisht Turqia, gjatë disa shekujve të fundit është për evropianët obsesion shpirtëror dhe preokupim permanent diplomatiko-ushtarak, politiko-ekonomik e kulturor-shkencor. Është e pamundur në një shkrim të këtij lloji të shtrohen të gjitha këto preokupime shkencore, politike, diplomatike, udhëpërshkruese e të fushave të ngjashme.<sup>141</sup> Pamundësia kon siston në faktin se një angazhim i tillë kërkon kohë për t'u hulumtuar tërë ajo lëndë arkivore dhe literaturë e botuar, kërkon mjete të mëdha materiale, përgatitje profesionale dhe punë shumëdimensionale ekipore, mundësish institucionale. Megjithatë, më mirë pak se hiç.

Për arsyen e konfuzionit doktrinar, mosnjohjes së fesë islamë dhe synimeve shfrytëzuese, islamin si religionin rival Evropa e krishterë fillimisht e kishte qejf ta emërtonte me termen etnikë.<sup>142</sup> Mirëpo, jo fort vonë, me

---

<sup>141</sup> Në disa vepra dhe shkrime të mëparshme kemi shkruar për disa aspekte të kësaj teme, mirëpo ky angazhim është, megjithatë, një punë modeste në krahasim me çka duhet bërë. Shih: *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, Shkup, 1998 dhe disa botime tjera. Po ashtu shih: [www.zeriislam.com](http://www.zeriislam.com); *Islami dhe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar (sh. IX-XIV)*, Shkup, 2003; *Islami kërcënues i botës – shpjefje apo realitet*, në përgatitje për botim etj.

<sup>142</sup> Në letrat shqipe si shembull do ta përmendim Pjetër Bogdanin, *Ceta e profetëve*, I, Prishtinë, 1990, fq. 229 e gjatë gjithë librit.

Edhe papa Pali III (Aleksandër Farneze, 1468-1549), i inauguruar prej vitit 1534, i specializuar në luftën kundër protestantëve, ishte i njobur me thënien kundër kalvinistëve, në të cilën jep mendimin edhe për muslimanët:

nisiativë dhe me ndihmë të klerikëve të krishterë, Perandorinë Osmane filluan ta atakojnë edhe me emra religiozë, në të shumtën e rasteve me emra pezhorativë,<sup>143</sup> të bindur që më shumë se për rival etnik, fjala është për rival fetar. Po ashtu, ata nuk u ndalën vetëm në studimin e islamit si faktor dhe si doktrinë që i rrezikonte ata, por filluan t'i konvertojnë muslimanët në fenë e tyre të vërtetë.<sup>144</sup>

Mirëpo, nga fundi i shekullit XVI dhe fillimi i shekullit XVII puna ndryshoi. Interesat religjioze evropiane, sidomos pas reformacionit, i thelluan studimet rrëth islamit si doktrinë, sistem jete, ndoshta për shkak se evropianët nuk frikësoheshin më për rrezikimin e ekzistimit fizik nga islam.<sup>145</sup> Temat e përbashkëta të Ungjive dhe të Kur'anit, si dhe shumë të dërguar të Zotit, Krijimi i gjithësisë dhe i vetë njeriut, Bota tjeter, aspiratat universaliste të të dy religjioneve i bënë ata të krijojnë shkencë të veçantë për t'iu përgjigjur aspiratave islame.

Kështu, kleriku dhe dijetari anglez Richard Knolles në vitin 1693, shkroi veprën e vëllimshme me rrëth 600 fletë me titull “*Generalle Historie of the Turkes*”. Vepra është shkruar në gjuhën angleze, bën fjalë kundër Turqisë dhe për përpjekjet evropiane që të ndalet përp-

---

“Kalinistët parqesin rrezik më të madh se turqit”. Sipas: Andrija Gams, *Biblija i društva*, Novi Sad, 1979, fq. 349.

<sup>143</sup> Edhe në këtë rast si shembull do ta marrim Pjetër Bogdanin, pa dyshim ndër urrejtësit më të mëdhenj të muslimanëve dhe shqiptarëve muslimanë, i cili islamin e quan “*pafeja orientale*” (infedelta orientale) dhe me shumë emra të tjera. Shih: Pjetër Bogdani, op. cit., fq. 64 latinisht dhe 54 shqip.

<sup>144</sup> Shih: Edward Said, *Orijentalizam*, Sarajevë, 1999.

<sup>145</sup> Ushtritë muslimane në Spanjë tashmë kishin humbur tërësisht. Ushtria osmane të bie në amulli që nga dështimi i pushtimit të Vjenës më 1683. Edhe në pjesët e tjera ushtritë muslimane nuk e kishin vrullin e dikurshëm. Në anën tjeter, evropianët filluan me kolonializimin e tyre, pushtimin e tregjeve por edhe të vendeve të tjera. Vendet muslimane ishin më të goditura. Shih: Filip Hiti, *Istorija Arapa od najstarijih vremena do danas*, botimi II fototip, Sarajevë, 1988, fq. 447-554.

rimi i turqve. Ndonëse nuk e dinte osmanishten, kleriku anglez kishte lexuar për osmanët në latinishte, greqishte, frëngjishte, italishte e madje edhe në gjermanishte.

Vepra e R. Knollesit karakterizohet me literaturë udhëpërshkruese, misionare, diplomatike dhe shkencore. Si vepra në fjalë ashtu edhe burimet e shfrytëzuara nga Knollesi karakterizohen me dy tendencia:

- provokim kundrejt kristianizmit nga besimi rival musliman dhe;

- rreziku për Evropën me pushtimin dhe përfshirjen e vendeve të krishtera në “perandorinë e lavdishme turke”.<sup>146</sup>

Pushtimi i vendeve evropiane nga osmanët solli edhe strukturë të re etnike dhe religjioze. Pushtimi solli edhe ndryshime të tjera, siç është kategoria e konvertorëve (ata që pranuan islamin për fe të ardhshme të tyre). Konvertorët ishin të ndryshëm:

- Në vendet evropiane të pushtuara nga turqit kishte konvertorë të tillë – çuditërisht në numër të vogël – që për arsyet e kishin kaluar në fenë e re, islame;

- Kishte konvertorë që kishin ardhur nga Evropa në Perandorinë Osmane për të kërkuar lumturi të re, për të pranuar më vonë fenë islame, ndoshta për qëllime karrireste politike, ushtarake, ekonomike;

- Kishte konvertorë që fenë islame e pranuan pikërisht nga bindja religjioze, numri i tyre gjatë historisë do të jetë i madh. Këtë fakt na e dëshmon historia.<sup>147</sup>

Mirëpo, ky numër konvertorësh nuk paraqiste ndonjë problem të madh për Evropën. Këtë e vërejmë edhe

---

<sup>146</sup> Gjerësisht lexo: Bernard Lewis, *Otomanska opsesija, Novi Muallim* – časopis za odgoj i obrazovanje, nr. 9/2002, Sarajevë, fq. 28.

Nga ky shkrim kemi huazuar edhe disa të dhëna, që për shkak të numrit të madh nuk do t'i shënojmë të gjitha.

<sup>147</sup> Thomas W. Arnold, *The Preaching of Islam*, Third Reprint, Lahore, Pakistan, May 1968 (sipas botimit të vitit 1913), fq. 133-146 dhe 147-207.

nga pohimi i Luterit, i cili rrezikun nga Turqia e shihte më tepër në aspektin ushtarako-politik e më pak nga aspekti religjioz. Perandorinë Osmane ai e kishte katan-disur në rrezikun për luterizmin e tij dhe e klasifikonte së bashku me papën:

*“Papa dhe Turqit së bashku. Egërsira (bisha) plot jetë duhet të ketë trup dhe shpirt. Fryma ose Shpirti i Antikrishtit është Papa, mishi dhe trupi i tij janë turqit”.*<sup>148</sup>

Kalimi i ushtrisë Osmane në qendër të Evropës ka tmerruar Evropën. Kalimi i turqve në ngushticën e Galipojës, fitorja e thellë në Betejën e Kosovës më 1389, fitorja e muslimanëve kundër aleancës kryqtare në Nikopolis më 1396, pushtimi i Selanikut më 1430, pushtimi i Varnës më 1444, lufta në Kosovë më 1448 deri në pushtimin e Kostandinopojës më 1453 ishin kanosje e drejtpërdrejtë për Evropën. Italia qe rrezikuar nga osmanët në Venedik dhe në Sicili.<sup>149</sup> Në këtë periudhë Evropën e shpëtoi, sipas mendimit të përgjithshëm, vdekja e sulltan fatihut, Mehmetit II dhe përçarja e trashëgimtarëve të tij rreth ndarjes së pushtetit.<sup>150</sup>

Ngritja e Perandorisë Osmane dhe shtrirja e saj në një hapësirë gjeografike shumë të madhe nuk ishte vetëm rrezik ushtarak, por edhe rrezik ekonomik. Në Perandorinë Osmane tregtia dhe toleranca fetare musiliane ndaj feve qiellore (judaizmit dhe kristianizmit) mundësonin këmbimin e mallrave dhe vlerave të ndryshme, por edhe të robërve që ishin zënë gjatë luftërave apo që ishin blerë nga disa shtete të krishtera apo nga tregtarë robërish. Kjo e shtyri papën Klementin VII në

---

<sup>148</sup> Sipas: B. Lewis, op. cit., fq. 27.

<sup>149</sup> F. Hiti, op. cit., fq. 543-553.

<sup>150</sup> Franc Babinger, *Mehmet Pushtuesi dbe koha e tij*, Prishtinë, 1989. Krhs.: Halil Inalxhik, *Perandoria Osmane*, Gjilan, 2001.

vitin 1527 të sjellë Bulën, me të cilën përjashton dhe anameton:

“...të gjithë që (u dorëzojnë) saracenëve, turqve dhe armiqe të tjerë të emrit të kristhterë kuaj, armë, hekur, tel, plumb, bakër, tunxh, sulfur, shalitvu dhe çdo gjë të përshtatshme për bëjen e artilerisë dhe të instrumenteve, armëve dhe pjesëve të tjera për të sulmuar, me çka ata luftojnë kundër krishterë... ”.<sup>151</sup>

Burime kryesore të informatave për turqit janë robërit e ikur apo të liruar nga Perandoria Osmane, por edhe refugjatët e ikur nga trojet e pushtuara nga osmanët.

Shekulli XVI shënon një ndryshim, sepse karakterizohet me një lëvizje të evropianëve drejt Turqisë. Për shkak të politikës dhe fleksibilitetit religjioz dhe politik dhe zhvillimit të hovshëm kulturor, shkencor dhe aspektave të tjera të Perandorinë Osmane, evropianët hynin pa vështirësi në Turqi, me dallim nga politika e mbyllur, egosite evropiane dhe pengesat e shumta, që nuk i linin qytetarët muslimanë të hynin në vendet evropiane. Nga vizitorët evropianë në Perandorinë Osmane kishte pelegrinë, pastaj tregtarë fillimi i shërbimit nga Italia, Venediku dhe Gjenova, më vonë edhe nga Franca, Holanda, Anglia etj. Disa nga këta udhëtarë përshtypjet e tyre i kanë shkruar në libra e letra, duke i kontribuar kështu botëkuptimit religjioz dhe politik evropian për turqit.<sup>152</sup>

Shekulli XVI e pas karakterizohet edhe me tregtinë e diplomatëve dhe vizitorëve të tjerë, të cilët shkruan raporte të gjera e edhe libra të vëllimshëm për Turqinë. Kjo kategori ndërmjetësuesish kishte përparësi në raport me kategoritë e tjera, sepse qëndronte më gjatë mes muslimanëve dhe kishte mundësi për kontakte më të ngjeshura me banorët lokalë muslimanë dhe jomusli-

---

<sup>151</sup> B. Lewis, op. cit., fq. 28.

<sup>152</sup> Thomas W. Arnold, op. cit., fq. 133-146.

manë. Për këtë qëllim me rëndësi janë letrat e Ogier Ghiselin Busbecqu-t, flaman, i cili ishte ambasador i Mbretërisë Romake në Stamboll nga viti 1554 deri në vitin 1562. Kemi edhe raporte të misionarëve të tjerë me rëndësi të madhe për rrrethanat në Perandorinë Osmane.

Robërit, refugjatët, pelegrinët, tregtarët dhe diplomatët kanë ndikuar shumë për krijimin e një botëkuptimi të plotë për Turqinë. Kontribut kanë dhënë edhe shënimet e udhëtarëve të ndryshëm, të ushtarëve, që kishin luftuar kundër muslimanëve, të spiunëve evropianë, që kryenin detyra për shtetin apo për individë me ndikim në shtet dhe të aventurierëve të tjerë.

Nuk duhet harruar edhe një kategori e vizitorëve, siç janë mjekët. Periudha pas shekullit XVI në aspekt të mjekësisë ishte në favor të evropianëve, kështu që rritej nevoja për mjekët evropianë. Ata çanin edhe atje ku vështirë mund të depërttonin të tjerët, nëpër shtëpi, në mjediset më intime. Kjo kategori ka ofruar të dhëna me vlerë të madhe, por njoftimet e tyre duhet të merren me rezervë sepse numri i mjekëve ishte i kufizuar dhe ishin të ngarkuar me paragjykime ndaj muslimanëve.

Një kategori tjeter me rëndësi ishte grupei artistëve, të cilët me kërkesë të ndonjë personaliteti musliman apo me vetëdashje kishin vizituar Turqinë dhe kishin portretuar andej-këndej personalitete dhe gjësende të tjera me rëndësi. Herë-herë këta artistë ishin në përcjellje të pelegrinëve autoritativë, të cilët i skiconin dhe njëkohësisht jepnин shumë informata për personalitete, veshjen, ushqimin dhe vendbanimet.

Kategoria vijuese është ajo e artistëve të tjerë, të cilët nuk e kishin vizituar Turqinë, por që, nga frymëzimet e tjera dhe nga imagjinata, ilustronin e portrettonin luftëtarë turq, bënin motive nga luftërat, ngajeta,

mënyra e banimit, veshja, ushqimi dhe momente të tjera të jetës së muslimanëve.<sup>153</sup>

Mund të përfundohet se burimet e informacionit evropianë për Turqinë janë të ndryshme: popuj të ndryshëm, katolikë dhe protestantë, tregtarë dhe misionarë, ushtarë dhe diplomatë, secili kishte pikëpamje tjetër, si rezultat i përvojave dhe interesave të ndryshme.<sup>154</sup>

Temat që mbizotëronin në informacionet e perëndimorëve janë nga më të ndryshmet. Në aspekt në të gjellëtarisë perëndimorët veçojnë *pijen e kafesë*, nga të gjitha shtresat, madje edhe në vende publike. Mirëpo, përkundrejt mbizotërimit të kafesë, ndalohej pirja e alkoolit. Një bari islandez, në rrugë për në Algjeri, si rob lufte, vrojtoi se në anjen muslimane kishte raki *brendi*, të cilën ekuipazhi i anijes ua jepte robërve jomuslimanë, por jo edhe muslimanëve. Për vete ata përdornin ujë. Ky ishte vrojtim edhe i vizitorëve të tjerë. Si ilustrim do të cekim një poezi mbi pijen e alkoolit të autorit anglez të dramës William Congreve, i cili në vitin 1700 shkroi:

*Pirja e alkoolit është çoroditje e krishterë  
E panjobur për turqit dhe persianët  
Lërini budallenjtë Muhammedanë  
Të jetojnë sipas irregullare pagane  
Të mallkuarit le të bezdisen me gotën e çajit dhe të kafesë  
Le të këndojnë zonjat britanike  
Le të ngremë dolli për mbretin tonë  
Kurse “kaçën” lerjani sultanit dhe sufisë tuaj.*  
**(The Way of the World, pjesa IV, pamja 1)**<sup>155</sup>

---

<sup>153</sup> Shih: Sejid Muhammed Dikën, *Studime mbi historinë e shtetit osman*, Shkup, 1413/1994, fq. 92 etj. Po ashtu: Taha Mudever, *Andaluzja dhe Perandoria Osmane*, Shkup, 1415/1995, fq. 61-96.

<sup>154</sup> Shih: Hisam Džait, *Europa i islam*, botimi II i plotësuar, Sarajevë, 1989, fq. 22-26.

<sup>155</sup> B. Lewis, op. cit., fq. 32.

Temë tjetër e çdo lloj shkrimi është *frika* nga turku, nga i paftuari në Evropë dhe nga rreziku për kristianizmin. Edhe *Othello* i Shekspirit kur thotë “*turkun e lig në turban*” shfaq idenë e përhapur në Evropë për islamin dhe muslimanët.<sup>156</sup>

Mirëpo, kishte edhe të tillë, si udhëpërshkruesi francez Jean Thevenot, i cili e vizitoi Turqinë në vitin 1652, dhe vrojtoi se turqit nuk janë djaj të mëdhenj, barbarë dhe njerëz të pafe. Përkundrazi, nëse bisedon me ta, pohon ai, do të bindesh se ata janë njerëz të mirë që i ndjekin si dhuhet urdhurat që na i jep vetë natyra jonë, që të tjerëve t'u bëjmë atë që dëshirojmë të na bëhet neve.<sup>157</sup>

Si temë tjetër me rëndësi për turqit përmendet mikpritja, nderi, kthjellësia dhe toleranca.

Ndërkaq, ndër temat e liga theksohen: despotizmi dhe epshet e shfrenuara.

Pse ndodhi kështu? Nëse i hidhet një shikim psikikës turke, këto dy ligësi nuk janë më të shprehura se në cilindo vend evriopian. Atëherë, ku është shkaku? A mos është në faktin, se shumë herë ligësitë vetjake evropianët i kanë projektuar në popujt dhe kulturat e tjera?

Ne do të shohim se sulltani, ndonëse në shikim të parë me të drejta të pakufizuara, i nënshtronhet ligjit islam si edhe çdo qytetar tjetër. Njohësi i mirë i sistemeve të qeverisjes evropiane, Nikolla Makiaveli, monarkinë e Turqisë e shihte më funksionale se sistemet qeverisëse evropiane. Si shembull mori Turqinë dhe Francën:

*“Shembujt e këtyre dy lloj sundimere të ndryshme, në kohët tonë janë Turqia dhe Franca. Tërë monarkinë e Turqisë e sundon një sundues, të tjerët janë të nënshtruarit e tij; ai e ndan shtetin në sanxhakë dhe atje dërgon qeveritarë të cilët i transferon e i ndërron*

---

<sup>156</sup> Ibid., fq. 32.

<sup>157</sup> Ibid., fq. 32.

*sipas dëshirës së vet. Por, mbreti francez gjendet midis një morie zotërinjsh, të cilët nënshtetasit e tij i kanë parë ngaherë në ato pozita dhe gëzojnë respekt: kanë privilegje të trashëguara, të cilat mbreti nuk mund t'uua marrë pa e rrëzikuar veten”.*<sup>158</sup>

Ja vrojtimet e ambasadorit francez në Stamboll Choiseul-Gouffier, në tentimin e tij për ta bindur sulltanin për reforma:

*“Gjërat këtu nuk janë si në Francë, ku mbreti është zotëri i vërtetë; këtu duhet bindur ulemanë, juristët, ata që kryejnë detyra të larta dhe ata që më nuk kryejnë detyra të larta”.*<sup>159</sup>

Sa janë të qëndrueshme këto pohime dhe prej kur datojnë pohimet për seksualizmin dhe senzializmin e shfrenuar musliman? Do të thoshim se pohimet janë të vjetra dhe reflektojnë natyrën evropiane të senzializmit. Poligamia, parimisht e lejuar në islam, nuk është pasqyrë e perversionit dhe e shfrenimit të muslimanëve. Këtë e kanë pohuar edhe kundërshtarët e rreptë të islamit, si p.sh. D. Kalajiq:

*“Poligamia islame është institucion më civilizues, që s’ka të krahasuar dhe që zë fill në parimet e dashurisë dhe është mbrojtje e sigurt nga anarkia dhe promiskuiteti seksual ...”*<sup>160</sup>

Kurse shkrimtari i madh francez, Stendali, pohon:

*“Nën tendën e zezë të arabit beduin duhet kërkuar shembullin dhe atdheun e dashurisë së mirëfilltë... Shihet se ne kemi qenë barbarë në raport me Orientin kur kemi shkuar që këtë dashuri ta çrrregullojmë me luftërat tona kryqtare”.*<sup>161</sup>

---

<sup>158</sup> Nikolla Makiaveli, Sundimtari, Prishtinë, 1977, fq. 35-36.

<sup>159</sup> B. Lewis, op. cit., fq. 32.

<sup>160</sup> Dragos Kalajic, *Islamski ustavak protiv modernog svijeta*, Argumenti, 2/1982, Rijekë, fq. 64-65.

<sup>161</sup> Stendali, Mbi dashurinë, kapitulli LIII, sipas: Rozhe Garodi, *Živi Islam*, Sarajevë, 1990, fq. 135.

Shekulli XVIII shkon drejt veterishqyrtimit. Kjo frysme vazhdon edhe me tej, te ndryshoje konceptet. Muslimani nuk eshtë me tressik për Evropën, as tressik për fenë e tyre. Mirépo, kriza shpirtërore-morale e Evropës i nxit evropianët të prodhojnë armiq e tressiqe te të tjerët, e sidomos ndër muslimanët për t'i arsyetuar luftërat shpirtërore dhe fizike kundër muslimanëve që kanë për qëllim shfrytëzimin politiko-ekonomik.<sup>162</sup>

Perspektiva s'është e qartë: disa parashohin përplasje civilizimesh, disa paqe (ndjellakeqe) e disa zhdukje (luftë kryqtare, G. Bush) për të gjithë që nuk janë me ta, për të demonstruar kështu moralin dhe filozofinë e qytetërimit të tyre, të cilin para disa dekadash O. Spengler e ka përkufizuar si "shkatërrimi i Perëndimit".<sup>163</sup> Luftërat gjatë disa dekadave të fundit në Palestinë, Kosovë, Bosnjë, Filipine, Indonezi, Çeçeni, Afganistan, Irak, Al-gjeri, janë treguesi më i mirë se gjeneza pagano-judiaste-kristiane e Evropës qëndron si shpata e Damokleut mbi kokën e muslimanëve.

Mbetet të shihet nëse integrimi i Ballkanit Jugor në Evropë, për të cilin është bërë shumë fjalë, pastaj lufta kundër terrorizmit global 'dritare' drejt proceseve integruuese dhe të paqes botërore.

---

Mbi historikun e seksit në islam shih studimin jo gjithnjë korrekt të Rej Tanahil, *Čovek i seks*, Beograd, 1981, fq. 218-241.

Për aspektet e brendshme të seksit në islam shih studimin tejet interesant dhe frysues të Abd Al-Wahab Bouhdiba, *Seksualiteti në islam*, Gjilan, 2001.

<sup>162</sup> Shih: Hisam Džait, op. cit., fq. 22-26; Fikret Karcić, *Muslimani Balkana – Istočno pitanje u XX vijeku*, Tuzla, 2001.

<sup>163</sup> Osvald Spengler, *Propast Zapada*, I-IV, botimi II, Beograd, 1990.

## Religjioni, shpirtërorja dhe shëndeti mendor

Bindjet religjioze<sup>164</sup> dhe vuajtjet e ndryshme korrespondojnë qysh nga fillimi i komunitetit njerëzor, për të vazhduar gjatë historisë nëpër të gjitha kulturat dhe civilizimet.<sup>165</sup> Po ashtu, lidhjet e bindjeve fetare dhe të shëndetit mendor nga një anë dhe të bindjeve religjioze dhe fuqive të errëta, të këqija, satanike, demoniane, nga ana tjetër, janë të pranishme në etiologjinë e shumë çrrégullimeve mendore të njerëzve.<sup>166</sup> Në përputhje me këto bindje e perceptime edhe trajtimi i çështjes së religjiozitetit dhe të shëndetit mendor në të kaluarën ishte i shumëlojshëm: religjioz, psikologjik, psikiatrik, ateistik etj. Nëse i hedhim një sy literaturës përkatëse do të shohim se popujt e ndryshëm kishin botëkuptime të

---

<sup>164</sup> Fjala ‘religion’ rrjedh nga gjuha latine ‘religio’ dhe kap domethëniet të shumta. Shih: Ekrem Murtezai, *Fjalor i fave*, Prishtinë, 2000, fq. 403 - 406. Milan Vujaklija, *Leksikon stranih reči i izraza*, Beograd, 1980. Në kuptimin terminologjik, religion d.m.th. ‘rivendosje e sërishtme e lidhjes së humbur’, apo ‘lidhja e njeriut për diçka që e transcendon’. Po ashtu, ‘religioni është sistem i të kuptuarit, besimit, mirësjelljes, ritualeve dhe ceremonive, me anë të të cilave individët apo bashkësitë e vënë veten në raport me Zotin apo me botën mbinatyrore dhe shpesh në raport të një grupi me tjetrin’. (Sipas: Syed Arshad Husain & Osman Sinanović, *Uloga religije u očuvanju mentalnog zdravlja*, në: *Duhovnost i mentalno zdravje* (më tej: DMZ), Sarajevë, 2002, fq. 13).

<sup>165</sup> Për trajtimin mjekësor dhe religjioz të të sëmurëve mendorë gjatë historisë, me theks të veçantë në Turqinë e hershme nën traditën islame shih: Ayhan Songar, (Turqi), *Social-Psychiatric Institutions in Old Turks Under Islamic Tradition*, [www.islamnet.com](http://www.islamnet.com), pp. 1-5.

<sup>166</sup> Shih: Xhorxhi Frejzer, *Zlatna grana*, Beograd; Emil Dirkem, *Elementarni oblici religioznog života*, Beograd, 1982.

shëndosha, por edhe shtrembërime ideore.<sup>167</sup> Në shumë raste, varësisht nga rrethanat sa ishte një popull afër fesë së mirëfilltë, predikuesi fetar, kleriku apo mjeku populor e kishin fjalën kryesore. Kjo gjendje zgjati deri në shekujt XI-XII, për t'u ndarë më dukshëm vetëm pas shekullit XV.<sup>168</sup>

Ritmet e shekullarizmit dhe të scientificimit të medicinës, sikur edhe të jetës në tërësi<sup>169</sup>, sollën që këto dy drejtime (feja dhe medicina) të ecnин rrugëve të ndryshme. Themelimi i institucioneve të veçanta për të sëmurët mendorë, si dhe metodat fizike të trajnimit në medicinë, e veçan në psikiatri, thelluan jazin ndërmjet këtyre dy disiplinave, drejtimeve.<sup>170</sup>

Me përparimin e medicinës dhe me shfaqjen e risive dhe të teorive të reja shkencore, fshehtësitë e çrregullimeve mendore, mjekësia i shpjegonte në të shumtën si pasojë e çrregullimeve themelore strukturore dhe biokimike, e jo më sipas konceptimeve të mëhershme. Duke e marrë parasysh se në botën e krishterë të sëmurët mendorë klerikët i shikonin formalisht si person të përshkuar nga xhindet e djajt, sjellja e tyre jo e zakonshme nga ana e ekspertëve të shëndetit mendor shpjegohej si çrregullim i mendjes.

---

<sup>167</sup> Shumë ajete kur'anore tregojnë se popuj të tërë që nuk kanë respektuar parimet e shëndosha janë zhdukur fare apo kanë pësuar pjesërisht. Populli i Nuhit, Hudit, Salihut, Ibrahimit, Musait, e të tjere janë shembuj tipikë për pothemet tona. Shih njërin nga përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe: të Feti Mehdiut, Prishtinë, 1985; Hasan Nahit, Prishtinë, 1988 apo Sherif Ahmetit, Prishtinë, 1988.

<sup>168</sup> M. A. Javed, *Religija...*, në: DMZ, Sarajevë, 2002, fq. 47-48.

<sup>169</sup> Seyyid Hossein Nasr, Susret čovjeka i prirode (Duhovna kriza modernog čovjeka), Sarajevë, 2001/1422 h.; Al-Attas, *Islam and Secularism*, Kuala Lumpur, Malajzi, 1970.

<sup>170</sup> Shekullarizimin dhe vulgarizimin e jetës dhe të vetë njeriut nga njeriu filozofi kroat Rudi Supek e elaboron si vijon: "Disa sekonda në historinë e këtij planeti, sa po zgjatë revolucioni industrial, i kundërviben tërë asaj urtësie mbi të cilën zë fill puna shekullore, e ngadalshme dhe thuajse e padukshme". R. Supek, *Ova jedina zemlja*, Zagreb, 1978, fq. 155.

Por, në shumë kultura ende mbizoterojnë mendimet se sëmundjet mendore dhe trajtimi i tyre janë të lidhura ngushtë me botëkuptimin dhe perceptimin se mëkatit, vuajtjet dhe sëmundjet mendore janë pasojë e një përcaktimi nga hyjnorja apo madje e dorëzimit forcave të djajve.

Me gjithë faktin se feja ka rëndësi të pakontestueshme për medicinën dhe sidomos për shëndetin mendor, studimet empirike që kanë hulumtuar përmasa të ndryshme të shëndetit mendor tregojnë se religioni, nën ndikimin e bindjeve shekullare, ishte shpërfillë nga ekspertët dhe institucionet e përgjithshme përkatëse të shëndetit dhe veçanërisht nga ato të shëndetit mendor. Në revistat më të njoitura botërore për psikologji / psikiatri (*American Journal of Psychiatry*, *British Journal of Psychiatry*, *Canadian Journal of Psychiatry* dhe *Archives of General Psychiatry*)<sup>171</sup> por edhe në studimet tjera më me renome të kësaj natyre, variablet religioze qenë përjashtuar.<sup>172</sup>

Edhe pse shekulli XX ishte dëshmitar i ndryshimeve domethënëse në besim dhe spiritualitet<sup>173</sup>, interaksiioni i religionit dhe i shëndetit mendor shiheshin si dy gjëra që ndihmojnë njëra-tjetrën. Të dyja së bashku ishin tejet efektive për t'i kuptuar dhe për t'i shëruar shumë

---

<sup>171</sup> Në tërë këto shkrime, sipas statistikave, vetëm 3% janë të karakterit religioz, që tregon për një shpërpjesëtim me bindjet dhe nevojat e të sëmurëve mendorë dhe për një dehumanizim të injeksisë përgjithësisht, sepse ekspertët ndjekin egon e tyre e jo kërkesat e patienteve. Shih: O. Sinanović & I. Pajević, *Naučna valorizacija ...*, në: DMZ, op. cit., fq. 79.

<sup>172</sup> Shih disa tregues të shpërfilljes së religionit në mostratimin e të sëmurëve mendorë: Syed Arshad Husain, Osman Sinanović, *Uloga religije...*, në: DMZ, op. cit., fq. 48.

<sup>173</sup> Hulumtimet e një anketimi të vitit 1984 në SHBA tregojnë se 50% të psikologëve, dhe vetëm 10% të popullit pojuan se nuk janë religiozë, kurse 33 % të psikologëve klinikë dhe 72% të popullit pojanë se feja përcakton jetën e tyre. Sipas: Osman Sinanović, Izet Pajević, *Naučna valorizacija uticaja religioznosti na mentalno zdravje*, në: DMZ, fq. 78.

sëmundje mendore. Kështu u pranua përgjithësisht se religjioni, aspekte të tij religjioze dhe praktike, ndikojnë në shëndetin mendor.

Edhe studimi empirik në Minesotë, ShBA, mbi pacientët psikiatrikë, tregon se religjioni dhe bindjet religjioze kanë rëndësi të madhe në jetën e shumicës së pacientëve. Pacientët më religjiozë kishin dhe shfaqnin shkallë të lartë të kënaqësisë jetësore, lumturi më të madhe dhe pasoja më të vogla negative psikologjike nga përvojat traumatike nëpër të cilat kishin kaluar.

Religjioni, po ashtu, shihet si një mbrojtje, parambrojtje e fuqishme kundër shumë lloje neurozash<sup>174</sup> dhe çrrégullimesh të shkaktuara nga përdorimi dhe keqpërdorimi i substancave të ndryshme. Zbatimi i Kur'anit dhe hadithit është parambrojtje por edhe trajtim adekuat i pakon-testueshëm në psikoterapi dhe shkenca të ngjashme.<sup>175</sup>

Sipas konceptimit kur'anoro-sunetik njeriu është simbiozë e materiales dhe e shpirtërores, por edhe ruajtës i baraspeshës ndërmjet materiales dhe shpirtërores.<sup>176</sup> Mirëpo, të kuptuarit e porosive kur'anore-sunetike dhe të traditës fetare-islame nuk është në vetvete i mjaftueshëm, pa ndihmesën e predikuesit fetar. Duke e shkrirë vetveten në porositë hyjnore, ky bëhet interpretues i tyre dhe mbjell te bashkëbiseduesi të vërtetat e shëndosha.<sup>177</sup>

---

<sup>174</sup> Hulumtimet tregojnë se vetëm 2% të ushtarëve që marrin pjesë në një luftë nuk do të kenë pasoja për shëndetin e tyre. Andaj religjioni është më se i nevojshëm edhe në kohën e zhvillimit të luftës edhe pas luftës. Shih: I. Pajević, *Uticaj religioznosti ...*, në: DMZ, op. cit., fq. 84.

<sup>175</sup> Për stresin, kurimin dhe mjetet e kurimit shih: Shahid Athar M. D., *Modern Stres And Its Cure From Qur'an*, në: [www.crescentlife.com](http://www.crescentlife.com), fq. 1-3. Krhs.: Ibn Kajim el-Dzvezij, *Poslanikova medicina*, Sarajevë, 1422/2001. Mustafa Mahmud, *Qur'anic Psychology*, [www.crescentlife.com](http://www.crescentlife.com).

<sup>176</sup> Shih gjerësisht: Mohammad Osman Najaty, Kuwait, *The Concept of Mental Health in the Holy Qur'an and the Hadeeth*, [www.islamnet.com](http://www.islamnet.com).

<sup>177</sup> Ekzistojnë edhe shkencëtarë që mendojnë se predikuesi fetar mund të ndihmojë, por vetëm në çështjet periferike, si në përgatitjen e mjedisit, për-

Eliminimi i urrejtjes, zilisë, egocentrizmit dhe veseve të shumta përmes virtuteve si durimi, avdesi, namazi, barazia, vëllazëria e modestia, është shkollë që ka dhënë provimin gjatë tërë historisë, por edhe në luftën tonë jo të largët në Kosovë.<sup>178</sup>

Reabilitimi nga depresioni tek pacientët e hospitalizuar, sipas Koenigut dhe bashkë-punëtorëve të tij (më 1998), është i mundur në koreacion pozitiv te religioziteti intrinzist dhe te remisionet më të hershme.<sup>179</sup> Pasi kjo është fushë pak e njojur për ne, do të japim disa propozime se si njeriu besimtar por edhe mësuesi i tij religioz do të duhej të vepronin për ta arritur një qetësi psikike:

- përforcimi i të vërtetave bazore të besimit;
- këmbëngulja për aplikimin e obligimeve praktike që dalin nga bazat e besimit;
- praktikimi i veprimitarive pozitive që nuk janë strikte;
- katër metoda:
  - 1) kontrolli i komunikimit me të tjera;
  - 2) kontrolli i të folurit;
  - 3) kontrolli i të ushqyerit;
  - 4) kontrolli i të fjeturit.
- kontrolli vigilant i baraspeshës psikike, zbulimi i shpejtë i simptomave dhe eliminimi i shpejtë.<sup>180</sup>

Bindjet religioze, pastaj traditat religioze dhe tiparet socio-kulturore kanë ndikim edhe në pengimin e shpesh-

---

gatitjen morale të të sëmurit etj. Shih: Liljana Moro, *Mentalno zdravje i religija*, në: DMZ, op. cit., fq. 552-53.

<sup>178</sup> Shih për medicinën e Pejgamberit a.s.: Ibn Kajim el-Devzij, op. cit. Nga aktualiteti ynë kosovar e ballkanik shih romanin: Milazim Krasniqi, *Fotografitë e kujtimeve*, Prishtinë, 2002, fq. 5 – 133.

<sup>179</sup> Shih: Syed Arshad Husain, Osman Sinanović, *Uloga religije..., DMZ*, fq. 49.

<sup>180</sup> Shih: Sead Seljubac, *Neke islamske metode za ocuvanje i unapredjenje psihičkog zdravlja*, në: DMZ, op. cit., fq. 68.

tësisë së suiciditetit, d.m.th. ndikon në ndryshimin e shkallës dhe në seriozitetin e mortalitetit suicidal. Këtë e dëshmon shkalla e lartë e suiciditetit, pastaj e perversioneve dhe e degjenerimeve të tjera në vendet e zhvilluara industriale në Evropë, Japoni dhe ShBA.<sup>181</sup>

Mirëqenia shpirtërore dhe psikologjike, krahës dallimeve, ndihmojnë njëra-tjetrën në frenimin e ‘deviantizmit’. Disa shkencëtarë theksojnë se psikiatri që punon me pacientë religjiozë duhet të provojë të bashkëpunojë me mësuesin shpirtëror të pacientit, nëse pacienti e ka atë. Përfillja e religjozitetit të mirëfilltë gjatë trajtimit psiko-terapik të të sëmurit mental, mendor, qoftë në bashkëveprim me mësuesin religjioz, do të ishte faktor pozitiv dhe i suksesshëm në përpjekjet për ruajtjen e shëndetit mendor.<sup>182</sup> Është me rëndësi të madhe që individët me bindje religjioze të ekzaminohen me kohë për vlerësimin dhe mjekimin e çrrëgullimeve mendore.

Ka kaluar periudha që të sëmurët mendorë të konsiderohen ‘turp’ e jo realitet, të sëmurë që kërkojnë ndihmesë kompetente. Modelet arkaike të të menduarit rrëth të sëmurëve mendorë duhet të ndryshojnë te të gjithë ata që preokupohen me rehabilitimin dhe mjekimin e tyre, qoftë të mjekësisë institucionale qoftë të asaj alternative. Religjioza, shpirtërorja do të kenë sukses në kurimin mendor vetëm në bashkëveprim të plotë me mjekësinë. Ky është interes i pacientëve si individë, por edhe i shoqërisë si grup më i madh apo si popull.

Moralisht i degjeneruar dhe shpirtërisht i zbrazur, pas çrrënjosjes së gjatë, njeriu, është e qartë, nuk mund t'i zgjidhë problemet e veta, ato të njeriut bashkëkohor, ndaj është e nevojshme të ekzistojë alternativa e filozo-

<sup>181</sup> Krahaso: Alija Izetbegoviq, *Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*, Prizren, 1992. Dragoš Kalajić, *Smak sveta*, Beograd, 1979.

<sup>182</sup> Shih: Syed Arshad Husain, Osman Sinanović, *Uloga religije..., DMZ*, fq. 20.

fisë aktuale të jetës, nevoja që njeriu t'i kthehet vetes dhe të lirohet nga obsesioni antropocentrist kundrejt botës që e rrethon, duke e përshkuar trënjosjen e tij tokësore dhe shpirtësinë qullore, që do të rezultojë me njerëzish-mërinë (humanitetin).

Jemi të bindur se serioziteti i çështjes do ta tërheqë vëmendjen e ekspertëve të shëndetit mendor në punën e tyre të ardhshme.

# Eutanazia – vdekje e mëshirshme

## Hyrje

*Eutanazia* është temë që gjatë gjithë historisë ka nxitur diskutime kontraverze. Çështjet mbi vdekjen ecin paralelisht me çështjet mbi jetën. Vdekja është fakt jetësor dhe ajo s'është veçse fundi i jetës. Medicina bashkëkohore dhe potencialet e saj (madje edhe) të manipulimit me jetën rezultojnë me pyetjet dhe problemet e reja të *eutanazisë*. Sociologjia dhe shkencat e afërme me sociologjinë vetëm para pak kohe kanë filluar të preokupohen e ta ndjekin veprimtarinë medicinale, e me këtë edhe me problemin e *eutanazisë*. *Eutanazia* dhe problemet që vijnë me të ishin çështje anësore të ndodhive dhe të interesave shoqërore.<sup>183</sup>

Në vendet evroperëndimore rreth *eutanazisë* zhvillohen dekada me radhë diskutime të ashpra, dërsa te ne, në trojet shqiptare, sidomos në Kosovë, kjo temë nuk ka tërhequr vëmendjen dhe interesimin as të ekspertëve të fushave drejtpërdrejt të interesuara as të intelektualëve dhe të opinionit të përgjithshëm. Mbi *eutanazinë* dhe

---

<sup>183</sup> Shfletimi i librave sociologjikë apo i revistave që trajtojnë punime sociologjike te ne dëfton se *eutanazia* nuk trajtohet thuajse fare. Kohëve të fundit kemi një interesim sipërfaqësor edhe në Kosovë. Shih: Naser Ramadani, *Bioetika – Qasjet etike në mjekësinë moderne*, Prishtinë, 2002, fq. 134 – 138 dhe një përkthim: Shahid Athar, *Euthanasia – Vdekja e Ndihmuar nga Mjeku*, në revistën elektronike “Horizonti”. Shih: [www.horizonti.com/artikulli\\_2002\\_10\\_3\\_0053.php](http://www.horizonti.com/artikulli_2002_10_3_0053.php) 02-12-25, fq. 3-8.

problemet e tjera të sotme të civilizimit bashkëkohor duhet diskutuar mbi baza shkencore dhe intelektuale dhe nuk duhet heshtur para këtyre problemeve. Polemikat dhe diskutimet e deritanishme zhvillohen rrëth tendencave dhe kërkesave konkrete për ligjësimin e *eutanazisë* dhe të kundërshtimeve rigorozë të saj, që eutanazinë e konsiderojnë si akt kundërnjerëzor dhe kundërfetar, pikëpamje “që e dëmton konceptimin e ruajtjes së shëndetit”.<sup>184</sup>

## Eutanazia në rrjedhën e historisë

Shprehja ‘*eutanazija*’<sup>185</sup> në përkthimin e fjalëpërfjalshtëm do të thotë ‘vdekje e lehtë, e mirë’. Që nga paraqitja

<sup>184</sup> Shih gjerësisht: Esmina Avdibegović – Osman Sinanović, *Religijsko-etičko-pravni pogled na ljekarsku pomoć u samoubistvu i eutanaziji*, në: Grup autorësh, Duhovnost i mentalno zdravlje (më tej: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ), Sarajevë, 2002, fq. 1.

Është indikative se tendencat *eutanazi* mbështeten më së shumti nga njerëzit jofetarë, shekullarë. Shih: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, op. cit., fq. 97- 98.

<sup>185</sup> Greqisht: ‘eu’ = e lehtë, e mirë dhe ‘*thantos*’ = vdekja).

Letica S. (1985), *Medicinska sociologija*, Zagreb, sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr/WPozaić](http://www.ftidi.hr/WPozaić), fq. 1.

Milan Vujaklija pohon se fjalë “*eutanazi*” (nga greq, euthanasia) d.m.th. vdekje e lehtë dhe e butë; fikje e jetës pa dhembje të vdekjes; zbutje e vdekjes duke i dhënë të sëmurit narkotikë (vetëm për t’ia lehtësuar, e assesi për t’ia përshtypet). (M. Vujaklija, *Leksikon stranih reči i izraza*, Beograd, 1980, fq. 305).

*Eutanazinë* muslimanët e përkufizojnë si: “Lehtësim i vdekjes për personin pa shkaktuar dhembje e për arsyen të zgogëlimit të vuajtjeve të pacientit, në mënyrë aktive apo pasive”. Jusuf el-Kardavi, *Surremene fetve (Izbor)*, Tuzla, 1997, fq. 77.

M. Klaić, *Rječnik stranih rječi i izraza*, Zagreb, dallon tri kuptime thelbësore: 1. vdekja e lehtë, 2. lehtësimi i mundimit dhe dhembjes së vdekjes me anë të narkotikëve etj. dhe 3. mbytja e të sëmurëve të pashërueshëm. Sipas: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 2.

*Sintagmat* më të shpeshta lidhur me *eutanazinë* në literaturën e huaj dhe tonën, sidomos në anglishtë, janë si vijon:

e saj në histori e deri më sot nacioni i eutanazisë është konceptuar dhe trajtuar ndryshe-ndryshe, varësisht nga këndvështrimi dhe bindjet e individit, të grupit apo të shoqërisë në përgjithësi.

*Enciklopedia* prestigjioze amerikane për mjekësi dhe shëndet *eutanazinë* e përkufizon si “metodë apo akt me të cilin te individi që pëson vuajtje të vazhdueshme dhe dhembje nga sëmundja terminale, realizohet vdekja pa dhembje”.<sup>186</sup>

Në kuptimin burimor *eutanazia* përcakton dëshirën dhe lutjen e njeriut për vdekje të mirë, d.m.th. të lehtë, të shpejtë dhe pa dhembje. Kuptimi vijues i *eutanazisë* është kujdesi pozitiv, angazhimi si dhe kurimi që vdekja, sa është e mundur, të jetohet pa dhembje trupore dhe zemërngushtësi – duke e respektuar edhe jetën edhe ardhjen natyrore të vdekjes. Kuptimi i tretë i *eutanazisë* është bashkëkohor dhe, krahas dy kuptimeve të para, përfshin edhe kuptimin agresiv, ‘*marrjen e qëllimit dhe të dhunshme të jetës së njeriut*’.<sup>187</sup>

Sipas kuptimit të fundit, të tretë, që e miraton edhe Kisha katolike në dokumentet e veta, “*me shprehjen eutanazi kuptohet në akti apo në lëshimi, i cili, sipas natyrës së vet apo me qëllimin e vet, shkakton vdekjen në mënyrë që kësijoj të mënjanohet çdo dhembje ...*”.<sup>188</sup>

- 
- *Mercy killing* (mbytja nga mëshira) – rëndom ka të bëjë me *eutanazinë* e bërë nga ana e kushërirëve apo miqve që t'i lehtësohen dhembjet të sëmurit;
  - *Helping someone to die* (ndihmesa, që i jepet dikujt të vdesë);
  - *Assisted suicide* (ndihmë gjatë suicidit) – sigurimi i dozës vdekjeprurëse të ilaçeve për dikë që dëshiron ta përfundojë jetën;
  - *D. N. R.* – Do not resuscitate (të mos shpëtohet);
  - *Palliative care apo hospice approach* (kurimi zbutës) – lidhet me lëvizjen Hospice, të përhapur në Evropën Perëndimore. Mjekët dhe infermieret mëtojnë t'ia zbusin vuajtjet pacientit duke kërkuar rrugë të qetë dhe të thjeshtë deri në vdekjen natyrore.

<sup>186</sup> *Medical and Health Encyclopaedia*, New York, (1972 ?), fq. 359.

<sup>187</sup> Sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr/WPozaić](http://www.ftidi.hr/WPozaić), fq.1.

<sup>188</sup> Shih: *Sveti zbor za nauk vjere*, Deklaracija o eutanaziji, br. II, në: Pozaić, V., *Život dostojan života. Eutanazija u prosudbi medicinske etike*, FTI, Zagreb, fq. 102-103, sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 2.

Në kulturën helene *eutanazia* kishte kuptimin e vdekjes së bukur e të lumtur, kurse në atë greko-romake kuptimin e vdekjes fisnike e të guximshme. Në Romën e vjetër nacioni i *eutanazisë* kishte domethënje praktike dhe përcaktonte qëndrimin e njeriut kundrejt vdekjes.<sup>189</sup>

*Eutanazia*, përkatësisht diçka e ngjashme me *eutanazinë*, është e njohur edhe në kohën e Muhammedit a.s., të as'habëve (p.sh. Ibn Ka'bi dhe Ebu Dherri), të Imam el-Gazaliut, të Ibn Tejmijes, të Ibn Kajim el-Xhevziut etj.<sup>190</sup>

Në kuptimin modern, emërtimin ‘*eutanazi*’ i pari e përdori Frencis Bekoni (1561-1626) në veprën e tij *Organoni i ni*, në vitin 1620. Mirëpo, *eutanazinë* e trajtoi në njëfarë mënyre edhe filozofin Monteskie (1689-1755), i cili më 1721 u angazhua botërisht për të drejtën e vetë-vrasjes së njerëzve të kapluar dhembjet, pastaj Thomas Mor (1480-1535), në veprën e tij *Utopia*, i cili propozoi t'u këshillohet të sëmurëve të pashpresë që ta lënë këtë botë sa më shpejt, d.m.th. të vdesin, dhe de Montenje e Shekspiri, të cilët e mbështetën *eutanazinë*<sup>191</sup>. Sipas mendimit të autorëve të tjera ‘termi *eutanazi* u fut për herë të parë në përdorim në ShBA në vitin 1872’.<sup>192</sup>

---

<sup>189</sup> *Eutanazinë* e hasim edhe në shoqëritë primitive, kurse eskimët edhe sot i janë pleqtë e pafuqishëm të vdesin në borë. Është interesant se filozofi i njohur grek para e.r., Platoni, mendon se të sëmurët nuk duhet t'i bëhen barrë shoqërisë, ndaj ata nuk duhet shëruar, por duhet lënë të vdesin, që do të thotë se është angazhuar për një lloj *eutanazie* pasive për shkaqe pragmatike. Shih: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 2.

<sup>190</sup> Buhariu dhe Muslimi (Muttefekun alejh); Ibn Tejmije, *El-Fetava el-kubra li Ibn Tejmije*, Imam el-Gazaliu, *Ihja ulumi'd-din*; Ibn Kajim el-Xhevzij, *Zad'ul-mead*, pjesa e tretë, sipas: Jusuf el-Kardavi, *Surremene fetve*, op. cit., fq. 79 – 80.

<sup>191</sup> Sipas: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 2.

<sup>192</sup> E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, Sarajevë, 2002, fq. 96.

Në shekullin XIX nacioni ‘*eutanazi*’ pëson ndryshim rrënjosor, duke nënkuptuar ‘ndihmën që i jepet njeriut në fill të vdekjes me ndihmën e personelit mjekësor’.

Disa qarqe, duke u gjetur para kërkesave gjithnjë e më të mëdha të eutanazistëve, pohojnë se “për t’iu shmanjur cilësimit si vepër penale e mbytjes / vrasjes, eutanazia, duhet t’i plotësojë së paku dy kushte:

1) personi që gjendet në kthetrat e vdekjes të jetë pa gjasa për shërim dhe të ketë vuajtje që i kapërcejnë vuajtjet që e ndjekin vdekjen e njeriut. Këtë vendim e merr Komisioni i ekspertëve – mjekë, të mbështetur në rregullat dhe në të arriturat e shkencës së medicinës;

2) për aprovin e *eutanazisë* nevojitet edhe kërkesa e qartë e të sëmurit të pashërueshëm që të privohet ngajeta.<sup>193</sup>

Disa kundërshtarë të *eutanazisë* thonë se duhet të merren parasysh edhe këto rrethana:

1) Kurrë nuk mund të mohohet me siguri mundësia e shërimit të të sëmurit, sidomos në kushtet gjithnjë e më të mëdha të njohurive medicinale dhe të aparaturës së medicinës moderne;

2) Me gjithë masat parandaluese, nuk mund të evitohen abuzimet në praktikë;

3) E drejta për të jetuar është e drejtë e pacenueshme e njeriut, e cila nuk mund të shkelet në kurrfarë kushtesh, dhe nga ajo nuk mund të ikë as bartësi i kësaj të drejte, sidomos në kushtet kur vendimi i tij është marrë nën ndikimin e dhembjeve të mëdha.<sup>194</sup>

Gjatë historisë hasim edhe rezistencën kundrejt *eutanazisë*. Betimi i Hipokratit është kundër *eutanazisë*. Aty pohohet: “...Nuk do t’i ja p medikament vdekjeprurës askujt që do të kërkojë as do t’i ja p këshillë në këtë veprim. ...”<sup>195</sup>

---

<sup>193</sup> Sipas: *Pravna enciklopedija*, 1, Beograd, 1989, fq. 355 – 356.

<sup>194</sup> *Pravna enciklopedija*, op. cit., fq. 356. Shih: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, op. cit., fq. 96.

<sup>195</sup> Përkthimi sipas: Abdul Fadil Muhsin Ibrahim, *Biomedicina – islamski pogledi*, Sarajevë, 2001/1422, fq. 159. Tërësinë e Betimit të Hipokratit lexoje edhe në: Naser Ramadani, op. cit., fq. 3.

## Përkufizimi kuptimor i ‘eutanazisë’

Ndonëse në literaturën e përgjithshme e hasim jo shpesh vetëm në kuptimin kryesor, ekspertët dallojnë disa lloje ‘*eutanazish*’: <sup>196</sup>

1. *Eutanazia aktive* – shkurtimi (privimi) i drejtpërdrejtë i jetës së individit në fill të vdekjes me ndihmën aktive të tjetërkujt. Thua jse pa përjashtim, kjo *eutanazi* është e ndaluar dhe e dënueshme në të gjitha vendet. Kjo lloj *eutanazie* ekzekutohet në të shumtën e herëve me përdorimin e injeksionit vdekjeprurës. <sup>197</sup>

2. *Eutanazia pasive (ortonatazia)* – ndihmesa që i jepet njeriut në fill të vdekjes, duke ia ndërprerë aplikimin e terapisë dhe të mjeteve me të cilat i mbahetjeta, d.m.th. ndërprerja e trajtimit medicinal për pacientin, gjendja e të cilat nuk ka gjasa të përmirësohet. *Ortonatazia* është veprim krejtësisht i kundërt nga *distanzia*: ajo është përpjekje maksimale për t’ia zgjatur jetën pacientit të pashërueshëm me aplikimin e veprimeve të jashtëzakonshme mjekësore (me aparaturë a barna), përpjekje pa të cilat ai do të vdiste.. <sup>198</sup>

---

<sup>196</sup> Këtë ndarje kuptimeshi e huazuam nga: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 3. Krhs.: MUDr. Stefan Grenda, *Eutanazia je utok na život čoveka*, në: [www.prolife.sk](http://www.prolife.sk), fq. 1 - 2.

<sup>197</sup> *Eutanazia aktive* kemi kur pacienti lëngon nga kanceri, vuan nga dhembje dhe është në agoni. Mjeku beson se pacienti gjithsesi do të vdesë dhe i jep dozë të madhe të narkoanalgetikëve, të cilët ia ndalin frysma marrjen, d.m.th. mjeku bën veprim praktik me qëllim që i sëmuri të vdesë dhe e shpejton vdekjen e tij. Kjo pa dyshim është vrasje. Shih: Jusuf el-Kardavi, *Suvremene fetre op. cit.*, fq. 77 – 78.

<sup>198</sup> *Eutanazia pasive* është ajo formë, sipas së cilës nuk ndërmerr të gjitha aktivitetet për përfundimin e jetës, por lejohet që sëmundja të kalojë nëpër fazat e veta, pa i ofruar pacientit kurifarë ilaçi për vazhdimin e jetës, p.sh., kur pacienti është pa vetëdije një kohë të gjatë dhe ka mundësi të mbetet gjallë nëse përdoret aparaturë artificiale. Nëse aparatura artificiale pushon së punuari pacienti nuk do të vazhdojë të jetojë. Të gjithë ekspertët e lëmenjve

*Eutanazia sociale* – formë e *eutanazisë pasive*, sipas së cilës pacientët e moshuar të pashëruar lëshohen në shtëpi para kohe. Kështu, kujdesi për ta bie në minimum, në mënyrë që të përshpejtohet vdekja.<sup>199</sup>

---

të afërt me medicinën mendojnë se ky pacient është i vdekur dhe nuk urdhëron funksionet vetjake, ndaj vazhdimi i jetës së tij i zgjat vuajtjet dhe mundimet e pacientit dhe vuajtjet dhe investimet e mëdha të familjes. Në rast kur veprimi i mjekut redukohet në ndërprerjen e aparaturës mjekësore, që e ka mbajtur vetëm dimensionin e jashtëm të jetës, atëherë kemi të bëjmë me eutanazinë pasive, të cilën nuk e ndalon islami. (Jusuf el-Kardavi, *Suivremene fetive op. cit.*, fq. 77- 81). Krhs.: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, op. cit., fq. 96.

<sup>199</sup> N. Ramadani, op. cit., fq. 135.

Përveç *eutanazisë aktive* dhe *pasive* ekspertët dallojnë edhe disa lloje utanazish:

1. *Eutanazia vullnetare* – ndihmesa në vdekje me kërkesë të të sëmurit të pashërueshëm është në kundërshtim me vdekjen jovullnetare, te e cila pacienti nuk është në gjendje ta shprehë këtë kërkesë – ngecja shpirtërore, pavetëdia.
2. *Eutanazia e porositur* (e a. q. Living Will) – në rastin kur kemi paraprakisht deklaratën e të sëmurit me të cilën ai heq dorë nga teknika dhe veprimi nëse arrin në një gjendje përplot vuajtje dhe pa shpresë në shërim.
3. *Eutanazia e detyrueshme* – mbytja, vrasja apo përshpejtimi i mbytjes kundër vullnetit të pacientit.
4. *E drejta e vdekjes* – domethënë e drejta e njeriut që vetë të vendosë për vdekjen dhe që eventualisht ta zgjedhë. Njeriu nuk ka detyrim as që nga ai mund të kërkohet durimi i vuajtjeve dhe përcëmimeve të panevojshme për shkak të pamundësisë së vazdueshme dhe nënçmuese dhe deteriorizimit të mendjes dhe trupit, kur nuk ka më mundësi të përmirësimit.
5. *Vdekja trumore* – gjendja pas pushimit të funksionit të sistemit qendror nervor. Funksionet trupore vitale mbahen me aparatet të ndryshme. Nuk është fjala për *eutanazinë*, por për veprimin teknik në lidhje me personin i cili tashmë është i vdekur.
6. *Teratotanazia* – vetëmbytja eugjenike e frytit. Nuk dallon shumë nga *eutanazia*, sepse në të dy rastet fjala është për ndërprerjen e jetës. Nuk është e ligjësuar, por, megjithatë, aplikohet shpesh me indikacionin medicinal të ashtuquajtura dështim. Kah fundi i shekullit XIX *teratotanazia* manifestohet si problem i darvinizmit social, respektivisht i higjenës racore. Eksperimentet e dr. Mengeles me njerëzit dhe ‘Aksioni 4’ i njohur, janë shembuj të *eutanazsët* e dhjetëra mijë fëmijë me qëllim të krijimit të racës së re, të pastër<sup>199</sup> apo në rastet kur prindërit kërkojnë *eutanazinë* për fëmijët e tyre me anomali të rënda mendore etj.<sup>199</sup>

## Legalizimi e eutanazisë në botë

Me kalimin e kohës kemi kërkesa të vazhdueshme që parlamentet e disa shteteve ta legalizojnë *eutanazinë*.<sup>200</sup> Ne do t'i cekim vetëm disa raste, sepse nuk kemi të dhëna të plota për të gjitha vendet por edhe pse kështu do të kapërcenim pretendimet e punimit tonë. Për shembull, nga parlamenti i shtetit federal të Ohios në ShBA, në vitin 1906, doli nisma e parë për ligjësimin e *eutanazisë* për të sëmurët e pashërueshëm. Kongresi e refuzoi këtë propozim-ligj. Ndërkohë janë ndërmarrë një varg aksionesh dhe nismash për legalizmin e *eutanazisë*. Kështu, në vitin 1938 në ShBA u formua shoqata për legalizimin e *eutanazisë*. Në vitin 1946 një grup kle-rikësh hebrenj dhe protestantë i drejtoi parlamentit të Nju-Jorkut kërkesën për legalizmin e *eutanazisë* vullnetare për ata që vuajnë nga sëmundjet e pamjekueshme. Teologu bashkëkohor protestant amerikan Joseph Fletcher është për aplikimin e *eutanazisë*, sepse të sëmurët e pashpresë për mjekim i barazon me ata “që vecse konsumojnë të mira private dhe publike”.<sup>201</sup> Në vitin 1976 në shtetin Kaliforni të ShBA-së u adaptua Ligji mbi të drejtën për vdekje; pacienti mund të deklarohet me shkrim mbi ndërprerjen e terapisë. Njëkohësisht abrogohet përgjegjësia penale e mjekut, ai është i detyruar ta zbatojë vendimin e pacientit, pa marrë parasysh bindjet dhe mendimet e tij vet-

---

<sup>200</sup> Për legalizmin dhe aplikimin e *eutanazisë* më këmbëngulëse janë grupet e rrezikuara suicidale, si të moshuarit dhe ata me sëmundje kronike. Këto kategori bëjnë më së shumti vetëvrasje, qoftë ajo edhe me ndihmën e mjekëve. Shih: E. Avdibegović – O. Sinanović, *Religijsko-etičko-pravni pogled na ljekarsku pomoć u samoubistvu i eutanaziji*, në: [www.healthbosnia.com](http://www.healthbosnia.com), fq. 1.

<sup>201</sup> Shih gjerësisht për këtë rast dhe raste të tjera: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 3. E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, op. cit., fq. 96.

jake.<sup>202</sup> Po ashtu, në Oregon të ShBA-së, viteve të fundit u aprovua ligji që legalizon *eutanazinë*. Me Aktin “*vdekje me dinjitet*” (Death of Dignity) është votuar legalizimi i ndihmës mjekësore në vetëmbytje. Ky *Akt* kërkon që pacienti të jetë më i vjetër se 18 vjeç, shtetas i Oregonit, të jetë në gjendje të marrë vendim dhe ta ketë të diagnostikuar gjendjen e terminuar të sëmundjes së pashëreshme që e shpie në vdekje brenda gjashtë muajsh. Akti i parë ka ndodhur më 1998.<sup>203</sup>

Në Evropë qysh nga viti 1935<sup>204</sup> zhvillohet diskutim i gjallë dhe i ashpër rrëth problemit të *eutanazisë*. Ndonëse propozimet janë refuzuar shumë herë, opinioni publik në 72% të rasteve të anketuara mbështet *eutanazinë*. Në Angli *eutanazia* dhe ndihma mjekësore në vetëmbytje është vepër penale.<sup>205</sup>

Në Francë nuk ekziston ligj që ndalon *eutanazinë*. Por, kemi kërkesa për legalizmin e saj.<sup>206</sup>

Në Zvicër *eutanazia aktive*, sipas nenit 114 të Kodit penal, është joligjore, kurse nenit 115 përkufizon: “Ndihamesa dhe nxitja në vetëmbytje” është kundërvajtje kur buron nga motivi vetjak. Mirëpo, ndihmesa mjekësore në vetëmbytje, e motivuar nga altruizmi, nuk është kundërligjore. Në Zvicërr gjatë vitit, Nga dozat legale të

---

<sup>202</sup> Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 4.

Kohëve të fundit shtrohen kërkesa që në kushte të caktuara të hiqet përgjegjësia për privimin ngajeta të kryer nga arsyé humane. Disa legjislativë *eutanazinë* e konsiderojnë rast të privilegjuar të mbytjes përtë cilin është caktuar dënim më i lehtë se sa përmbytje / vrasje të zakonshme. Shih: *Pravna enciklopedija*, 1, Beograd, 1989, fq. 356.

<sup>203</sup> E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, fq. 96.

<sup>204</sup> Në Angli është formuar ‘Shoqëria britanike për *eutanazinë* vullnetare dhe për legalizimin e saj’ (The Voluntary Euthanasia Legislation Society), sipas: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 4.

<sup>205</sup> Sipas: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, fq. 97.

<sup>206</sup> Sipas: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, fq. 97.

ilaçeve sipas së drejtës për vdekje – EXIT, në Zvicër brenda një viti vdesin rreth 120 persona.<sup>207</sup>

Në Gjermani kemi nisma të ngjashme, si formimi i *Shoqërisë për vdekjen humane* (Deutsche Gesellschaft fur humanes Sterben, DGHS) në vitin 1980, e cila angazhohet për sigurinë më të madhe juridike të atyre që do të ndihmonin në sendërtimin e të drejtës në vdekje. Kurse mjeku gjerman Julius Hacketal u drejtua para opinionit me ndihmën e tij të hapur në aplikimin e *autoeutanasizës*.<sup>208</sup> Po ashtu, kemi edhe rezistencën shumë aktive *kundër-eutanasiste*.<sup>209</sup>

Në favor të *eutanazisë* është edhe pohimi i kryetarit të parë të Bankës Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim, Jacques Attali, i cili ka thanë: “Pas moshës 60-65 – vjeçar njeriu humb aftësinë e prodhimit dhe është barrë e shoqërisë, ndaj këtë makinë duhet ndalur fuqishëm; logjika socialiste është liria, e liria themelore është vetëvrasja”.<sup>210</sup>

---

<sup>207</sup> Sipas: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, fq. 97.

<sup>208</sup> Sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 3. Të nxitur nga ky inkurajim, në Austri infermieret dërguan në atë botë shumë pacientë të bezdisshëm e të rëndë, pa dëshirën dhe dijen e tyre. Sipas: B. Souček, Doživotni zatvor za dvije bolničarke, Večernji list, 30. dhe 31. ožuljak, 1991, fq. 8, sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 3.

Diskutimet rreth *eutanazisë*, pas një heshtjeje e qetësie, shpërthyen në vitin 1990 e pas, kur dolën në sipërsaqe disa ndodhi skandalozë në disa vende, siç është rasti me mjekët amerikanë Jack Kevorkian dhe Timothy Quill, të cilët privuan ngajeta shumë njerëz me doza të mëdha të barbiturave. Sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 8. Po ashtu lexo: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, op. cit., fq. 96.

<sup>209</sup> Sipas: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 4.

<sup>210</sup> Sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 3. Sipas islamit shpenzimet financiare janë një faktor i rëndësishëm për shërimin e sëmundjeve të pashërueshme, prandaj, në rastet kur ato nuk mund të mbulohen nga burimet individuale, barra bie mbi shoqërinë dhe përgjegjësia është kolektive. Shoqëria duhet t'i riprogramojë fondet që harxhohen për alkoolizmin, narkomaninë, shtatzëninë e adoleshenteve dhe “kënaqë-

Në Holandë *eutanazia* dhe ndihmesa në vetëvrasje ishin teoretikisht joligjore, pos që nga 1973, sipas ligjit, shqiptohen aktgjykime liruese në rastet e *eutanazisë* me kërkesë, me kusht që pacienti të bëjë kërkesë për *eutanazi* dhe që *eutanazinë* ta bëjë mjeku. Në vitet tetëdhjetë filluan ndryshimet. *Shoqata Mjekësore Mbretërore Holandeze* i përcaktoi ‘*regullat e ndihmës meritore*’ (Rules of due care), që janë të ngjashme me ligjet mbi legalizmin e *eutanazisë* dhe ndihmesës në vetëmbytje.<sup>211</sup> Të dhënrat tregojnë se mjekët në Holandë aplikojnë gjashtë herë në ditë *eutanazinë aktive* – dhënen me qëllim të ilaçit vdekjeprurës me kërkesën e pacientit, me qëllim që ky të çlirohet nga vuajtjet. Njëzet herë në ditë pacienti hiqet nga aparati për zgjatjen artificiale të jetës. Në vitin 1984, 67% të opinionit publik holandez qenë deklaruar në llogari të *eutanazisë aktive*.<sup>212</sup> Në vitin 1987 është arritur marrëveshja mbi përkufizimin e *eutanazisë – perfundimin e qëllimit të jetës së personit me kërkesë të tij me ndihmesë të personit tjeter*.<sup>213</sup> Në vitin 1993, në Holandë miratohet ligji mbi *eutanazinë*.<sup>214</sup> Sipas të dhënave të tjera, *eutanazia* në Holandi u miratua tërësisht në vjeshtën e vitit 2000, ku, me aplikimin e *eutanazisë*, në vit vdesin rrëth 3600 individë.<sup>215</sup> Një kardinal holandez, F. Angelini, për *eutanazinë*

---

sitë” e tjera dhe të tregojnë kujdes shëndetësor për ata që janë të sëmurë të pashpresë dhe t'u lejojnë atyre të jetojnë në mënyrë cilësore dhe të vdesin me dinjitet. Sipas: Shahid, Athar, op. cit., fq. 5.

<sup>211</sup> E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, fq. 97.

<sup>212</sup> Rreth modelit holandez të eutanazisë shih: Veronika Lagova, Spolocenstvo života, Dobra smrt, në: [www.prolife.sk](http://www.prolife.sk), fq. 1 - 2.

<sup>213</sup> Sipas: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 4. Krahs.: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 6. Sipas shënimeve, në Holandë *eutanazia* shënon në vitin 1990 = 454 raste; viti 1994 = 1424, kurse në vitin 1995 ka disa kufizime. Shih: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 6.

<sup>214</sup> Sipas: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 4.

<sup>215</sup> E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, fq. 97.

thotë se është “kapitullim i shkencës së medicinës poltronë dhe fyerje e rëndë e dinjitetit njerëzor”.<sup>216</sup> Vatikani e gjykon ligjin mbi *eutanazinë* të miratuar në Holandë.<sup>217</sup>

Edhe në Australinë Veriore *eutanazia* me *Aktin mbi të drejtën në fazën terminale të sëmundjes* u legalizua nga korriku 1996 deri në mars 1997, kur u shfuqizua nga Ligji federal i Australisë.<sup>218</sup>

Në Kroaci deri vonë *eutanazia* nuk njihej me emrin e saj. Kështu, nen 94, me emrin ‘Vrasja sipas kërkesës’ thotë: “*Kush e vret dikë me kërkesë të tij të prerë dhe senioze, do të dënohet me dënim me burg prej një deri në tetë vjet*”. Pra, në legjislacionin kroat *eutanazia* (vrasja apo ndihmesa në vrasje) konsiderohet vrasje e njeriut. Mirëpo, edhe në Kroaci ka lëvizje drejt legalizimit të *eutanazisë*. Kështu, me Kodin penal më të ri në Kroaci (1997), përgatitet lejimi i *eutanazisë*, dështimit etj.<sup>219</sup>

Diskutime të gjalla rrreth legalizimit të *eutanazisë* janë zhvilluar edhe në parlamentin sloven, të motivuara nga legalizimi i *eutanazisë* në Holandë<sup>220</sup> dhe në vendet përreth.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë ndihma në vetëvrasje është e ndaluar, kurse *eutanazia* nuk trajtohet si kualifikim i veçantë, megjithëse viteve të fundit për të diskutohet shumë.<sup>221</sup>

Është indikativ rasti në Rumani, ku kryetari i Bashkisë së Bukureshtit, Trajan Basesku, i shtrënguar nga prania e rrreth 300 mijë qenve rrugaçë në qytet,

---

<sup>216</sup> Sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 6.

<sup>217</sup> Glas koncila, nr. 8/ 1993, fq. 3.

<sup>218</sup> Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 6, dhe: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, fq. 97.

<sup>219</sup> Sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 3 dhe 7.

<sup>220</sup> Poslanici o legalizaciji eutanazije na Slovensku / SME 1. 12. 2000 në: [www.rcc.sk](http://www.rcc.sk), fq. 1.

<sup>221</sup> E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, fq. 97.

pohoi “se eutanazia e rrugaçëve është gjëja e fundit që ne e dëshirojmë. Qentë do të zhduken kur këtë ta vendosin veterinarët”.<sup>222</sup>

Diskutimet lidhur me *eutanazinë* kanë filluar edhe në shtetet largnesh, si në Kinë, Kolumbi, Argjentinë e vende të tjera.

Në Kodin penal të Kosovës problemi i *eutanazisë* nuk theksohet veçan dhe deri tanë nuk është vërejtur ndonjë shkrim apo studim lidhur me këtë çështje. *Eutanazia* në Kosovë, pa cilësim të veçantë, trajtohet në kuadër të Kodit penal të Kosovës mbi vrasjet.

Në vendet muslimane nuk vërejmë trajtimin e veçantë të *eutanazisë*, por konsiderojmë se kjo temë trajtohet në kuadër të vrasjeve ordinere, kurse kualifikimi i *eutanazisë* dallon nga vendi në vet.<sup>223</sup>

## Akceset e zgjidhjes së problemit të eutanazisë

Trajtimi i problemit të *eutanazisë* është shumëdimensional. Dallojmö: akcesin medicinal, juridik, etik dhe akcesin e përgjithshëm shoqëror.<sup>224</sup>

1. *Akcesi medicinal* – Kap veprimin mjekësor, shëndetësor që shërben përmenjanimin e dhembjes, kundër së cilës nuk ka argument moral, etik as teologjik, dhe kështu ky veprim nuk ka lidhje me *eutanazinë*, edhe pse

<sup>222</sup> E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, Sarajevë, 2002, fq. 96; Për eutanazinë e kafshëve shih: [www.balkantimes.com](http://www.balkantimes.com), fq. 1.

<sup>223</sup> Tahir Mahmood, *Reforma krivičnog prava u muslimanskim zemljama: odrazi tradicionalnog i modernog zakonodavstva*, në: Fikret Karcić – Enes Karić (ed.), *Šerijatsko pravo u savremenim društima*, Sarajevë, 1998, fq. 117 – 140. Po ashtu: Sayed Hassan Amin, *Prajni sistemi srednjeg vijeka*, Sarajevë, 1998, fq. 470.

<sup>224</sup> Nga: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 4 – 5.

nga ai mund tē pasojë vdekja e pacientit. Është detyrë e mjekut që gjithësesi ta shpëtojë jetën e pacientit, e jo ta fikë atë. Qysh nga *Betimi i Hipokratit* mjekët betohen se askujt, qoftë edhe atij që kërkon, nuk do t'i jasin medikament që sjell vdekjen, as këshillë lidhur me tē. Në rrafshin e veprimit medicinal është e rëndë tē dallohet pasoja e fundit e veprimeve medicinale, pra a do tē jetë rezultati zbutja e dhembjeve apo *eutanazia*.

2. *Akcesi juridik* – Përpiqet nga pikëpamja juridike ta shqyrtojë problematikën që paraqitet gjatë *eutanazisë*. Roli instrumental në shoqëri i takon përgjithësisht së drejtës e kështu edhe në medicinë. Në angazhimet e veta që tē çlirohet nga dykuptimësia dhe nga paqartësitë, gjithë me qëllim që tē pengojë tē manipulimin e medicinës moderne me jetën e dikujt, e drejta ka arritur sukses vetëm deri diku. Fjala është, në tē vërtetë, për kategoritë shoqërore, etike dhe deontologjike, të cilat në format e veta tē skajshme kanë edhe legjitimimin juridik. Pikëpamja juridike përmblidhet në problemin e përgjegjësisë përvendimet që janë në fushën skajore tē jetës dhe tē vdekjes së pacientit.

3. *Akcesi moral* – Morali te çështja e *eutanazisë* është gjithnjë diskutabil. Në tē vërtetë, nga shkaqe morale në medicinë nuk është e lejuar çdo gjë e domosdoshme. Nga ky shkak, parimi moral është një prej shpjegimeve vendimtare tē sëmundjeve në disa kultura.

Feja nuk e pranon jetën e panatyrrshme dhe vdekjen artificiale (me dhunë), sepsejeta dhe vdekja nuk janë në dorën e njeriut, por tē Zotit. Etika e konsideron *eutanazinë* cenim tē humanizmit, sepse njeriun si objekt dhe kjo shpie drejt manipulimit dhe shpërdorimit. Një autor thotë: “plani që me njerëzit tē veprohet si me shtazët, na duket njëkohësisht edhe i neveritshëm, edhe qesharak; ai godet rëndë ndjenjën e dinjitetit tonë personal”.<sup>225</sup>

---

<sup>225</sup> Jean Rostand, *La biologie et l'avenir humain*, sipas: Alija Izetbegoviq, op. cit., fq. 150.

Sot shumëkush mendon se lirimi prej vuajtjeve të pashpresë dhe të padobishme, megjithatë është moralisht i arsyeshëm dhe së paku *eutanazia pasive*, në situata të këtilla, mund të lejohet. Madje edhe disa teologë thonë se moralisht është e paarsyeshme të pengohet *eutanazia* në situata të caktuara.<sup>226</sup>

4. *Akcesi i përgjithshëm shoqëror* – Opioni publik bëhet gjithnjë e më i interesuar dhe më ndikues te institucionet medicinale. Opioni publik tërheq gjithnjë e më shumë njerëz në të ashtuquajturën arenë, në të cilën diskutohet për çështjet e moralit. Është praktikë e shpeshtë që mediumet tentojnë t'i bindin autoritetet në shëndetësi dhe qeverinë që t'i shpërfillin shpenzimet ekonomike gjatë mjekimeve të shtrenjta në dobi të mbajtjes në jetë të pacientit një kohë të gjatë.<sup>227</sup> Për fat të keq, pasqyra që del në opinion është jo e plotë apo edhe e shtrembëruar dhe së këndejmi nuk ofron një tablo relevante për problemin e *eutanazisë*.

---

<sup>226</sup> Mirëpo, eksperti kroat për gjinekologji-akusher Dr. Antun Lisec, në një shkrim të tij rreth çështjes se a ka *eutanazi* në trojet ish-jugosllave pohon se “*përfat të keq, më duhet të them patjetër ka, madje më shumë sesa ndoshta mendoni. Ja vetëm një shembull: Nëse individi i moshuar gjendet në spital, nëse familja nuk kujdeset përfat e ose nëse personeli i spitalit e vëren sado pak se familja nuk dëshiron që ky person të jetojë, ka raste që atij personi të mos i ofrohet as diagnostikë adekuate, as përkujdesje dhe as kurim. Nëse ky apo kjo e moshuar përpigjet të ngrihet nga shtrati – e lidbin që të mos kujdesen përfat. E nëse edhe kundërshtojnë ose dëshirojnë të liron, atyre u jepet injekcion gjumi. Dhe kështu ata vetëm flenë, hanë shumë pak ose nuk hanë fare, ngase qëndrojnë shtrirë marrin shumë shpejt plagë, infeksion të kataterit urinor, ndezje të mushkërive, dbe kështu babai ose nëna jonë përfat disa ditë vdes i uritur dbe i etshëm në këtë mënyrë të turpshme. Shikoni gabimin: punonjësit e shëndetësisë e edhe familjarët më të afërt, thonë se ai plak e ka kohën që të vdesë. Prej nga kjo e drejtë që dikë ta dënojmë me vdekje! Vetëm Zoti është Zot mbi fillimin dbe mbi fundin e jetës dbe Ai do të caktojë se kur duhet të shkojmë nga kjo botë. Detyrë jona është që të mos lëmë pas dore kurimin dbe shërimin!*” Cituar sipas: Antun Lisec, *Mjetet kontraceptive – në mes së vërtetës dbe mashtimit*, në: *Takvim 1423/24 – Kalendar 2003*, Prishtinë, 2002, fq. 224-225.

<sup>227</sup> Në kohën kur shtëpitë nuk kanë askënd përfkujdesje ato nuk janë vendet më të përshtatshme as përfat lindur as përfat vdekur. Mbështetja në institucionet shëndetësore shtetërore apo shoqërore është domosdoshmëri, ndonëse shoqëria e industrializuar, gjithnjë e më pak e ofron këtë ndilmë. Andaj nevojitet një rishikim radikal shoqëror drejt humanizimit të shëndetësisë dhe jetës në tërsi. Shih: Shahid Athar, op. cit., fq. 7.

## Eutanazia dhe ligji

Nga pikëpamja juridike, ligjore, ‘*eutanazia*’ është privim i jetës së personit tjeter; d.m.th. juridikisht *eutanazia* është vepër penale dhe si e tillë ajo i nënshtrohet përgjegjësisë penale dhe ndëshkimit.<sup>228</sup> Ligji synon ose duhet të synojë ta sigurojë jetën dhe vlerat e përbashkëta. Ai në vetvete duhet të jetë i moralshëm, përndryshe nuk do të ishte ligj. Nëse ligji nuk e siguron jetën e individit dhe të grupit ai ka thyer barazinë, njëjtësinë dhe dinjitetin e të gjithë njerëzve.<sup>229</sup>

Me dallim nga shumica e mbytjeve / vrasjeve, tek motiv është kryesisht hakmarrja, urrejtja apo interes material, në rastin e *eutanazisë* motivi është i natyrës altruiste. *Eutanazia* kuptohet si formë e ndihmës, shkurtim i mundimeve dhe i vuajtjeve, dhe pikërisht nga ky dallim ndërmjet mbytjeve klasike dhe *eutanazisë* paraqiten problemet në trajtimin e *eutanazisë*.

---

<sup>228</sup> Sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 5.

*Eutanazinë* enciklopedia juridike e trajton si fikje të jetës së dikujt pa dhembje, d.m.th. vdekje, të cilën disa e kuptojnë si të drejtë që të sëmurit të pashërueshëm t'i privohet jeta. Këtë ato e arsyetojnë me shkaqe humane e fisnike duke thënë se eutanazia nuk është shoqërisht e rrezikshme dhe e dënueshme. *Pravna enciklopedija*, 1, Beograd, 1989, fq. 355.

<sup>229</sup> Sipas: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 5. Krhs.: Sipas: Valentin Pozaić, *Eutanazija pred za-konom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 5

Kur diskutojnë rrëth problemit të legalizimit të *eutanazisë* shkencëtarët tërheqin vërejtjen edhe për disa çështje të pakapërcyeshme, që do të vlenin vazhdimi: 1) jodiagnostifikimi dhe jomjekimi i çrrregullimeve te sëmundjet kronike dhe të pashërueshme; 2) menaxhimi jopërkatës i simptomave fizike; 3) kujdesi i pamjaftueshëm për vuajtjet dhe frika e pacientëve nga vdekjea 4) grupet sociale të margji-nalizuara; 5) zhvlerësimi i jetës së të paaftëve, të invalidëve; 6) rekomandimet e mjekut për pacientin etj. Shih gjerësisht: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, op. cit., fq. 98.

Në Francë, Belgjikë dhe Britaninë e Madhe *eutanazia* nuk klasifikohet si vepër penale, por ndëshkohet me dispozitat mbi privimin ngajeta.

Në vitin 1939 Hitleri nënshkroi urdhëresën sipas së cilës lejohej mbytja / vrasja e personit që është shpallur i pashërueshëm. Mjeku Karl Fridrih Brandt personalisht është përgjegjës për shpalljen e 275000 njerëzve të pashërueshëm dhe të gjithë ata u mbytën. Gjyqi i Nurembergut e gjykoi këtë mjek me vdekje.<sup>230</sup>

Në Gjermani, Itali dhe Holandë *eutanazia* klasifikohet si vepër penale, por ndëshkohet me forma më të lehta dënimini në krahasim me mbytjet me motive klasike.

Në shumicën e vendeve federale në SHBA është adaptuar ligj mbi të drejtën për vdekje i cili u jep personave me sëmundje terminale të drejtën të vendosin mbi jetën dhe ta refuzojnë ndihmën mjekësore me qëllim që të vdesin.

Sipas ligjit të vjetër të ish-Jugosllavisë *eutanazia* trajtohej si vepër e veçantë penale e privimit të jetës nëse ajo bëhej me kërkesë ose lutje (dënim me burg deri në pesë vjet), e nëse autori i përgjigjet lutjes apo kërkesës, i motivuar nga dhembja ndaj gjendjes së mjerë të ndonjë personi, vepra konsiderohej kundravajtje dhe dënohej me burg deri në tre vjet. Sipas ligjit të vitit 1951 *eutanazia* konsiderohej vepër penale e privimit të qëllimtë të jetës – me mbytje / vrasje dhe dënohej me dënim të përcaktuar për këtë vepër.<sup>231</sup>

---

<sup>230</sup> Sipas: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 4; Valentin Pozaić, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 6.

<sup>231</sup> Shih: *Pravna enciklopedija*, 1, Beograd, 1989, fq. 356.

## Pikëpamjet teologjike mbi eutanazinë

Nuk kemi mundësi që problemin e *eutanazisë* ta ndjekim nga aspektet e feve të ndryshme, sepse trajtimi i tillë do të na çonte larg dhe do të kërkonte hulumtime më të thella, prandaj do t'i cekim vetëm shkurtimisht disa mendime më karakteristike. Mirëpo, e përbashkëta e “*liderëve religiozë dhe humanistë është qëndrimi se askush nuk ka të drejtë ta përfundojë jetën e ndonjë personi tjetër, pavarësisht nga rrëthanat ...*”,<sup>232</sup> dhe se *eutanazia* është fye se dhe e ndëshkueshme jo vetëm për personin që e kërkon por edhe për atë që e ndihmon, duke thënë se ajo është në kundërshtim me të drejtën e Zotit dhe me të gjitha ndodhitë e jetës së njeriut.<sup>233</sup> Jo vetëm intelektualët fetarë, por edhe mjekët, filozofët, letrarët, juristët dhe qarqet shoqërore-shkencore nuk kanë qëndrim unik as thjesht pozitiv apo negativ ndaj *eutanazisë*.

### a. Kristianizmi

Sipas kristianizmit dhe kërkesave të tij hyjnore askush nuk ka të drejtë ta autorizojë ndonjë person për vdekjen e një personi tjetër. Asnjë pushtet nuk mund ta ligjësojë *eutanazinë* sepse ka të bëjë me shkeljen e ligjit hyjnor, me krimin kundër jetës dhe me cenimin e dinjitetit njerëzor. Për pjesëtarët e kristianizmit vdekja është ngjarje me rëndësi të madhe, sepse ajo është kalim ngajeta botërore e përkohshme në përbashkësinë e amshueshme me Zotin. Kristianizmi kundërshton shpre-

<sup>232</sup> *Medical and Health Encyclopaedia*, New York, (1978 ?), fq. 359.

<sup>233</sup> E. Avdibegović – O. Sinanović, *Religijsko-etičko-pravni pogled u samoubistvu i eutanaziji*, në: [www.healthbosnia.com](http://www.healthbosnia.com), fq. 1.

himisht *eutanazinë* dhe nga vetë fillimi i ka dhënë rëndësi kurimit të të sëmurit dhe kujdesit ndaj të moshuarve, të pafuqishmëve dhe të uriturve.

Sipas autorëve të krishterë, *eutanazia e drejtperdrejtë* (d.m.th. ndihma për përfundimin e jetës së personave të gjymtuar, të sëmurë apo para vdekjes), ndalohet, pavarësisht nga motivet dhe mjetet. Ky ndalim bëhet edhe nga pikëpamja morale, sepse *eutanazia* “paraqet akt të rëndë kundër dinjitetit të personalitetit të njeriut dhe respektimit të Zotit, krijuesit të tij. Vlerësimi i gabuar dhe bindja se kjo është rruga më e mirë nuk e arsyetojnë këtë akt: mbytje / vrasje.<sup>234</sup>

Kisha zyrtare nismat për legalizimin e *eutanazisë* i gjykoi rreptë, duke thënë se *eutanazia* është humanitet johuman, që vrasjen e cilëson si mëshirë.<sup>235</sup>

Edhe kohëve të fundit kemi reagime të rrepta të kreut katolik kundër *eutanazisë*, si për shembull ai i papa Gjon Palit II, i cili në korrik të vitit 2002, me rastin e një festë katolike, “*eutanazinë e quajti ‘absurde’*”.<sup>236</sup>

Mirëpo, qarqet e Kishës katolike, protestante (madje edhe judaizmi si fe qellore) miratojnë *eutanazinë pasive*, bile edhe e rekomandojnë.<sup>237</sup>

## b. Budizmi

Në besimin budist nuk ka qëndrim të prerë mbi *eutanazinë*, por çdo besimtar ndërton pikëpamjen e tij në suaza të doktrinës religjioze. Mendohet se budizmi nuk dallon shumë nga kristianizmi në aspekt të *eutanazisë*.<sup>238</sup>

<sup>234</sup> [www.hbk.hr/katekizam/](http://www.hbk.hr/katekizam/) Ljubi bližnjega svoga kao samoga sebe, fq. 10. 11.

<sup>235</sup> E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, op. cit., fq. 96.

<sup>236</sup> [www.vaticanradio.org](http://www.vaticanradio.org) , Radio Vatikan, Vijesti, fq. 2.

<sup>237</sup> E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, op. cit., fq. 96.

<sup>238</sup> [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), në: Donat Math, *Eutanazija*;fq. 4

## c. Islami

Islami e afirmon jetën dhe plotësimin e nevojave jetësore, kurse vetëvrasjen e konsideron, si edhe shumica e religjioneve, blasfemi dhe të gjykuar, sepse pos tjerash, *eutanazja* dhe ndihmesa në kryerjen e *eutanazisë* është në kundërshti me të drejtën absolute të Zotit.

All-llahu i madhërishëm është ai që përcakton ç'do t'i ndodhë njeriut gjatë jetës së tij, sa do të jetojë dhe kur do të vdesë, dhe ajo që e ka goditur nuk ka mundur ta anashkalojë dhe ajo që e ka anashkaluar nuk ka mundur ta goditë, në kuptim të fjalëve të Muhammedit a.s. në hadithin: "...*a jo që nuk tē ka goditur, as qē ka mundur tē tē goditē, kurse ajo qē tē ka goditur, nuk ka mundur tē tē mos goditē...*"<sup>239</sup>, duke përfshirë këtu edhe shëndetin dhe sëmundjen.

Shëndeti dhe sëmundja janë mënyra me të cilat All-llahu xh. sh. i sprovon njerëzit që në këtë mënyrë t'i shpërblejë apo ndëshkojë ata, por shumë njerëz nuk kuptojnë, ata mendojnë se jeta ecën derisa njeriu është i shëndoshë dhe i fuqishëm, sepse kur sëmuren, plaken apo bëhen të pafuqishëm ata dëshpërohen, humbin shpresën dhe angazhohen për çolloj shërimi dhe kur nuk shohin rrugëdalje, i drejtohen Zotit për mëshirë, falje dhe i luten t'ua shkurtojë jetën.<sup>240</sup>

Sipas islamit '*eutanazia*' është një lloj vrasjeje / mbytjeje prandaj ai e kundërshton haptazi dhe qartazi *eutanazinë*. Sipas tij, *eutanazia* ia merr jetën njeriut tjetër. Islami ndalon rreptësisht të gjitha llojet e vrasjeve, përvèç sipas

---

<sup>239</sup> Sipas: Imam en-Neveviu, *Dyzet hadithe dhe shtoja e Ibni Rexhebit*, Shkup, 413/1992, fq. 46/47.

<sup>240</sup> All-llahu i madhëruar thotë:

"*Thuaj: 'O njerëzit e mi që keni bërë gabim ndaj vetes, mos e këputni shpresën te mëshira e All-llahut! All-llahu, do t'ju falë me siguri të gjitha mëkatet; Ai, njëmend, fal shumë dbe është i mëshirshëm'*". (Ez-Zumer, 53);

"*„Kurse mëshira ime ngërthen çdo send”*". (El-A'raf, 156).

ndëshkimit (kisas). Jetën ai e konsideron si vlerën më të madhe të njeriut, si dhuratë të Zotit. Askush nuk ka të drejtë ta privojë nga kjo e drejtë. Zoti ia ka dhruuar jetën si të mirën më të madhe, prandaj Ai i vetmi mund t'ia marrë. Në të vërtetë, Zoti ka lejuar që njeriu të privohet nga kjo dhuratë nëse ai ka privuar tjetërkënd.<sup>241</sup> Kjo masë është përcaktuar për arsyen që të ruhet kjo begati.<sup>242</sup>

Nga pikëpamja fetare islame *eutanazia* është e papranueshme edhe për arsyen se ky veprim në vete fsheh humbjen e shpresës në mëshirën e Zotit dhe provokimin e besimit në Zotin. Sipas mësimave islame kurrë nuk bën të humbet shpresa e shërimit. Humbjen e shpresës e trajtuan kësisoj edhe klasikët muslimanë, si En-Nesefiu, i cili ndër të tjera pohoi se edhe "... *humbja e shpresës në mëshirën e All-llahut është kufr*".<sup>243</sup> Mund të dështojë medicina, por gjithnjë, në të gjitha situatat, mbetet Zoti si shpresa e fundit. Ai është i gjithëdijshëm, i gjithëpushtetshëm dhe i gjithëmëshirshëm, absolut në çdo gjë. Besimtari, nuk dyshon asnjë çast në mëshirën e Tij, dhe e ka parasysh ajetin kur'anor vijues:

"...Kurse mëshira ime ngërthen çdo send". (El-A'ruf, 156).

Në çastet më të vështira njeriu besimtar shpreson dhe mbështetet te Zoti. Shembujt e të dërguarve të Zotit, si për shembull të Nuhit, Ibrahimit, Muhammedit a.s. janë shembulli më i mirë si duhet vepruar.<sup>244</sup>

---

<sup>241</sup> "... Nëse dikush vret, që s'ka vrarë askë ose nuk ka bërë në tokë trazira – sikur ka vrarë tërë njerëzinë; por kush bëhet shkaktar për të jetuar dikush – sikur ia ka ruajtur jetën tërë njerëzisë". (el-Maideh, 32).

Shih hadithet e Muhammedit a.s. mbi shpresën në All-llahun e madhëruar Imam en-Nevevi, Rijadus-salihin, Shkup, 1418/1998, fq. 170 – 187.

<sup>242</sup> "We lekum fi'l-kisasi bajatun ja uli'l-elbabi le'al-lekum tettekun". "Në hakmarrje keni ekzistencën, o të mençur, ndoshta do të rubeni!" (El-Bekaretu, 179, sipas përkthimit të Feti Mehdiut), kurse: "O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të rubeni (nga mbytja e njëri-tjetrit)". (El-Bekaretu, 179, sipas përkthimit të Sherif Ahmetit).

<sup>243</sup> "We'l-je'su min'All-llahi teala kufrun", në: Ebu Hafs Umer en-Nesefij, *Besimi islam sipas imam en-Nesefiut (El-Akaid'un-Nesefiuh)*, Prizren, 2003, fq. 48.

<sup>244</sup> Shih përgjigjen e dijetarit të madhi boshnjak Husein Gjozo: Husein Dozo, *Fetve – Pitanja i odgoverni*, Novi Pazar, 1996, fq. 130.

Nuk duhet anashkaluar as përkujdesjen psikologjike dhe emocionale të njerëzve që kujdesen (personeli mjekësor apo pjesëtarët e familjes) për pacientin e pashpresë, ndaj me këtë rast duhet pasur parasysh besimin, bindjet, etnikumin etj., të pacientit, sepse të gjitha këto mund të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes apo në zbutjen e vuajtjeve.<sup>245</sup>

Sipas mendimit islam, *eutanazia aktive*, ajo kur pacienti kërkon nga mjeku që ta vdesë atë, është rreptësisht e ndaluar.<sup>246</sup> Askush s'ka të drejtë të përzihet në përcaktimin e Zotit dhe të gjithë janë të obliguar të mjekohen. Muhammedi a.s. thotë: “Për çdo sëmundje që e ka dhënë All-lahu, Ai e ka caktuar edhe ilaçin”.<sup>247</sup> Ky hadith provon se kurrfarë vdekjeje, pra as nga mëshira, nuk lejohet, sepse disa sëmundje nuk kanë shërim vetëm momentalisht. Prandaj, mbytja nga mëshira dhe për ta lehtësuar vuajtjen nuk e eliminon karakterin e mbytjes, sepse mjeku nuk është më mëshirues ndaj të sëmurit se sa vetë Krijuesi.<sup>248</sup>

---

<sup>245</sup> Shahid Athar, op. cit., fq. 7.

<sup>246</sup> Muhammedi a.s. pohon: “Askush nga ju mos ta kërkojë vdekjen. Sepse, nëse është i mirë, ka shpresë që do të bëjë edhe më vepra të mira; e nëse është mëkatar, ka shpresë se do të pendohet dhe të përmirësohet”. (Buhariu), sipas: Jakup Memic, *Izbor poslanikovih hadisa*, nr. i hadithit 1921, Sarajevë, 1985, fq. 410.

Ebu Hurejreja tregon se Muhammedi a.s. pohon: “Askush nga ju nuk bën ta dëshirojë vdekjen për shkak të fatkeqësisë ose dëmit që e ka goditur. E nëse e dëshiron, le të thotë: “O All-lahu im, ma zgjat jetën nëse kjo është më mirë për mua, kurse ma merr, nëse vdekja është më e mirë për mua”. Sipas: Jakup Memic, nr. i hadithit 1922, op. cit., fq. 410.

<sup>247</sup> Hadithin e shënon El-Buharij, në: Ibn-Kajim El-Dzevzi, *Poslanikova medicina*, Sarajevë, 2001/1422, fq. 23.

Sh. Athar cek hadithin e ngjashiëm me të parin: “O muslimanë, kërkon shërim, përderisa Zoti nuk ka krijuar asnjë sëmundje pa krijuar një kurim për të”. (Shahid Athar, *Euthanasia*, op. cit., fq. 5).

<sup>248</sup> Sipas ajeteve kur'anore, All-lahu është më mëshirues se çdo kriesë (erham'ur-rrahimin).

Edhe Jusuf el-Kardavi konsideron se *eutanazia aktive* është e ndaluar dhe mëkat i rëndë, pa marrë parasysh metodën (goditje elektrike, mjet i mprehtë apo mjete narkotike dhe pa marrë parasysh se a bëhet nga mëshira ndaj

Edhe *Shoqata Internationale Muslimane* në ShBA nuk e mbështet *eutanazinë* dhe nuk e përfshin në organizimin mjekësor, në asnjë formë dhe me asnjë emër (vrasje nga mëshira, vetëvrasje, vdekje me ndihmë, e drejta për të vdekur, nevoja për të vdekur etj.), sepse, pos të tjera, legalizimi dhe legjitimizimi i eutanazisë bën mjaft presion te pacienti që ky në mënyrë të drejtë apo të gabuar, të lexojë në sytë e pjesëtarëve të familjes lutjen e heshtur për të ikur.<sup>249</sup>

Mirëpo, *eutanazinë pasive* disa dijetarë islamë e lejojnë, për shembull, në rastin kur pacienti refuzon mjekimin dhe e duron sëmundjen dhe, pas keqësimit të gjendjes, shëndetësore, ai vdes, është e lejuar dhe legale ndërpresa e mjekimit dhe mosdhënia e ilaçeve me qëllim që sëmurit dhe familjes së tij t'u lehtësohet gjendja. Thënë ndryshe, nëse nuk ka shpresa për mjekim në pajtim me ligjet e kauzalitetit të Zotit, që e njohin ekspertët nga domeni i medicinës, shërimi nuk është i detyrueshëm. Rastet kur mjeku ndal aparatin, instrumentit medicinal, sepse pacienti tashmë biologjikisht ka vdekur, quhen *eutanazi pasive*. Këtë ky grup dijetarësh e mbështet në hadithin e Muhammedit a.s. kur një grua iu drejtua atij t'i lutet Zotit për shërimin, e saj, kurse Muhammedi a.s. i tha se do të lutej, por do të ishte më mirë që ajo ta duronte sëmundjen, sepse All-lahu do ta falte at dhe gruaja e pranoi sugjerimin e Pejgamberit a.s.. Kjo nuk do të thotë se i sëmuri nuk duhet mjekuar, se është më mirë të durohet sëmundja e vuajtja, por do të thotë se është e lejuar.<sup>250</sup> Jusuf el-Kardavi pohon se “njohësit e shariatit

---

pacientit apo për t'ia lehtësuar vuajtjet dhe dhembjet atij. Shih: Jusuf el-Kardavi, *Surremene fetve* (Izbor), Tuzla, 1997, fq. 78 – 79.

<sup>249</sup> Shih: Shahid Athar, op. cit., fq. 5.

<sup>250</sup> Resad ef. Plojević, *Pitanja i odgovori*, në: Glas islama, nr. 70, Shtator 2002, Novi Pazar, fq. 49. Krhs.: E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, op. cit., fq. 99.

janë në dijeni se mjekimi nuk është vaxhib (detyrim) sipas shumicës së juristëve dhe liderëve të shkollave juridike (medhhebeve). Për ta ky veprim cilësohet në mubah (e lejuar). Disa madje e konsiderojnë për mustehab (të dëshirueshme). El-Kardavi pohon se u bashkohet dijetarëve që shërimin e konsiderojnë vaxhib (të detyrueshëm), nëse dhembja është e vështirë, kurse ilaçi i dobi-shëm, edhe pse ka shpresë në mjekim në pajtim me ligjin e Zotit.<sup>251</sup> Mirëpo, nëse nuk ka shpresë, në pajtim me ligjin e All-llahut të kauzalitetit, që e njohin specialistët nga domeni i medicinës, askush nuk thotë se mjekimi është mustehab apo vaxhib. Për më tepër, nëse trajtimi medicinal i të sëmurit, pavarësisht nëse ka të bëjë me përdorimin e tabletës, dhënien e injekzionit apo të infuzionit, me mushkëritë artificiale e të tjera, do ta vazhdonte periudhën e sëmundjes, kurse dhembjet do të mbeteshin një kohë të gjatë, nuk është vaxhib apo mustehab, por e kundërta. Ky lloj i *eutanazisë* nuk bën të hyjë në konceptimin e ‘vrasjes nga mëshira’ për shkak të mungesës së veprimit praktik nga ana e mjekut. Ky është mosveprim i diçkasë që nuk është vaxhib as mendub, prandaj nuk mund të trajtohet si veprim kriminal. Pra, ky është veprim i lejuar dhe legal, në mos po edhe i dëshirueshëm dhe mjeku mund ta praktikojë me qëllim që ta lehtësojë gjendjen e pacientit dhe të familjes së tij.<sup>252</sup>

Disa mendimtarë bashkëkohorë islamë konsiderojnë se në rast kur edhe pas zgjedhjes së përdorimit të aparatit që e mban njeriun në jetë, gjendja shëndetësore nuk përmirësohet, apo kur mjekët këshillojnë heqjen e këtyre aparateve, atëherë është e lejueshme të ndërprenhet puna pa marrë parasysh që i sëmuri menjëherë pas kësaj do të

---

<sup>251</sup> Jusuf el-Kardavi, *Suvremene fetre*, op. cit., fq. 80.

<sup>252</sup> Jusuf el-Kardavi, *Suvremene fetre*, op. cit., fq. 80.

vdesë. Këtë qëndrim e ka edhe Jusuf el-Kardavi. Mëndimin e tij e mbështesin edhe mjekët muslimanë.<sup>253</sup>

Në fund do t'i ofrojmë sugjerimet vijuese të *Shoqatës Internationale Muslimane* në Amerikë lidhur me *eutanazinë*, me shpresë se do të ndihmojnë në konceptimin më të drejtë të kësaj çështjeje:

1. “Zhvillimi i mjeteve vlerësuese dhe direktivave të çështjeve të fundit, të jetës, nga specialistë përkatës.
2. Teste specifike dhe të përshtatshme të arrihen për diagnozat dhe prognozat e pranuara.
3. Të përcaktohen zonat në të cilat do të ndihmohet për përmirësimin e shëndetit dhe të mbahet cilësia e jetës jo në koston e përfundimit të jetës (që do të thotë, përmirësimin e kujdesit shëndetësor në kushte shtëpiake).
4. T'i jepet rëndësi edukimit të të gjithë mjekëve dhe të shmanget zhvillimi i veçorive që mund të keqpërdoren.
5. Vënia e udhëzuesve të parakohshëm, si nevojë e të gjitha spitaleve dhe regjistrimeve të zyrës shëndetësore të pacientit”.<sup>254</sup>

## ç. Shekullarizmi

Në vendet perëndimore ku po merr hov shekullarizimi i traditës religjioze, zhvillohet një betejë e rreptë për ruajtjen e autoritetit që këto çështje dikur e kanë pasur. Ndikimi i tyre në përfundimin e debatës mbi vdekjen dhe *eutanazinë* është shumë i vogël, por s'është për t'u shpërfillur. Nën ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë apo të tërthortë rezultojnë edhe shumë vendime anekënd Evropës dhe botës.

<sup>253</sup> Resad ef. Plojević, *Pitanja i odgovori*, në: *Glas islamia*, nr. 71, Tetor, 2002, Novi Pazar, fq. 44.

<sup>254</sup> Shahid Athar, op. cit., fq. 8.

## Zhvillimi i medicinës dhe ndikimi i saj

Zhvillimi i medicinës bashkëkohore mundëson ruajtjen dhe mbrojtjen e jetës në situatat e pashpresa. Medicina intensive kujdeset për të sëmurin të cilin e kanë lënë funksionet vitale, dhe që ka ardhur ndërmjet jetës dhe vdekjes. Me medicinën intensive lidhen problemet e *eutanazisë pasive* dhe problemet e miratimit dhe mosmiratimit të pacientit për vdekje. Shumica e mjekëve sot do ta refuzojnë *eutanazinë* si veprim që u kundërvihet parimeve themelore dhe kërkesave të profesionit të tyre, por duke i marrë parasysh të drejtat themelore njerëzore – ndër të tjera edhe të drejtën e vdekjes, gjerat ndërlikanohen edhe më tepër. *Eutanazia* këtu ka dy domethënje: marrja aktive e të ashtuquajturës jetë e pavlefshme e të sëmurrëve të pashërueshëm, kurse domethënia tjetër është ndihma në vdekje në vdekjen e të sëmurrëve të cilët e përjetojnë vuajtje të mëdha. Ka disa indikacione dhe paralajmërimë apokaliptike se së shpejti do të paraqiten mjekët të cilët do ta zbatojnë *eutanazinë* sipas kërkesës. Po ashtu, ekzistojnë vërejtjet se normat etike dhe juri-dike nuk janë në pajtim me përparimin shkencor dhe me potencialin eksperimental të medicinës bashkëkohore. Mbase kjo është edhe e vërtetë, ndërkaq, thelbi i çdo gjëje, megjithatë, është në kufijtë dhe detyrat e mbajtjes së jetës nga medicinën bashkëkohore. Po ashtu paraqitet edhe problemi i përcaktimit të situatës së pashpresë.<sup>255</sup>

---

<sup>255</sup> Gjendemi në udhëkryq të zgjidhjes së *kulturës së vdekjes apo kulturës së jetës*. Kur pacienti ndihet i shpërfillur, i tepërt, i pakujdesur, ai në gjendje të këtillë do të bëjë çmos të lirohet nga kjo barrë, por nëse ai ndihet i dashur, s’do të kërkojë zbatimin e eutanazisë. Kërkesa për *eutanazi* është humbje e pësim i humbjes para së gjithash për medicinën. Shih gjerësisht: V. Pozaic, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi, hr](http://www.ftidi.hr), fq. 10 –11. Shih gjerësisht për

Sepse, në medicinë, si edhe kudo tjetër, paraqiten fenomenet të cilat janë përjashtime dhe askush nuk e supozon mënyrën e reaksionit të tyre. Në medicinë mund të paraqitet terrori i njerëzishmërisë, sepse medicina është në gjendje të manipulojë me jetën e njeriut. Nga e ekspozuara rezulton që në medicinë ekziston një grumbull problemesh të lidhura me *eutanazinë*.<sup>256</sup>

## Pikëpamja sociologjike mbi eutanazinë

*Eutanazia* është temë që ndikon drejtpërdrejt në shoqëri dhe standardet e saj normative, në Perëndim me intensitet më të madh, kurse te ne në Kosovë ende në fazën e aktualizimit, fillimisht në opinionin publik e pastaj në praktikën private. Në botë janë bërë hulumtime sociologjike, kulturologjike, politike, juridike dhe ekonomike. Ndër të tjera është hulumtuar se cila vdekje konsiderohet më e pranueshme dhe moralisht më e arsyeshme, e cila jo. Në Kroaci janë bërë hulumtime të tilla gjatë viteve 1988, 1989 dhe 1990. Rezultat i anketës: i gjithë personeli mjekësor i qendrave hospitalizuese është kundër *eutanazisë*. Madje edhe vetë pyetja zgjoi revoltë. Megjithatë, një pjesë e personelit ishte për *eutanazi* nëse ajo nuk sjell abuzim, por vendimi për të merret në përputhje me humanitetin dhe profesionalitetin e duhur.<sup>257</sup>

---

aspekte të ndiyshme të medicinës dhe e njeriut *Kodeksin e etikës mjekësore*: N. Ramadani, op. cit., fq. 188 – 199.

<sup>256</sup> Sipas: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 6.

Anketat tregojnë se mbështetja e *eutanazisë* nga ana e mjekëve rrit skepticizmin dhe mosbesimin e pacientëve kundrejt mjekëve.

<sup>257</sup> Sipas: Donat Math, *Eutanazija*, në: [www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr), fq. 7; Valentin Pozaic, *Eutanazija pred zakonom*, në: [www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr), fq. 11.

Për këtë çështje me rëndësi është edhe mendimi i të sëmurëve, sepse bëhet fjalë për jetën dhe fatin e tyre. Është detyrë e sociologëve që të gjejnë shpjegim për dallimet në trajtimin e *eutanazisë*, dallime këto të lidhura me normat, vlerat dhe besimet në shoqëritë e caktuara.

## Argumentet për dhe kundër eutanazisë

Për ilustrim, do të cekim disa nga argumentet dhe kundërgumentet më të shpeshta të lidhura me problemin e *eutanazisë*.

*Argumenti 1:* Sipas kristianizmit shkaklet urdhri i gjashtë i Zotit: Mos mbyt! Edhe pse respektohen bindjet fetare, megjithatë ka mendime se në shoqëritë moderne duhet kriuar mundësinë që njeriu të zgjedhë sipas bindjeve personale. Kisha e krishterë, katolike dhe protestante dhe hebraizmi miratojnë *eutanazinë pasive*, por jo edhe aktiven. Ndërkajq, nuk mund të vihet kufi relevant ndërmjet dhënieve së injekzionit vdekjeprurës dhe mos-mjekimit të ndonjë sëmundjeje.

Islami e konsideron jetën, punën, ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit gjë të shenjtë, prandaj cenimi i tyre, pjesërisht apo tërësisht, është shkelje e rëndë e parimeve islame.

*Argumenti 2:* E drejta për të jetuar është e drejtë themelore njerëzore – absolute, natyrore dhe e patjetërsueshme. Qëndrimi sejeta njerëzore është vlera më e madhe që duhet të respektohet dhe të ruhet me çdo kusht bazohet në konцепcionin e vjetër mbi *shenjtërinë e jetës*, dhe kundërshtohet nga pikëpamja e konceptit mbi cilësinë e jetës, nga e cila rrjedh edhe e drejta e vdekjes – ndërprerja e jetës në situatat kur vazhdimi i saj bëhet i

pakuptimshëm. Nëse do të pranohej kjo e dyta, dinjiteti njerëzor do të rrënohej.

*Argumenti 3:* *Eutanazia* nuk bën të lejohet, sepse gjithnjë ekziston mundësia e diagnostifikimit dhe prognozimit të gabuar. Kjo është e saktë, por ceket kundër-argumenti se ndërprerja e mundimeve dhe e vuajtjeve të panevojshme mbikalojnë mundësinë që një numër i vogël do të shpëtonë.<sup>258</sup>

*Argumenti 4:* *Eutanazia* nuk bën të legalizohet sepse kështu do të hapej rruga e abuzimeve dhe e krimeve dhe aplikimi i planifikuar i *eutanazisë* sipas shembullit të Gjermanisë së viteve të Luftës së Dytë Botërore. Kundër-argumenti është që çdo gjë mund të abuzohet dhe të përdoret për krime.

*Argumenti 5:* Mjetet kundër dhembjeve e bëjnë *eutanazinë* të tepërt, kurse mjeku i mirë nuk e lejon pacientin e tij të vdesë me dhembje. Kundërargumenti është se *eutanazia* ku nuk ka dhembje, ndërsa kur dhembja është mënjanuar, ajo nuk lejohet. Por, nuk ka arsyë që *eutanazia* të pengohet në rastet kur dhembja nuk mund të lehtësohet. Vuajtja për shkak të mosefikositetit të ilaçeve dhejeta pa ndihmën efikase të personelit medicinal nuk bën të durohen.

*Argumenti 6:* Legalizimi i *eutanazisë* do ta dobësonte besimin e opinionit publik dhe të të sëmurit në kurimin mjekësor dhe në moralin e mjekut. Besimi i patientit në mjekun dhe spitalin detyrë e të cilit është mjekimi, nuk do të dobësohet nëse *eutanazia* aplikohet vetëm me kërkesë këmbëngulëse të patientit.

*Argumenti 7:* I sëmuri mund ta shprehë dëshirën për *eutanazi* nën ndikimin e ilaçeve apo të dhembjeve momentale dhe se dëshira apo kërkesa e tij mund të jetë e pamatur. Edhe në këtë rast mund të shtrohet kundër-argument dhe çështja e *eutanazisë* të vazhdojë .

---

<sup>258</sup> E. Avdibegović – O. Sinanović, REPP, DMZ, op. cit., fq. 98.

## Përfundim

Kundërshtimit e rrepta dhe të papajtueshme ndërmjet kundërshtarëve dhe përkrahësve të *eutanazisë* bëjnë që diskutimi mbi *eutanazinë* nuk mund të përfundohet. Kompleksiviteti dhe multidimensionaliteti i temës (aspekti moral, juridik, medicinal etj.) inkuadroi në diskutim shumë njerëz të domeneve të ndryshme. Teknologjizimi i medicinës dhe mundësítë e saj të mëdha, në një anë, dhe resurset e kufizuara ekonomike, në anën tjetër, si dhe evoluimi i bindjeve morale dhe shumë faktorë të tjerë flasin në favor të diskutimit permanent mbi *eutanazinë*. Ende ekziston dilema mbi kufirin ndërmjet jetës dhe vdekjes dhe *kush e kur* do të mundej, pa abuzim, me ndërgjegje të pastër e të qetë, dhe moralo-juridikisht dhe profesionalisht me arsyet përcaktonte këtë kufi. Ndonëse dijetarët islamë janë deklaruar lidhur me *eutanazinë*, me gjithatë mendojmë se kjo çështje duhet analizuar më hollësisht dhe më shkencërisht, pa i lënë anash pikëpamjet morale, sociale, mjekësore, ekonomike, juridike por edhe tradicionale.

# **Filozofia islame – pro et contra**

I

Në kohën kurjeta dhe idetë po ndërrohen në mënyrat më të ndryshme, vëmendja e lexuesit vlen të përqendrohet në çështjen e arsimimit filozofik (islam), mjaft të rëndësishëm për jetën e përdit-shme, për t'u ballafaqar me takimet e frytshme ndërmjet fesë dhe botës, ndërmjet fesë dhe diturisë, ndërmjet trashëgimisë shpirtërore dhe kulturës aktuale, por edhe me simptomat shqetësuese që prodhojnë skepticizëm dhe indiferentizëm ndaj filozofisë dhe trashëgimisë së saj.

II

Reforma aktuale e studimit filozofik ndër ne, e zbatuar më tepër spontanisht, në rrjedha të ritmeve aktuale në botë dhe tek ne, është në një atmosferë shpirtërore njëkohësisht të favorshme dhe armiqësore për filozofinë, për shkak të ndryshimeve të shumta shoqërore dhe ndryshimet të ideve të përsiatjes serioze filozofike dhe për shkak të tendencave që filozofia të zhvlerësohet e të shpërfilltet, kështu që ajo në fund të fundit të proklamohet si e padobishme, e padëshirueshme që duhet eliminuar. Duke u mbyllur kundrejt problemit të transhendencës, kultura moderne përpinqet t'i kundërvihet mend-

mit autentik filozofik e sidomos spekulimit metafizik, i cili është i vetmi në gjendje të vijë deri te vlerat absolute.

Fryma teknologjike, që gjithnjë e më shumë e shpie *homo sapiensin* në *homo faber* dhe i sjell njerëzisë përparësi të shumta që nuk mund të mohohen, nuk shkon në favor të vlerave shpirtërore të njeriut. Në anën tjeter, mendësia e njeriut do të shkonte më me dëshirë drejt botës konkrete materiale, drejt zotërimit të përparimit shkencor dhe teknik, duke mos kërkuar zgjidhje në parimet e forta dhe indiskutabile metafizike, por në aktualitet dhe sukses. Prandaj, është e lehtë të kuptohet përse fryma e aktualitetit duket antimetafizike, duke ua hapur rrugën kështu të gjitha formave të relativizmit, të frysëzuar nga rrymimet pozitiviste, neopozitiviste dhe strukturaliste.

Në rrethana të tilla, nuk duhet çuditur përse shumë prej tyre shohin mundësi për një filozofi që do të dallonte nga dituritë pozitiviste. Dhe ndërkohë që mund të konstatohet një rënie e interesimit për disiplinat klasike filozofike, rritet me këmbëngulje rëndësia e diturive natyrore dhe antropologjike dhe prej tyre kërkohet komenti përfundimtar i njëmendësisë, duke e përjashtuar kështu plotësisht filozofinë si një gjë arkaikë, që do të zhduket gjithsesi. Prandaj, në vend të një takimi të dëshirueshëm që do t'u shërbente vlerave dhe lulëzimit të filozofisë dhe të shkencës, po vjen deri te kundërvënia e tyre, gjë që shkon në dëm të njërsës dhe tjetrës anë.

Filozofia nuk goditet vetëm nga shkenca dhe ritmet e saj aktuale, por edhe nga vetë teologët (musilimanë e të krishterë), të cilët e konsiderojnë të padobishme dhe si të tillë të dëmshme dhe të panevojshme për edukimin e besimtarëve dhe vetë teologëve. Këta konsiderojnë se shpallja hyjnore burimore është komprometuar gjatë historisë me futjen e disiplinave filozofike, vetjake apo të

huaja, të adoptuara në disiplinat sakrale. Po ashtu konsiderojnë se filozofia speku-lative e ka stërvngarkuar teologjinë dhe disiplinat përreth me probleme inekzistente.

Filozofia është e rrezikuar edhe nga vetë protagonistët e saj, të cilët, të ballafaquar me pluralizmin filozofik, gjenden në situatë inferiore. Duhet absorbuar e asimiluar nacione të shumta e të rënda, duhet adaptuar në mënyrë krejtësisht tjetër metodikën e saj didaktike, që shpesh, në mungesë kohore e pa mjete të mjaftueshme për stimulim, nuk mjaftojnë për auditoriumin dhe, për pasojë kemi inferiorizëm dhe izolacionizëm.

Filozofia është rrezikuar edhe nga ana e studentëve, të cilët, edhe pse tregojnë interesim për probleme të caktuara të njeriut dhe të shoqërisë, të ndikuar nga atmosfera aktuale kulturore, nuk preokupohen me problemet filozofike. Sot njerëzit janë orientuar më tepër drejt fotografisë, më pak drejt idesë, kurse paraedukimi dhe edukimi është orientuar më tepër drejt teknikës dhe praktikës. Po ashtu, rrymat e shumta kundërshtuese e konfuze filozofike, mosinteresimi i përgjithshëm për hulumtimin e së vërtetës dhe kërkesave të mëdha intelektuale që i shtron studimi i filozofisë, rëndësia abstrakte e studimit të filozofisë, i ngulfatin dhe i topitin studentët dhe të interesuarit e tjerë për studimin e filozofisë, sepse, pos tjerash, ata nuk e shohin qartë lidhjen ndërmjet filozofisë dhe teologjisë, sidomos teologjisë praktike, drejt së cilës ata janë orientuar.

### III

Pavarësisht nga vështirësitet e theksuara dhe të patheksuara në kurrit të filozofisë, kemi bindjen se ekziston mundësia për kapërcimin e këtyre tendencave

që shkojnë në drejtim të zhvlerësimit të filozofisë, të minimizimit të vlerës dhe të braktisjes së saj absolute. Sepse, miratimi dhe aplikimi i tendecave të theksuara do të thotë injorim i krijimeve më autentike dhe më të thella të mendimit klasik dhe bashkëkohor, gojor dhe të shkruar për çështje si: jeta dhe vdekja, kuptimi i së mirës dhe së keqes, vlera, dinjiteti dhe e drejta e njeriut, padrejtësia, shkelja e personalitetit, dhuna, karakteri, dashuria, rendi dhe kaosi, edukimi, autoriteti, liria, kuptimi i përparimit dhe i historisë, enigma e jetës matanë botës, Zoti dhe ekzistimi i Tij e shumë çështje të tjera, që e preokupojnë edhe sot veprën shkencore, këngën, poezinë, romanin, esenë, dramën, filmin, radion, televizionin etj.

Këto probleme nuk mund të zgjidhen në mënyrë adekuate në rrafshin e diturive pozitiviste, qoftë natyrore apo antropologjike, sepse metodat e tyre specifike nuk i trajtojnë këto çështje. Këto i shqyrton filozofia, e cila, duke i mbikaluar aspektet e pastra të jashtme dhe të pjesërishme të fenomenit, i drejtohet njëmendësisë totale në dritën e shkaqeve më të larta.

Kështu filozofia, me gjithë nevojën për rezultatet e diturive empirike, dëftohet si dituri e veçantë, autonome dhe me rëndësi kapitale për njeriun, jo vetëm për regjistrimin, deskribimin dhe rregullimin e fenomeneve, por edhe për të kuptuarit e vlerës së tyre të mirëfilltë dhe kuptimit të fundit.

Filozofia ka rëndësi parësore edhe në sferën e teologjisë, sepse nuk mund të merret me mend pranimi i mirëfilltë i shpalljes hyjnore si akt i besimit të verbër, si mirësjellje fideiste. kur'ani dhe hadithi dhjetëra herë theksojnë rëndësinë e të përsiaturit dhe të arsyes. Teologu ka nevojë për filozofinë, që besimit të tij personal t'i

sigurojë baza logjike të vlerave diturore të cilat do të jenë në rafsh të arsimimit të tij intelektual.

Feja e shpallur kërkon përsiatje, analizë, thellim dhe sintezë nga besimtari. Duhet të studiohen burimet feta-re, duke mos e ngatërruar filozofinë në çështjet që nuk i përkasin. Ndikimi reciprok i filozofisë dhe i teologjisë është nevojë historike. Teologja sot dëshiron t'u hapet përmasave të reja – historike, antropologjike, ekzistenci-ale, personale dhe të zhvillohet në aspekte të reja – psi-kologjike, shoqërore-politike, ortopraktike etj. Më tej, teologja dëshiron t'i thellojë metodat e veta në aspekt të hermeneutikës.

Në fund, filozofia është fusha e përbashkët e takimit dhe dialogut ndërmjet besimtarit dhe jobesimtarit. Teologu, në një vend dhe në një kohë kur pluralizmi i mendimeve është në shkallë të lartë nuk guxon t'i lejojë vetes atë gabim që të tregohet i paaftë të komunikojë me ata që nuk besojnë, apo besojnë ndryshe. Këto probleme i përkasin fesë së tij, si në aspektin interior ashtu edhe në atë eksterior.

Nuk ka dyshim se filozofia autentike nuk mund të kontribuojë që boza dhe rrathi të bëhet më human, duke vënë dhe respektuar hierarkinë e vlerave.

## IV

Filozofët si edhe studentët e tyre, do të duhej të kishin njohuri adekuate për nocionet kryesore të filozofisë së kohës dhe të mjedisit të tyre, në mënyrë që filozofia t'i përgatisë mirëfilli për jetën dhe profesionin që i pret apo të cilin tashmë e ushtrojnë t'i aftësojë për dialog me njerëzit, me besimtarët dhe jobesimtarët.

## Për artin islam - Skicë -

### Hyrje

Hulumtimet e bëra në fushën e *artit islam* pajtohen se kontributi i tij në familjen e artit botëror është i pavlerësueshëm. Fakti që disa dijetarë nga Perëndimi i theksojnë më tepër ngjashmëritë apo afërsitë e artit islam me mjediset përreth (Bizanti, India etj.)<sup>259</sup> sesa zgjidhjet dhe krijimet e tij burimore, nuk e zbeh origjinalitetin e artit islam. Por, edhe sikur të pranohej ky konstatim, këta mendimtarë duhet ta kenë parasysh përfundimin korrekt të Osvald Spenglerit se “*asnjëherë nuk mund të përcillet fryma e një bote, vetëdije, kulture*”<sup>260</sup>. Arti islam ka huazuar elemente të teknikës dhe të formës nga mjediset me të cilat ka kontaktuar apo tek ka bashkëjetuar, por fryma e islamit ka qenë postullat i pacenueshëm i frysëzimit dhe i veprës

---

<sup>259</sup> Në Perëndim është krijuar bindje e gabueshme se arti islam është më tepër dekorativ, artizanat dhe zejtari, mirëpo studimet e ndryshme rrith artit islam konfirmojnë të kundërtën. Shih disa mendime rrith kësaj temë: Richard Ettinghausen, Ambijent stvoren čovjekovom rukom, në: Bernard Lewis, *Svijet islama, vjera, narodi, kultura*, Beograd, 1979, fq. 61.

<sup>260</sup> Sipas: Nerkez Smailagić, *Klasična kultura islama*, II, Zagreb, 1976, fq. 159.

së artistëve muslimanë.<sup>261</sup> Ndër muslimanët dhe në mjeshter përreth islami nuk ishte dukuri e huazuar dhe e izoluar, por parim dhe kuptim i jetës:

- në pikëpamjen religjioze - bazë e fesë;
- në pikëpamjen politike - bazë kushtetuese e shtetësisë;
- në pikëpamjen ekonomike - rregulli i afarizmit;
- në pikëpamjen etike - stili i mirësjelljes;
- në pikëpamjen edukative - përbajtja e arsimimit.<sup>262</sup>

## Vendi i artit në islam

Pavarësisht nga diskutimet e gjalla dhe kontradiktore, por ende të sipërfaqshme, arti e ka vendin e vet në islam. Sipas disave “vetë kur’ani është vepër artistike”.<sup>263</sup> Entuziazmi fetar, i nxitur jo vetëm nga porosia kur’anore, por edhe nga shkrimi dhe gjuha arabe (kur’anore)<sup>264</sup> si e tillë, ka bërë rrugën e zhvillimit prej artit profan deri te ai sakral, prej femoneneve kozmike deri te fshehtësitë meta-

---

<sup>261</sup> M. M. Sharif, *A History of Muslim Philosophy*, vol. II, Wiesbaden, 1966, sipas: Nerkez Smailagić, op. cit., fq. 397-472; Sejid Husein Nasr, *Vodič mladom muslimanu*, Sarajevë, 1998, fq. 135.

<sup>262</sup> Ibid., fq. 159.

Arti islam sipas R. Garodit shquhet me dy karakteristika:

a) Islami nuk është kundër fotografisë, por kundër idhujtarisë;  
b) Islami më tepër përcakton stilin e artit sesa lëndën e tij. Sipas: Rozhe Garodi, *Islami dhe kultura*, Sarajevë, 1991, fq. 26.

<sup>263</sup> Razgovor o islamskoj umjetnosti, Nur, 2/1992, Beograd, fq. 21.

Arti islam është drejtpërdrejt i lidhur me formën dhe me fyrmen e Kur'anit dhe të Shpalljes islame. Ky art përpinqet ta manifestojë Njësinë e Zotit, duke theksuar mangësitë e kësaj bote dhe permanencën e botës tjetër. S. H. Nasr, op. cit., fq. 136.

<sup>264</sup> Richard Ettinghausen, op. cit., fq. 64-65; Krhs.: Beshir Ajvazoglu, *Islamska estetika*, Shkup, 2002, fq. 21 . . .

empirike, të mbështjella me velin e simboleve me qëllim që t'i zbulojë dhe t'i bëjë transparente. Pohimi se arti është produkt i shkathësisë, si *e drejta* dhe *filozofia* që mbështeten në *kognitio*, nuk qëndron. Konsiderohet se arti është ‘gjetur’ në mësimin islam<sup>265</sup>, është burimor në islam dhe i është përkushtuar fymës islame: individi i tillë kurrë nuk do t'i kalojë kufijtë që i ka vënë islami as që do të krijojë art që është në kundërshtim me religionin e tij.<sup>266</sup> Me fjalë të tjera, nuk ka artist musliman që do të krijojë trupa lakuriqë apo që do ta mirëpresë pornografinë. Ky preokupim shkoi nga piktura e skulptura në drejtim të arabeskës dhe ornamentikës vegjetable dhe gjeometrike.<sup>267</sup>

---

<sup>265</sup> Ndalimi i fotografisë, pikturës, skulpturës në artin islam është në funksion të ruajtjes së monoteizmit të pastër. Çdo gjë që bën aluzion për idhujtarinë përjashtohet nga preokupimet e krijuesve muslimanë. Shih: Titus Burkhart, *Osnove muslimanske umetnosti*, në: Delo – revistë mujore për teori, kritikë dhe poezi, nr. 7/1978, Beograd, fq. 43. Shih studimin serioz: Alija Bejtic, *Ideja lijepog u izvorima islama*, në: O arapsko-islamskoj kulturi, Sarajevë, 1976, fq. 33-34.

<sup>266</sup> Çdo gjë që krijon artisti islam është në shërbim të së gjallës dhe të së qëllimshmes, qoftë kur ka të bëjë me ritualin fetar apo me ndonjë veprim ose nevojë të përditshme. Husref Redžić, *Islamska umjetnost*, Beograd – Zagreb – Mostar, 1982, fq. 19.

Një piktor që jetonte në Medinë e që sapo kishte pranuar islamin, që merrej me art, pikturë (tasvir), iu ankua Abdull-lah ibn Abbasit, bashkëkohësit të Muhammedit a.s.dhe komentuesit të njohur të Kur'anit se nuk dinte ç'të pikturonte, kurse ky i sugjeroi se: “*Nëse patjetër duhet ta punosh këtë, atëherë pasqyro florën (shexher) dhe atë që nuk ka shpirt*”. Hadithi i cituar sipas Sahihut të Muslimit në: Alija Bejtic, op. cit., fq. 37; Po ashtu sipas: Titus Burkhart, op. cit., fq. 43.

<sup>267</sup> Skulptura në islam thua jse nuk ekziston. Disa figura nga koha emevite, e edhe më vonë, do të thoshim, janë me tepër raste të izoluara. Sidomos i gjejmë në miniaturë. Shih: Richard Ettinghausen, op. cit., fq. 66-67; Adnan Silajdžić, *40 Hadisa s tumačenjem*, Zenicë, pa vit botimi, fq. 172.

Muhammedi a.s., lidhur me skulpturën dhe artin figural ka thënë: “... Ine'l-bejte'l-ledhi fihi es-suveru la ted'huluh'ul-melaiketu ...” – “... *Melekët nuk byjnë në shtëpi ku ka fotografi...*”. Sipas: *Sabibu i Muslimit*, Kairo, 1374 h., Libas, 34.

Arti islam me shekuj ka ofruar një mjedis në të cilin muslimanët kanë mundur të jetojnë dhe të veprojnë në gjendjen e përkujtimit të përhershëm të All-llahut, me vizion dhe në kontemplacion të bukurisë që përfundimisht mund të vijë prej All-llahut i cili është i Bukur (el-xhemil) në kuptimin absolut dhe skajor.<sup>268</sup> Në dallim nga arti i krishterë, në të cilin vendin qendror e zë ikona dhe personi me emrin Jezu, në islam arti lidhet me emrin e librit të quajtur Kur'an. Shkruarja e Kur'anit, d.m.th. kaligrafia dhe lexim-këndimi melodik i Kur'anit paraqet apogjenë e hierarkisë së artit islam. Vetëm pastaj vjen arkitektura, sidomos ajo e xhamisë etj.<sup>269</sup>

Domethënë, arti islam, sipas esencës së tij, i përket rrethit kulturor oriental të cilin e karakterizon pikëpamja specifike mbi botën, jetën dhe njeriun. Pa këto karakteristika, arti islam nuk mund të kuptohet, as të përjetohet në gurrën e tij.

## Koncepti i lirisë dhe i artit

Diskutimi rreth artit dhe preokupimi me artin<sup>270</sup> para së gjithash shtron disa pyetje të pakapërcyeshme: *artili - liria* dhe *artisti - liria*. Koncepti i lirisë që prej kohësh është temë bosht. Në rastin konkret koncepti i lirisë duhet të kuptohet në aspekt të artit dhe të disa hulumtimeve në këtë fushë.<sup>271</sup> Nuk duhet harruar njeriun si qenie të dyfishtë: shpirtërore dhe animale dhe çështjen

---

<sup>268</sup> S. H. Nasr, Vodič ..., op. cit., fq. 136.

<sup>269</sup> Shih: S. H. Nasr, *Srce islama*, Sarajevë, 2002, fq. 291.

<sup>270</sup> *Razgovor o islamskoj umjetnosti*, op. cit., fq. 20-24.

<sup>271</sup> Alija Izetbegović, *Islam izmedju Istoka i Zapada*, Beograd, 1988, fq. 92.

se sa mund të veprojnë këto dy fusha absolutisht të pavarura, të lira njëra nga tjetra. Eliminimi absolut i njërit aspekt do të thotë gjyntim i aspektit tjetër. Konceptin e lirisë, sipas mendimit tonë, duhet perceptuar në mënyrë që eliminimi i cilitdo aspekt të mos dëmtojë asnje pjesë të qenies sonë.<sup>272</sup>

## Karakteristikat themelore të artit islam

Arti islam është i veçantë. Ai është i paluhatshëm në aspekt të monoteizmit rigoroz. Ndryshe nga kristianizmi, arti islam e konsideron edhe Pejgamberin e Zotit njeri si njerëzit e tjerë.

Duke analizuar artin islam, Rozhe Garodi vëren disa karakteristika themelore, që artin islam e bëjnë specifik, në krahasim me artet e tjera:

1) *Funksionaliteti*. – Xhamia, si alfa e omega, sipas konstruktit të vet i përgjigjet funksionit të destinuar. Me dallim prej kishës së krishterë dhe tempullit grek, xhamia nuk shërben për të strehuar fotografinë e Zotit as për dekorimin e ceremonive në xhami. Xhamia është sallë për namaz dhe lutje, dhe, në varësi prej vendit të ndërtimit, ka karakteristika lokale, që nuk dalin jashtë funksionit fetar.

2) *Abstraksiioni*. – Konceptimi islam i botës, i njeriut dhe i Zotit e përcakton këtë karakteristikë, sepse arti islam nuk e mbart të dukshmen, por e dëftan abstrakten

---

<sup>272</sup> Ibid., fq. 89-115.

Islami ka nxitur ato forma të artit me të cilat arrihet fisnikërimi i botës dhe forcimi i harmonisë të cilën e kërkon islami. Sepse, njeriu është i lirë aq sa jeton në paqe dhe harmoni me mjedisin ku jeton, kontemplon dhe vepron, duke e pasur parasysh transhendencën absolute të Zotit, monoteizmin rigoroz. Shih: Adnan Silajdić, op. cit., fq. 172.

ose atë, por dëftimin e abstraktes apo asaj që sqarohet vështirë, sqaron sistemin hyjnopr të kozmosit, të shoqërisë dhe të ligjeve të sakta që i përshkojnë të gjitha këto ligjësi. Paull Keli, piktor i madh, për abstraksionin thotë se ai ka bërë rrugë të gjatë që “të padukshmen ta bëjë të dukshme”, sepse abstraksioni nuk e shfaq realitetin, por ritmin dhe ligjshmëritë e tij të vërteta.

3) *Njësia e sakrales dhe profanes*. – Sakralen dhe profanen nuk i ndan ndonjë vijë absolute. Çdo krijim artistik në islam çon në xhami, kurse xhamia çon në namaz, në adhurim, në monoteizëm absolut.<sup>273</sup> I pyetur me një rast se ç'është islami, Titus Burckhardt, perëndimori që më së thelli e njohu artin islam, u përgjigj: “*Shko dhe shikoje xhaminë e Ibn Tulunit në Kairo*”.<sup>274</sup> Me këtë ai latë kuptohet njësia e sakrales dhe profanes, apogjeu i krijimit artistik dhe esenca e islamit.<sup>275</sup>

## Raporti ndërmjet artit, filozofisë dhe misticizmit

Pa personifikimin e ideve abstrakte dhe fakteve të rënda në përdorimin e të folurit figurativ në mënyrën e gjuhës metaforike, filozofi dhe gnostiku do të mbeteshin të shurdhër, kurse vizionet tanshendente që për ta janë aq reale, do të mbeteshin vetëm të tyre. Nëpërmjet të simboleve ata vendosin komunikim me të tjerët rrëth vetes. Në dallim prej mistikëve, shumica e filozofëve nuk e kanë përdorur të shprehurit figurativ dhe metafo-

---

<sup>273</sup> Shih gjerësisht Rozhe Garodi, *Islami dhe kultura*, Sarajevë, 1991, fq. 27-36.

<sup>274</sup> S.H.Nasr, *Srce islama*, op. cit., fq. 290.

<sup>275</sup> Richard Ettinghausen, op. cit., fq. 67-71.

Lexo zërat enciklopedike arabeska, piktura etj. në: Nerkez Smailagić, *Leksikon islama*, Sarajevë, 1990, fq.45, 554, 556 etj.

rik në prezantimin e argumenteve të tyre, që mbështeteshin në të shumtën në logjikë dhe fakte.<sup>276</sup>

Raportet ndërmjet artit, filozofisë dhe misticizmit determinohen edhe nga disa faktorë:

*Faktori hapësinor:* Islami i shkretëtirës, i qytetit dhe i fshatit;

*Faktori kohor:* Islami i fillimit, i zenitit, i tërësive të individualizuara të shteteve;

*Faktori ideor:* sunitët si shumicë dhe harixhitët, mu'tezilitët, shi'itët e të tjera si pakicë;

*Faktori i traditës së ndryshme:* Egjipti, India, Irani, Turqia, Arabia etj. <sup>277</sup>

## Alegoria si manifestim i mendimit abstrakt

Thuajse pa përjashtim konsiderohet se gjuha njerëzore nuk është adekuate të përballet me kërkesat reale të të shprehurit. Për shkaqe të ndryshme, mistikët janë detyruar të përdorin simbole, metafora dhe alegori që do të përkonin me porosit e tyre.<sup>278</sup> Edhe vetë Kur'ani dhe hadithi përdorin shprehje metaforike për të shprehur bukurinë si përjetim estetik.<sup>279</sup>

---

<sup>276</sup> Arti islam nuk është individual, por mbiindividual. Njeriu zbulon me arsyen ligjësitë natyrore, me arsyen zbulon botën e krijuar prej Zotit, me arsyen zbulon edhe bukurinë. Arsyja dhe e bukura janë tabani i veprës artistike ... Shih: Husref Redžić, op. cit., fq. 20.

<sup>277</sup> Nerkez Smailagić, op. cit., fq. 159.

<sup>278</sup> Simbolika luan rol të rëndësishëm në artin islam. Ajo lind nga filozofia dhe religioni islam. Artisti musliman përpinqet të përkufizojë me shprehjen rationale abstrakte unitetin e fenomeneve individuale, me dallim nga artisti bashkëkohor i cili mbështetet në ndërdije dhe në impulset e brendshme individuale. Shih: Husref Redžić, op. cit., fq. 20. Krahaso: Titus Burkhart, op. cit., fq. 45-46.

<sup>279</sup> Kur'an, LIX, 24; XXXII, 7 etj.

Bukuria manifestohet në të vërtetën e Veprës. Kuptimi i së vërtetës na ndihmon ta njohim ligjin e krijimit, kurse kuptimi i bukurisë na ndihmon ta njohim harmoninë e krijimit.<sup>280</sup> Nëpërmjet kësaj, duke përjetuar këtë harmoni të madhe të veprave, marrim pjesë në mënyrë aktive në kënaqësinë e krijimit, me çka shprehja e bukurisë në art bëhet më reale dhe më universale.<sup>281</sup>

## Tri shkallë të filozofisë

Proceset e mendimit të filozofëve në tërësi janë të lidhura në tri mënyra me imagjinatën:

1. Filozofët duhet të ruhen shumë nga mjegullia e imagjinatës, realitetin nuk duhet ta konsiderojnë të mjegulluar dhe mbi shprehjen joreale apo poetike. Rreziku i vetëm i filozofit në këtë rrafsh është mundësia e mashtrimit të tij duke akceptuar hijen në vend të thelbit.

2. Filozofi përdor imagjinatën si instrument që mund ta sjellë shpejt në fushën e Realitetit dhe ky atje t'i shfaket në fotografi të reja, t'i tregohet një përvojë që nuk është e kapshme për filozofët e rinj.

3. Vetë imaginata bëhet objekt i diskutimit, analizohet dhe gjykohet në lidhje me vlerat e saj të brendshme.<sup>282</sup>

---

Muhammedi a.s. ka thënë: “*All-lahu është i bukur dhe e do të bukurën*”, sipas *Sabibut të Muslimit*.

Për të shprehurit hiperbolik, metaforik të nivelit të lartë në islam shih librin e sidomos kapitullin e parë e Frithjof Schuon (Isa Nuruddin), *Dimenzije Islama*, Sarajevë, 1996, fq. 27-45; Krhs.: Beshir Ajvazoglu, op. cit., fq. 39 e tutje dhe 71 e tutje.

<sup>280</sup> Shih observimet e shkëlqyeshme rrëth artit në veprën tashmë të theksuar të Alija Izetbegoviqit, op. cit., fq. 90-93.

<sup>281</sup> Shih: Nerkez Smailagić, op. cit., fq. 166.

<sup>282</sup> *Razgovor o islamskoj umjetnosti*, op. cit., fq. 22.

## Vetëtëhuajësimi

Filozofi nuk duhet të mjaftohet me terminologjinë e diskursit filozofik, por ai duhet të depërtojë thellë në shkencën filozofike dhe këtë ta prezantojë nga një kënd krejtësisht tjetër. Çdo objekt në botë e ka esencën e vet. Edhe njeriu e ka esencën e vet e ajo është vetëdija për individualitetin e tij. Ka edhe të tillë që identitetin e vet nuk e quajnë të vlefshëm dhe kështu vetëtëhuajësohen. Kur'ani e shpjegon tëhuajësimin si ndikim të djallit, i cili e shtrembëron shikimin e njeriut mbi universin, duke e paraqitur atë të rrejshëm dhe iritures. Njeriu degradohet kur largohet nga vija që i lidh me Zotin dhe kur i mungon pikëpamja e identitetit vetjak.<sup>283</sup>

## Njeriu në raport me Zotin

Njohja e pikënisjes së tëhuajësimit imponon njohjen e kufijve të unit të tij. Nëse pranohet ideja se çdo gjë jashtë unit duhet të refuzohet, argumenti i tillë do të na conte në përfundimin se meqë Zoti është jashtë unit tonë, edhe Ai do të duhej lënë anash. Besimtari nuk mund ta pranojë këtë konfuzion, gjendjen pa Zotin, por e pranon njohjen nëpërmjet të Zotit dhe nën hijen (manifestimin) e Zotit.<sup>284</sup>

Krijuesi është një, përkatësisht Atij i përket akti burimor i krijimit. Arti nuk është *krijues*, por *i sendërtuar*, dhe imponon karakterin funksional të tij në dy aspekte:

- estetikisht demonstron *aktin e krijimit* të Zotit si edhe pozitën dhe rolin e krijesës së Zotit dhe;

---

<sup>283</sup> Ibid., fq. 23.

<sup>284</sup> Ibid., fq. 23. Krahaso: Alija Bejtic, op. cit., fq. 42-53.

- kultivimin e jetës duke e humanizuar dhe duke ndjekur modelin e *mirësjelljes burimore* islamë.

Së këndejmi, ideali i tij nuk është as asketizmi as hedonizmi. Asketizmit i kundërvihet ideali i plotësisë së jetës, që e rekomandon Kur'ani dhe hadithi, kurse hedonizmit i kundërvihet qëllimi absolut i krijimit në islam.<sup>285</sup>

## Përmasat

Nëse e pranojmë idenë se Zoti është i gjithëmundshëm, atëherë uni ynë do të shkrihet në Të. Nëse dëshirojmë ta ruajmë unin tonë, ne duhet ta braktisim idenë për Zotin absolut. Analiza e kësaj çështjeje zbulon se uni ka disa përmasa. Një përmasë, sipas natyrës së tij, është *historike*<sup>286</sup> që do të thotë, nëse jemi të vetëdijshëm për prapavijën vetjake historike, ne do ta humbim pikëpamjen mbi një aspekt tonin. Nëse nga ana tjeter e neglizhojmë prapavijën tonë *kulturore* dhe *religioze*,<sup>287</sup> atëherë do ta humbim pikëpamjen mbi aspektet e tjera të rëndësishme të qenies sonë. Në këtë mënyrë, nëse nuk jemi në kontakt me artin dhe literaturën e vendit tonë, d.m.th. me faktorin *hapësinor*,<sup>288</sup> atëherë do të varfërohem, do të na mungojë gjerësia. Tërë kjo provon se pikëpamja që ne kemi për veten është diçka krejt tjeter nga e Vërteta. Të gjitha këto pikëpamjet rrjedhin në prapavijën tonë si përrrenjtë që rrjedhin në det. Ajo është personaliteti i dikujt, kurse Zoti është burimi nga i cili rrjedh çdo fuqi. Mohimi i këtij burimi është mohimi i vvetvetes, kurse mohimi i vvetvetes është vetëtëhuajësimi.<sup>289</sup>

<sup>285</sup> Gjerësishth shih: Nerkez Smailagić, op. cit., fq. 164.

<sup>286</sup> Ibid., fq. 162.

<sup>287</sup> Ibid., fq. 159-160.

<sup>288</sup> Ibid., fq. 160-161.

<sup>289</sup> Koncepti perëndimor i artit dhe i estetikës nuk pranon ekzistencës e artit jashtë aktivitetit të njeriut dhe shpirtit të tij. Ky koncept nuk e njeh

## Ndikimi i artit islam

Tradita artistike e islamit ka bërë ndikim të madh jo vetëm brenda botës muslimane, por edhe brenda qytetërimeve që e rrethonin. Njëkohësisht, edhe arti islam ishte nën ndikim të caktuar të artit kinez, indian etj. p.sh. në muzikë, punimin e qilimave e aspekte të tjera.<sup>290</sup>

Arti islam ndikoi edhe në Perëndim në aspekte të ndryshme të artit, si në muzikë, poezi, arkitekturë, miniaturre etj,<sup>291</sup> jo vetëm në trajtë dhe formë.<sup>292</sup> Ai ndikoi në konceptimin e esencës së islamit dhe është rruga e mesme në përcjelljen e porosisë së tij të bota bashkëkohore islame dhe joislame.

## Përmbyllje

Arti islam dhe historia e tij është temë pak e njohur në botën islame dhe tejet e panjohur në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare. Nga një pjesë e intelektualëve islamë arti trajtohet si joislam. Pos disa shkrimeve të shkurtra për disa aspekte të artit, ai është ‘botë’ ende e panjohur. Mangësia e studimit të artit islam pa dyshim e varfëron historikun e pasur islam si në botë ashtu edhe në tokat shqiptare. Kjo mangësi i varfëron edhe përmasat e shumta, ende të pazbuluara të kulturës dhe të qytetërimit islam si në botën islame ashtu edhe në tokat shqiptare. Disa lëvizje në këtë aspekt, megjithatë, të jepin zemër.

---

bukurinë artistike dhe estetike si artistike, me çka ai mohon llojet e tjera të bukurisë: hyjnore, kozmike, bukurinë e natyrës dhe bukurinë e objekteve inorganike si prodhime të njeriut.

<sup>290</sup> Për ndikimet reciproke ndërmjet artit islam dhe atij fqinjësor e më gjerë në art lexo: Richard Ettinghausen, op. cit., fq. 76 dhe 305-316; Beshir Ajvazoglu, op. cit., fq. 33...

<sup>291</sup> Sejid Husein Nasr, *Vodič mladom muslimanu*, Sarajevë, 1998, fq. 148-149.

<sup>292</sup> Rozhe Garodi, *Islami dbe kultura*, op. cit., e sidomos: fq. 34-36.

## Kthimi në burimet – si të kuptohet selefizmi?

Islami i hershëm konsiderohet bërthamë dhe kristalizim i realizimeve të tij themelore shpirtërore dhe historike. Ai është civilizim ndërmjetësues midis antikitetit renesansës dhe paraqet formësimin fondamental dhe kreativ të islamit të hershëm në sistemin unik dhe grandioz kulturor, prandaj i gjithë zhvillimi i mëvonshëm i islamit është vetëm vazhdimësi e zhvillimit klasik, qoftë pozitivisht - në përpunimin e tyre të mëtejshëm, qoftë negativisht - në rezistencën në emër të kthimit drejt mendimeve dhe porosive burimore.<sup>293</sup>

Duke e marrë parasysh se fondamentalistët kërkojnë “evitimin e shtresimeve historike nga komentimi dhe praktika islamë” kurse “përvojës së Bashkësisë së hershme muslimane në Medine i japid karakter normativ dhe e konsiderojnë për arketip, e jo shembull historik të realizimit të islamit”, konsiderojmë të nevojshme të kihen parasysh edhe këto çështje:

- Fjala *burim*, të kuptuarit *orgjinar* të burimit të një tradite fetare ngërthen domethënien se nuk bën që burimi i caktuar i fesë (ose i traditës përgjithësisht) të kuptohet ndryshe pos sipas mënyrës së ashtuquajtur *të kuptuarit të parë të burimit*. Sipas kësaj teze, kohët e tjera nuk kanë të drejtë në të kuptuarit vetjak të burimeve të fesë.

---

<sup>293</sup> S. H. Nasr, Tradicionalni islam i moderni svijet, Sarajevë, 1994, fq.

- *Sintagma tē kuptuarit e parë originar tē burimit*, sipas kësaj teze, do tē thotë se *burimin përkatës* e kanë kuptuar drejt vetëm recipientët e parë. Breznitë e mëvonshme, do ta kuptojnë në mënyrë korrekte burimin vetëm nëse nuk kanë koncept dhe receptim vetjak, por konceptim dhe receptim tē huaj tē burimit. Kjo po ashtu d.m.th. me sintagman “*tē kuptuarit e parë originar tē burimit* në një kohë oktroizohet,” që tē shërbejë si model për kohët e mëvonshme.

Nëse çështja e shtruar kundrohet nga pikëpamja e përgjithshme, fjala *burim* ka kuptimin edhe tē burimit, gurrës së përbershme, tē pandalshme. Për islamin burim i fesë është Fjala e Zotit, që buron gjithmonë e nuk shteret, prandaj brezi i parë i recipientëve as nuk ka mundur as nuk ka guxuar ta orientojë këtë burim drejt tē kuptuarit përfundimtar, sepse në islam nuk ekziston grup apo bashkësi, kohë apo hapësirë e privilegjuar. Brezi i parë nuk ka tē drejtë ta pranojë islamin në emër të tē tjerëve. Këtë mund ta vërejmë edhe te imami i madh Ebu Hanife,<sup>294</sup> por edhe te imamët e dijetarët e tjerë.

Në këtë aspekt, duhet pasur kujdes ndaj pikëpamjeve që e mbërthejnë njeriun apo brezin e caktuar brenda traditës së caktuar, duke ia mohuar tē drejtën për tē kuptuarit e drejtpërdrejtë tē Burimit hyjnor.<sup>295</sup> Prandaj, çdo “kthim prapa” duhet tē ketë parasysh këtë që vijon:

---

<sup>294</sup>Shih: N. Ibrahim, “*Shkolla juridike banefite dhe karakteristikat themelore tē doktrinës së saj*”, Shkup, 1998.

Husein Gjozo insiston në tē kuptuarit e Kur'anit për çdo brez apo kohë, sepse Kur'ani është mu'xhize dhe çdo brezi apo kohe i afrohet njësoj. Shih: Husein Gjozo, “*Islami në kohë*”, Shkup, 1993. Krhs.: Husein Djozo, Vraćanje šerijatu, Glasnik VIS-a në SFRJ, nr. 3/1982, Sarajevë, fq. 249-258.

<sup>295</sup>Adnan Silajxhiqi pohon se tradita ka rëndësi tē trefishtë: 1) Konstituive - konstituon praktikën e një kolektivi; 2) Kontinuitive - ruan atë që është krijuar dhe çka duhet tē përcillet më tej dhe tē pasurohet; 3) Edukative - vetëdija e gjatë mbi veten dhe vullnetin për gjurmime. Shih: Adnan Silajdžić, “*Muslimani izmedju tradicije i suvremenosti*”, ligjëratë e mbajtur në Këshillin e Kongre-

1. Tradita nuk mund t'i zëvendësojë burimet, as ta marrë vendin e tyre. Në islam as tradita teologjike *nuk është* burim i fesë, por konceptim njerëzor i burimeve të fesë në një kohë, në një vend, në një disponim shpirtëror. Fondamentalizmi i skajshëm i jep atributë hyjnore asaj që është vetëm një perceptim njerëzor. Kur'ani është gjithnjë i hapur për komentime të reja, së këndejmi nuk ka *përkthime* përfundimtare të Kur'anit, ngase ky libër nuk mund të përkthehet për të gjitha kohët, me një përvojë, por duhet të përkthehet rishtazi.

2. Fondamentalizmi i skajshëm nuk miraton të ashtu-quajturin *fondamentalizëm pozitiv* të islamit. Me fondamentalizmin pozitiv në islam nënkuuptojmë kthimin te themellet islame, Kur'ani dhe Suneti, nga koha e vet dhe në mënyrën e përfshirjen e plotrëndësishme të rrjedhës së burimeve të Burimit nga disponimi i vet shpirtëror. Komentimi i Kur'anit nga koha e vet, e bën produktive dhe e pasuron traditën e islamit dhe nuk i lejon traditës që të shndërrohet në *tradicionalizëm*. Në islam Kur'ani është *themel* jo në kuptimin e një dokumenti që (që në shekullin VII) është mbyllur një herë në një tërësi kuptimore të oktroizuar, por ai është *themel* në pikëpamje të Burimit të *pashtershëm*. Prandaj, fondamentalizmi pozitiv shkurtimisht d.t.th.: t'i jepet mundësia çdo kohe që t'i drejtohet Kur'anic e të mos pranohen pa rezervë komentimet e kaluara si skemë statike dhe model shembull.

3. Fondamentalizmi i skajshëm apo negativ nuk është i vetëdijshëm për dëmin që bën kërkesa e tyre për restaurimin dhe rikonstruimin rigoroz të jetës së musilimanëve të Epokës së Parë (nga Meka dhe Medina), me çka feja ngushtohej në dy qytete të një zone gjeografike, *lidhet* për një vend dhe *kufizohet* me një popull, me

---

sit të intelektualëve bosnjakë në Sarajevë më 1995, e ribotuar në "Selam" - revija za kulturë, vjetri i nauku, Prizren, 6/1996, fq. 11.

arabët, kështu që bie ndesh me natyrën universale të Kur'anit. Zoti nuk është Zot vetëm i një epoke, vetëm i një populli, vetëm i një vendi, por Zot i të gjitha kohë-rave dhe vendeve, Zot i parakohës dhe i paskohës, Zot i të gjitha botëve.

Fondamentalizmi pozitiv pra, i konsideron burimet islame si shembuj gjithnjë frymëzues për krijimin e formave të reja të praktikës shoqërore. Kthimi permanent në këto burime dhe refleksioni historik i frymës muslimane nëpërmjet prizmit të tyre në rrjedhën kulturore - civilizuese të islamit, kanë ruajtur identitetin e muslimanëve dhe vitalitetin në takimet dhe integrimet kulturore.

# **Libri islam dhe perspektiva e tij**

*“Nun, betohem në pendën dhe në atë çka shkruajnë!”*  
(El-Kur'an, El-Kalem, 1)

*“O ti që kërkon libra, ik nga unë, sepse është turp  
i madh që unë të të huazoj libër.  
Libri është e dashura ime në këtë botë,  
Vallë, ke parë ndonjëherë se e dashura  
i huazohet dikujt tjetër!?”*  
(Zamahsheriu)

## **Hyrje**

Lapsi, letra, libri dhe mjetet e tjera para tyre janë shumë të hershme.<sup>296</sup> Gjurmët e tyre nga kulturat dhe civilizimet e lashta kanë arritur deri në ditët tona.<sup>297</sup> Këtë na e konfirmojnë edhe librat e shenjtë, e sidomos Kur'ani, duke vërtetuar se pejgamberët e Zotit, gjatë

---

<sup>296</sup> Temë e lexuar në Seminarin V për imamët dhe kuadrin fetar të Bashkësisë islamë të Kosovës në Prishtinë më 27 dhe 28 tetor 2001.

<sup>297</sup> Shih: Aleksandër Stipçeviq, Historia e librit, Prishtinë, 1988. Po ashtu: Robert Escarpit, Revolucija knjige, Zagreb, 1972, fq. 14 etj. Qysh kinezët e njihnin shtypin. Edhe fatimitët në Egjipt e njojin, por ky shtyp ishte primitiv dhe mund të ekzekutohej pak shkrim. Zbulimi i Gutenbergut më 1450 ishte revolucion. Shih: Mehmed Handzic, Izabrana djela, VI, Sarajevo, 1999, fq. 23.

historisë kanë pranuar mesazhe nga Krijuesi i tyre.<sup>298</sup> Burimet arkeologjike dhe librat e shenjtë dëshmojnë se shkrimi dhe leximi janë të lashtë, duke filluar nga format më primitive drejt atyre më të përsosura,<sup>299</sup> duke u shndërruar si mjetet për shkrim ashtu edhe vetë shkrimi.<sup>300</sup>

Nacioni *liber*, që ndër ne mbizotëron një kohë të gjatë, është fjalë latine me domethënien në zanafillë: lëkurë druri (pemësh), pergamenë e mbështjellë; kapitull, listë, katalog; letër, mesazh.<sup>301</sup> Në Romën e vjetër me nacionin “liber” kuptohej teksti i shkruar në letrën e papirusit.<sup>302</sup>

---

<sup>298</sup> Shih: El-Kur'an: el-Hixhr, 10; Er-Rrum, 47; Gafir, 78 etj. Shih: N. Smailagic, Leksikon islama, Sarajevo, 1990, fq. 432. Mesazhet hyjnore te pejgamberët janë quajtur suhufe dhe kitabe. Musai a.s. mesazhin hyjnor e ka pranuar në formë pllakash. Shih: Mehmed Handzic, op. cit., fq. 12.

<sup>299</sup> Shkrimi ka kaluar nëpër tri fazë kryesore: 1) Shkrimi nëpërmjet figurave, 2) Shkrimi kalimtar (mes fazës së parë dhe asaj që do të pasojë) dhe 3) Shkrimi modern, ku çdo tingull ka shkronjën e vet. Po ashtu, shkrimet i kemi nga e majta në të djathëtë, nga e djathta në të majtë dhe nga lartë poshtë. Shih: Mehmed Handzic, op. cit., fq. 13 – 14.

<sup>300</sup> Fillimi i Kur'ani është shkruar në lëkurë, kore të hurmës, eshtra, pllaka guri etj. Shih: Muhammed Hamidull-llah, Muhammed a.s. – Život i djelo, I – II, botimi II, Sarajevë, 1981. Sultan Ahmed Qureshi, Letters of the Holy Prophet, (Lahore, Pakistan, ).

<sup>301</sup> Henrik Lacaj – Filip Fishta, Fjalor latinisht – shqip, Prishtinë, 1980, fq. 281.

Fillimi i Kur'ani është shkruar në pllaka qerpiçi, deltine, duke e bërë së pari pllakën e pastaj duke e gravuar shkrimin në të. Kjo pllakë sërisht është pjekur, për t'u ruajtur më gjatë. Kështu është vepruar në Asiri dhe Babiloni, gjë që e provojnë bibliotekat e gjetura. Shih: Mehmed Handzić, op. cit., fq. 11.

<sup>302</sup> Pravna enciklopedija, I, Beograd, 1989, fq. 182 – 183 dhe 724. Po ashtu: Mehmed Handzic, op. cit., fq. 11. Ndër librat më të vjetër është: Veda, Mahabharata, Ramajana, Upanishada, Zend-Avesta, Epi i Gilgameshit etj.

El-Kehf, 109; El-Kalem, 1-5; Ali Imran, 3; El-Mulk, 1 etj.

## Libri në burimet islame

Në burimet islame dituria (lapsi, letra etj.) qëndron në piedestalin më të lartë. All-llahu xh. sh. Nxit, nëpërmjet ajeteve të shumta,<sup>303</sup> mësimin dhe përsiatjen, bethet në laps dhe të obligon të analizosh shumë çështje të botës fenomenale (alem ‘ush-shehadeh). Ata që merren me statistikë konsiderojnë se ajete të tilla janë rrëth 850.

Diturinë, leximin, lapsin, letrën, librin e të ngjashme Muhammedi a.s. i ka vënë, nëpërmjet thënieve, rekomandimeve, miratimeve dhe veprimeve të tij, në nivelet më të larta. *Kërkimi i diturisë prej djepit deri në varr; Kërkimi i diturisë qoftë edhe në Kinë; Kërkimi i diturisë për çdo musliman (dhe muslimane)* e shumë të tjera, flasin qartë për këtë problematikë.<sup>304</sup>

Një fjalë e urtë arabe Kul-lu shej'in shej'un, we'l-xhehlu lejse bi shej'in (Çdo gjë është diç, kurse injoranca është hiç)<sup>305</sup> dhe një fjalë e urtë 'Sa di, aq vlen', dëftojnë në mënyrë eksplikite rëndësinë e lapsit dhe të letrës, d.m.th. të librit.<sup>306</sup>

---

<sup>303</sup> El-Kehf, 109; El-Kalem, 1-5; Ali Imran, 3; El-Mulk, 1 etj.

<sup>304</sup> Buhariu, Kitabu'l-ilmi; Muslimi, Kitabu'l-ilmi; Imam Neveviu, Rijadu's-salihin etj.

<sup>305</sup> Behar – List za pouku i zabavu, 1902 – 1903, Sarajevo, fq. 229.

Glasnik VIS-a, 4/1990, Sarajevo, fq. 91 - 98, intervistë e S. Serdarit me Kemal Hasanin – profesor nga Malajzia rrëth nocionit Kitab.

<sup>306</sup> Glasnik VIS-a, 4/1990, Sarajevo, fq. 91 - 98, intervistë e S. Serdarit me Kemal Hasanin – profesor nga Malajzia rrëth nocionit Kitab. Në arabishtë kitab, infinitivi i foljes ketebe – jektubu. Shih: Tewfik Muftic, Arapsko-bosnaski rječnik, I, Sarajevo, 1973. *Kitab* quhet edhe Kur'ani (El-Bekare, 2). Shih gjerësisht: Zagorka Janc, *Islamska minijatura*, Beograd, Zagreb, Mostar, 1988, fq. 25.

## Libri gjatë historisë islamë

Shekujt e parë të islamit janë themele të denja për zhvillim të gjithanshëm dhe solid të muslimanëve deri në ditët tona. Thesari i bibliotekave të Bagdadit, Kairos, Kajrevanit, Kordobës, pastaj të Stambollit, Sarajevës, Shkupit, Prizrenit etj. provon qëndrimin e drejtë që kanë pasur muslimanët ndaj diturisë dhe ndaj fjalës së shkruar në të kaluarën.

Si objekt trajtimi, libri<sup>307</sup> e sidomos Kur'ani në shtëpitë muslimane ka qenë tejet i respektuar. Libri është konsideruar miku më i mirë që na ndjek tërë jetën, që na mbron shpirtërisht e fizikisht, na rafinon shpirtin dhe mendjen.<sup>308</sup> Ai është ruajtur në raft të veçantë, shpesh nëpër rafte të gravuara, kurse të pasurit e kanë ruajtur në rafte të dekoruara me gurë të çmuar, me sedef, me eshtra etj. Libri, po ashtu është ruajtur edhe nëpër dollapë, nëpër arka speciale etj, kurse në xhami, Kur'ani dhe librat e tjerë fetarë janë ruajtur në kuti të posaçme dhe janë lexuar nëpër peshta e rahle.<sup>309</sup>

Nëse i hedhim një sy historisë islamë ndër iliro-shqiptarët, do të shohim se numri i madh i librave muslimanë dhe i muslimanëve në shekullin IX në mbretërinë e atëhershme bullgare (toka të pushtuara iliro-shqiptare) ka qenë problem për kanin bullgar Borisin dhe për papën

---

<sup>307</sup> Në arabishtë *kitab*, infinitivi i foljes ketebe – jektibu. Shih: Teufik Muftić, *op. cit.*

*Kitab* quhet edhe Kur'ani (El-Bekare, 2).

<sup>308</sup> Shih gjerësisht: Mehmed Handzic, *op. cit.*, fq. 11.

Shih gjerësisht: Zagorka Janc, *op. cit.*, fq. 25.

<sup>309</sup> Gjerësisht: Zagorka Janc, *op. cit.*, fq. 25.

e Vatikanit, mirëpo papa i sugjeroi Borisit që t'i digjte librat muslimanë sepse Bibla u mjafton të krishterëve.<sup>310</sup>

Po ashtu, ka indikacione se letra është prodhuar edhe te ne në Ballkan, edhe te shqiptarët, në shekullin XVI e XVII, që flet mjaft se lapsi, letra, leximi e mësimi, mjetet për shkrim, zeja e përshkrimit e tj. ishin çështje me rëndësi te të parët tanë.<sup>311</sup>

Kam bindjen se të parët tanë, ndonëse nga të tjerët edhe sot e kësaj dite quhen si të prapambetur e primitivë, janë udhëhequr nga mësimet kur'anore e sunetike ndaj librit. Janë udhëhequr, fjala vjen, nga mësimi i Ibn Xherir et-Taberiut (vdiq 310 H.), i cili brenda një dite shkruante 40 faqe libri, nga shembulli i Imam el-Gazaliut, Ibn Arebiut, Ibn Tejmijes, Ibn Kajim el-Xhevziut, Askalaniut, Sujutiut, nga shembulli i muhaddithinëve (Buhariu, Muslimi), i fekihëve (Ebu Hanife, Ebu Jusufi, Shejbaniu, Shafiu, Maliki), duke udhëtuar më këmbë, me kalë e deve, muaj të tërë për një çështje fetare, si shembull për ne, nga shembulli i Suzi Prizrenit, me bibliotekën e tij të parë në Kosovë, të legalizuar në vitin 1513<sup>312</sup>, i Mesih Prishtinasit, etj.

---

<sup>310</sup> Shih gjerësisht: N. Ibrahim, Islami në Ballkan para shekullit XV, botimi II, Prizren, fq. 60 – 61 dhe poshtëshënimi 77 në fq. 75. Krhs.: Nexhat Ibrahim, Islami dhe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar (sheku i IX-XIV), Shkup, 2003, fq. 15-38.

<sup>311</sup> Shih gjerësisht: Zagorka Janc, op. cit., fq. 28 - 29.

<sup>312</sup> N. Ibrahim, *Suzi prizrenasi – dijetar dhe bamires i shek. XV-XVI*, Prizren, 1990/1411. Dihet se ndër bibliotekat më të vjetra në botë janë Biblioteka e Asurbanipalit në Kujunxhik-Hisar, Biblioteka e Ramzesit të Madh në Egjipt, Biblioteka e Pizistratit në Athinë, Biblioteka e Ptolemeut në Aleksandri në Egjipt, bibliotekat e shumta të muslimanëve në Lindjen islame: Bagdad, Samerkand, Kufe etj. dhe në Perëndimin islam: Kordobë, Toledo, Granadë, Kairo etj. Shih: Mehmed Handžić, op. cit., fq. 18 – 21.

## **Faktorët që ndikuan në indiferentizmin e muslimanëve ndaj librit**

Por, kjo që u theksua quhet e kaluar dhe sado e shkëlqyeshme dhe e bukur, prej saj mund të mësohet por jo edhe të jetohet. Me këto rezultate mund dhe duhet të mburremi aq sa jemi në gjendje të lëmë gjurmë tonë në të tanishmen dhe sa jemi në gjendje të krijojmë predispozicionet për veprim të brezave të ardhshëm. Gjendja aktuale ndaj fjalës së shkruar ndër ne mund të diagnostifikohet si e pamjaftueshme, madje e patolerueshme, e herë-herë edhe komprometuese.

Kjo gjendje është pasojë e shumë faktorëve:

*Faktorët eksternë:*

1) Luftërat e vazhdueshme kundër muslimanëve në këto troje; 2) Mbyllja, shkatërrimi dhe zhdukja e medreseve dhe e institucioneve të tjera arsimuese islame; 3) Mbyllja dhe shkatërrimi i xhamive dhe, rëndom, krahas tyre, i bibliotekave të xhamive; 4) Burgosja dhe vrasja e kuadrit fetar dhe neutralizimi i të tjerëve me frikë, shantazhe etj.; 5) Humbja e identitetit autokton të popullit dhe përpjekja me çdo kusht për “evropeizim” në të gjitha fushat e jetës etj.<sup>313</sup>

*Faktorët internë:*

1) Dezintegrimi i kuadrit fetar dhe i njerëzve autoritativë fetarë; 2) Mosrezistimi aktiv kundër synimeve të jashtme qëllimkëqija; 3) Prania e kompleksit të inferioritetit në mesin e kuadrit fetar dhe të tjerëve; 4)

---

<sup>313</sup> Shih: Sejid Husein Nasr, Tradicionalni islam u modernom svijetu, Sarajevë, 1994; Nexhat Ibrahim, Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve, (pjesa e parë e librit), Shkup, 1998.

Kundërvënia e pakicës kundrejt të ashtuquajturave vlera të huaja me metoda diletantiste, josistematike, jokonzistente dhe jointelektuale; 5) Izolacionizimi dhe getoizimi i pjesës elite të kuadrit fetar në segmente të caktuara të sunizmit historik, duke treguar skepticizëm dhe rezistencë ndaj vlerave dhe mendimeve të tjera dhe nga tjetërkush; 6) Bindja e një pjese të ulemasë se nuk mund të kritiko-hen, sidomos nga brenda, edhe kur kritika është qëllimire; 7) Mbështetja e pjesës dërrmuese të ulemasë në zgjidhje të gatshme të huaja, duke humbur kështu kreativitetin dhe duke u vonuar në marrjen e përgjegjësisë për zgjidhjen e problemeve fetare në vendin ku jeton; 8) Qëndrimi edhe më tej në komoditetin oriental, siç do ta quante Hegeli, duke mos zbritur në realitetin botëror me forcat vetjake;<sup>314</sup> etj.

## Perspektiva e librit ndër ne

Si të dilet nga gjendja aktuale?

Pa e përcmuar e zhvlerësuar asnijë nga faktorët e cekur e të pacekur këtu, do t'i theksojmë edhe disa çështje, disa propozime, të cilat, ma do mendja, për fillim do ta zbutnin mjaft gjendjen e tanishme:

1) Themelimi i një shtëpie botuese në kuptimin e plotë të fjalës, përkatësish shndërrimi i kësaj të sotmes, me liri dhe me përgjegjësi të plotë pune; 2) Hartimi i

---

<sup>314</sup> Dy pikat e fundit i artikulova nga: Nijaz Sukrić, *O povijesti i savremenom stanju naše vjerske pisane riječi*, Islamska misao, nr. 88 – 89, Sarajevo, 1986, fq. 8 – 9.

Gjerësisht përfaktorin intern përdobësitë muslimane shih: Fazlur Rahman, *Duh islamia*, Beograd, 1983; dhe: Muhammed Ikbali, *Obnova vjerske misli u islamu*, botimi II, Sarajevë, 2000.

planeve afatgjatë dhe afatshkurtër dhe i planeve perspective lidhur me veprimtarinë botuese; 3) Hartimi i akteve normative për veprimtarinë botuese dhe avancimi i tyre i vazhdueshëm për tërë procesin e punës: dorëshkrimi → redaktimi → censurimi → lekturimi → shtypja e deri te shpërndarja e librit dhe kthimi i mjeteve nga librat e shitur te botuesi etj. 4) Hartimi i elaboratit mbi përparësinë e tematikës që duhet shkruar apo përkthyer dhe i autorëve që duhet përkthyer nga gjuhët e tjera në gjuhën shqipe etj. 5) Organizimi i shpeshtë i takimeve të niveleve të ndryshme për të ndërgjegjëzuar dhe për të vetëdijësuar kuadrin fetar, por edhe lexuesin për vlerën, rëndësinë, nevojën për blerjen dhe leximin e librit; 6) Botimi i librave për fazën parashkollore, të shkollave fillore, të mesme, për universitete dhe studime të veçanta; 7) Bashkësia Islame të angazhohet që dija dhe djersa e punëtorëve të saj të mos keqpërdoret nga botuesit privatë, shoqatat e ndryshme etj.; 8) Veprat e rëndësishme, si përkthimi i Kur'anit, Buhariu, dhe veprat me vlerë kapitale etj., që tani botohen privatisht, të përqëndrohen brenda Bashkësisë islame; 9) Të vendoset një bashkëpunim cilësor ndërmjet kryesisë BI dhe këshillave të BI lidhur me botimin e veprave me interes për muslimanët dhe për shpërndarjen më të mirë; 10) Kryesia e BI dhe bashkësitë islame komunale të angazhohen për hapjen e librarive islame e qoshqeve dhe të merret pjesë në të gjitha panairët e librave; 11) Botimi i librave që trajtojnë arsimin, edukimin dhe historinë e tyre; 12) Ndekja, mbështetja dhe ndihmesa në zhvillimin e programeve edukativo-arsimore në mektebe, në shkolla, medrese e fakultete; 13) Mobilizimi i të gjithë atyre që dinë dhe dëshirojnë ta çojnë përparrë edukimin dhe arsimimin institucional të muslimanëve; 14) Të vendosen, të zhvillohen dhe të mbahen kontakte me institucionet eduka-

tivo-arsimuese, shkencore përkatëse (universiteti, akademia, muzeumi, arkiva, institutet etj.); 15) Të bëhen hulumtime dhe kërkime dhe të ofrohen përgjigje për provokimet intelektuale të besimeve dhe ideologjive të ndryshme (siç është p. sh. vepra *Ceta e profetëve* prej Pjetër Bogdanit, *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve* prej Shan Zefit etj.; 16) Bashkësia Islame e Kosovës në bashkëpunim me bashkësitë islame komunale definitivisht të vendosë të reagojë ndaj *izmave* që kohëve të fundit infiltrohen nga vendet arabo-islame e vende të tjera, të servuara nëpërmjet individëve apo shoqatave; 17) Të vendoset kontakt dhe bashkëpunim me të gjithë botuesit seriozë privatë të librit islam; 18) Të formohet një grup ekspertësh të shkencave islame të cilët do të trajtojnë problematika të ndryshme me interes për bashkësinë islame dhe do të ofrojnë përgjigje intelektuale; 19) Të bëhen hulumtime analitike, sintetike dhe statistikore për ndihmën dhe përparimin e procesit edukativo-arsimor ndër muslimanët; 20) Të shkruhet dhe të përkthehet literatura përkatëse për njohjen e natyrës së botës moderne, për orientimet antireligioze shekullare, laike, moderniste e postmoderniste, e jo të vetëkënaqemi me izolimin dhe getoizimin tonë duke rropatur në vend; 21) Të punohet për zhvillimin e institucionit të familjes dhe të rëndësisë së saj për afirmimin e vlerave fetare dhe tradicionale; 22) Në fund, përgjegjësia për korrektësinë dhe fatin e fjalës së shkruar islame bie edhe mbi ata që shkruajnë edhe mbi ata që lexojnë...

Me përmirësimin e strukturës profesionale dhe kualifikative të ulemasë sonë me të drejtë pritet që fjala e shkruar të dalë nga anemia dhe stereotipi ekzistues, nga puna individuale në atë ekipore, nga puna *ad hoc*-i në punë me projekte me planifikim.

## Përfundim

Këto janë disa përsiatje e sugjerime të njoitura për ju, e megjithatë të shkruara e të shtruara për ju. Organizatorit do t'i rekomandoja që viteve të ardhshme të ndahen temat për ligjërim disa muaj më herët, në mënyrë që para auditoriumit të shtrohen studime teorike, analiza komparative e hulumtime nga terreni, e jo shkrime të shkruara në shpejtësi dhe pa ndonjë analizë të thellë.

Ky shkrim nuk e obligon askë, por mund të shërbejë si pikënisje për studime e hulumtime serioze.

## **Mësimi islam në shkollat laike, në mektebe dhe në mediume**

### **Hyrje**

Maksima e njohur e Pejgamberit a.s. “*Përcilleni prej meje qoftë edhe një ajet*” prej kohësh i ka preokupuar shumë dijetarë muslimanë. Janë shkruar vepra të shumta përkëtë qëllim. Në kohën bashkëkohore maksima e lartëcituar preokupon, pos individëve edhe institucionale të shumta muslimane. Mirëpo, gjatë historisë është krijuar njëfarë konfuzion didaktik meqë teksti i cekur është perceptuar dhe konceptuar pjesërisht, mekanikisht e tautologjikisht, që solli ‘*monotoninë informatike*’. . .

Ku shihet rrugëdalja?!?

### **Mësimi islam në shkolla - plan-programi i mësim-besimit dhe i kulturës së religjioneve**

Historia e mësim-besimit në trojet shqiptare është e lashtë<sup>315</sup>. Në shekullin XX mësim-besimi është aktiv me largimin e Perandorisë Osmane nga Ballkani pas vitit

---

<sup>315</sup> N. Ibrahim, *Islami dbe muslimanët në tokat shqiptare dbe në Ballkanin mesjetar*, Shkup, 2003.

1912. Në atë kohë mësim-besimi u përgjigjej nevojave dhe kërkesave të kohës, prandaj edhe sot ai duhet të jetë përputhje me nevojat dhe kërkesat e kohës. Për këtë arsy, është e domosdoshme që çdo kohë t'i përkufizojë:

*synimet e mësim-besimit* (mësimi, aftësimi dhe arsimimi fetar..),

*programin e mësim-besimit* (t'i jepet rëndësi traditës didaktike apo karikulume),

*Burimet, mënyrat, format e prezantimit të përbajtjes së mësim-besimit* (më parë janë praktikuar kryesisht burimet direkte, kurse sot më shumë burimet indirekte, mediale),

*Situatën e gjendjes aktuale* (cilësinë dhe gjerësinë e mësimit, mundësitë teknike-ekonomike të formësimit të shkathësive, kushtet natyrore-sociologjike të kultivimit dhe të zhvillimit të aftësive).

## a. Zvogëlimi i vëllimit të plan-programit mësimor të mësim-besimit

Plan-programi aktual, pa pikë dyshimi, është larg plan-programit ideal, prandaj shndërrimi i tij cilësor dhe sasior është i domosdoshëm. Gjendja e tanishme jo vetëm që është barrë psiko-fizike për nxënësit, por nga viti në vit po kalon në sindrom averzioni, anakronizmi, në varësi nga diktati politiko-social dhe arsimor-shkençor. Në këtë situatë rrugëdaljen e shohim në zvogëlimin sasior të vëllimit të plan-programit arsimor. Ky zvogëlim nuk guxon të bëhet *ad-hoc*, pa u inkorporuar me aspektet e tjera të prezantimit të mësimit islam, gjithnjë duke e pasur parasysh trekëndshin: *shkolla – mektebi – media*. Të gjitha këto, kuptohet, nëse mësim-besimin e marrim si çështje që do të futet në sistemin arsimor në Kosovë.

Konsiderojmë se në bankat e shkollës do të duhet të prezantohen çështjet që mund të shpjegohen burimisht dhe racionalisht, duke përdorur metodën verbale, vizuele dhe praktiko-logjike, duke eliminuar përsëritjet dhe monotoninë. Ritualet islame do të mësohen si tërësi, kurse islami do të merrej si *shkollë* edhe si *xhami*. Mediumet do të merreshin më tepër me prezantimin e personaliteteve historike dhe të të arriturave kulturo-historike dikur dhe sot.

### **b. Motivimi i zhvillimit më të madh të intelektit dhe kultivimi i origjinalitetit te nxënësi**

Përbajtja e mësim-besimit tek motivohet dhe zhvillohet intelekti dhe kultivohet puna originale, krahas shkarkimit esencial mendor të nxënësit, do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin e tij intelektual. Në vecanti janë të rëndësishme metodat e mendimtarëve klasikë muslimanë - të El-Gazaliut, Ez-Zernuxhit, Ibn Maskujes etj. por edhe të Gulifordit, I. Maltzmanit etj.:

- futja e situatës jo të rëndomtë si stimulans për të cilën nuk vlejnë metodat jo të rëndomta;
- nxitja e përgjigjeve të ndryshme në situatë të njëjtë;
- nxitja e përgjigjeve jo të rëndomta si përgjigje tekstuale.

Aplikimi i kësaj metode kërkon kohë ndaj nuk mund të realizohet pa reduktimin sasior të plan-programmit mësimor. Po ashtu, kjo metodë do ta eliminonte monotoninë dhe do ta afronte nxënësin në jetësimin e islamit real.

### **c. Për ligjëruesit e mësim-besimit**

Problemi i kuadrit të mësim-besimit është shumë i madh. Realizimin e mësim-besimit do të duhej ta bënte kuadri me kualifikime superiore islame - drejtimi pedagogjik. Mirëpo, praktika dhe realiteti kosovar, por edhe përreth na tregojnë se plan-programmin e mësim-besimit e realizojnë imamët me kualifikime të mesme të gjithfarë cilësive.

Sipas mendimit tonë, zbatimin e mësim-besimit nëpër shkolla të mesme do të duhej ta realizonin kuadrat me diplomën e universitetit. kurse nëpër shkolla fillore, në mungesë të shkollave të larta islame (akademive dyvjeçare islame), atë do ta zbatonin kuadrat me diplomën e universitetit dhe vetëm në raste të rralla dhe përkohësisht të diplomuarit e medreseve, me certifikata dhe trajtime të veçanta se janë të aftë ta kryejnë këtë punë, apo studentët e aftë pas përfundimit të vitit të dytë të studimeve..

### **ç. Kontradiktat rreth futjes së lëndës “mësim-besimi” nëpër shkolla?!**

Nuk do ta shtrojmë pyetjen se a do të futet mësim-besimi nëpër shkolla, por çështjet kur do të futet, si do të quhet lënda fetare (mësim-besim, kultura fetare, kultura e religjioneve etj.), kush do ta hartojë plan-programmin, kush do ta caktojë kuadrin arsimor për këtë lëndë, janë temë kontradiktore me shumë dilema, tani për tani ende jashtë bisedave zyrtare. Ndaj Bashkësia Islame do të duhej përgatitur mirë për këtë çështje, si brenda ashtu dhe jashtë saj, në aspektin politik, medial etj..

## **d. Përbajtja e lëndës së “mësim-besimit”**

Lënda që do të ligjerohet duhet të jetë në raport me vetveten dhe me të tjerat. Me vetveten do të praktikohej një trajtim teorik teologjik me theks polemik ndaj të tjerëve, përfshirë mirëkuptimi, toleranca dhe ekumeniteti. D.m.th.: prezantimi i islamit para të tjerëve dhe i të tjerëve para muslimanëve.

### **Mësimi islam në mektebe**

Numri i nxënësve në mësim-besim në mektebe nuk është i kënaqshëm. Kjo është manifestim i pranisë së vogël të besimtarëve nëpër xhami. Si të afrohen, si të joshen dhe si të mbahen besimtarët nëpër xhami është çështje që meriton shumë kujdes, por duhet theksuar se plan-programi i mektebit duhet të ndërrohet.

#### **a. Mësimi i praktikës së jetës islame dhe domosdoshmëria e themelimit të institutit pégadogjik të Bashkësisë Islame**

Tashmë kemi theksuar se në shkollë duhet të mësohet teoria islame. Në mësim-besim, ndërkaq duhet mësuar jetën praktike islame. Përkatësisht, të gjitha çështjet që nga arsyerat objektive janë lënë nga shkolla, duhet plotësuar në mësim-besim (si p.sh. shkrim-leximi arabisht nga sufara, kiraeti i Kur'anit, texhvidi, falja e namazit, e avdesit e kështu me radhë. Nëse plan-programi i mësim-besimit në mektebe harmonizohet me atë në shkolla dhe mediume, s'do të ketë nevojë për orë të

shumta në mekteb. Kohën tjetër do të duhej shfrytëzuar për të krijuar atmosferë têrheqëse për kandidatët e tjerë potencialë. Për këtë qëllim, Bashkësia Islame duhet të mendojë seriozisht për formimin e një instituti islam e në kuadër të tij të institutit pedagogjik islam, në kuadër të Bashkësisë Islame. Kështu është edhe për çështjen e sigurimit të mjeteve finansiare, por për të duhet angazhuar ekspertët financiarë, të cilët s'ka dyshim se do të angazhoheshin për gjetjen e mënyrave për mbarëvajtjen e punëve.

### **b. Inicimi i mektebit për të rriturit**

Hapja e mësim-besimit nëpër mektebe për të rriturit është domosdoshmëri kohe. Të gjithë ata që nuk kanë mësuar për islamin dhe kanë dëshirë ta bëjnë këtë tani (mosha 15-vjeçare deri në pleqëri) mund të mësojnë në objekte të veçanta me plan-program të veçantë. Nacioni ‘i veçantë’ nënkupton hapësirën jashtë mektebit, sepse shumë njerëz, ngaqë nuk dinë gjë për islamin ‘turpërohen’. Po ashtu, mektebin disa nga ata mund ta konsiderojnë të papërshtatshëm për ‘pjekurinë’ e tyre. Ky është realiteti, ndaj duhet bërë përpjekje për kapërcimin e këtij problemi. Duhet vepruar ashtu siç veprohet me kurset e mësimit të gjuhës angleze, kursin e kompjuterëve, trajnimeve të ndryshme etj. Afrimi i të rriturve duhet të dallojë nga afrimi i të vegjelvë.

### **c. Vendet e veçanta për mësimin e islamit për të rritur**

Procesi i mësimit të të rriturve do të zhvillohej në tri shkallë:

*Shkalla fillestare* do të zhvillohej në ndonjë mjedis jashtë Bashkësisë Islame (si p.sh. në Prishtinë: Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Biblioteka Nacionale apo edhe mjedis të tjera të kësaj shkolle, kuptohet me lejen e tyre);

*Shkalla e mesme* do të realizohej në mjedisin e Medresesë, të Fakultetit Islam apo në amfiteatër të Bashkësisë Islame (nëse ekziston). Mjedisi është i afërt me xhaminë, kurse vijuesit do të ambientoheshin me traditën shpirtërore-materiale islame, me traditën islame, do të njoftohen edhe me pikat konstruktive të tesavufit, shi'izmit, selefizmit / vehabizmit dhe të traditës vendore;

*Shkalla e lartë* do të zhvillohej në xhami, ku vijuesit do të ambientoheshin tërësisht me islamin dhe vlerat e tij

### **ç. Kuadri për mësimin e të rriturve**

Kuadri do të ndahej në dy tërësi: drejtoria dhe arsimtarët. Drejtorinë do ta drejtonin pedagogët me përgatitje të lartë dhe me përvojë, të cilët do t'i caktonte Instituti Pedagogjik Islam i Bashkësisë Islame. Arsimtarë do të ishin studentët e vitit III dhe IV të Fakultetit Islam, studentë të diplomuar të Akademisë pedagogjike dyvjeçare nëse ato do të hapeshin dhe profesorë të diplomuar. Këta studentë do t'i caktonte një komision i Bashkësisë Islame apo Fakulteti Islam dhe kjo do të ishte edhe praktika e tyre, por edhe stimulimi material shumë i nevojshëm. Në këtë proces bën të inkuadrohen edhe profesorë të diplomuar të paangazhuar.

## **Mësimi islam në media**

Mediumet janë mjetet me rëndësi të madhe në përhapjen e idesë. Me zhvillimin e teknologjisë u krijuan disa lloje mediumesh. Një herë për një herë televizioni dhe gazeta janë me ndikim më të madh. Sa i përket radios dhe internetit, këta nuk e kanë fuqinë e TV-së, e para sepse dëgjohet pak, kurse i dyti sepse te ne ende nuk ka rrjetë të gjerë dhe përdorim të madh të internetit.

### **a. Mediumet botuese**

1. Prezantimi i islamit në pajtim me doktrinën redaktuese të shkollës së mendimit që ndjek revista në vetvete dhe në kufizimin e lexuesve. Ekskluziviteti doktrinar dhe grupimi ideor e pengon lexuesin të fitojë një pasqyrë reale për islamin.

2. Mungesa e teksteve bashkëkohore cilësore dhe origjinale ka krijuar te lexuesi indiferencë.

3. Mungesa e mjeteve materiale-teknike por edhe mangësitë profesionale të autorëve, gazetarëve dhe redaktorëve.

Këto dhe mangësi të tjera krijojnë te lexuesi ‘vakuum informativo-edukues’ që ndikon shumë në gjendjen e përgjithshme të besimtarëve.

### **b. Radioja dhe televizioni**

Të gjitha shpresat se në Kosovë do të kemi RTV me interes të mirëfilltë për popullin po zbehen dhe po treten. Qendrat e ndikimit po hapin RTV të transmetimit

tokësor dhe satelitor për qëllimet e tyre ideologjike dhe komerciale. Islami si fe, besim dhe traditë shumëshekullore nuk është i pranishëm në to. Për të flitet nga këndi i terrorizmit, jotorancës, thjeshtë nga këndi i politikës së imponuar ditore, respektivisht islami në to prezantohet me konotacion negativ.

### **c. Vebi**

Veb prezantimi i islamit në gjuhën shqipe është tejet i vogël dhe tejet joprofesional. Edhe ai ndjek rrugën e publikimeve, d.m.th. ndjek rrugën e donatorit, duke kriuar rrëmujë doktrinare në përpjekjet kundër vlerave vendore islame.

Po ashtu, vebi kërkon aftësi, qartësi, shpjetësi, fluks idesh, dinamikë, përmasa, çiltëri etj. Disa gabime që ndodhin në mediumet e shkruara, nuk guxojnë të ndodhin.

Në anën tjeter, interneti në Kosovë ende është luks, sepse ekzistojnë disa Club, Caffe-internete me çmime jo të ulëta për shtresën e lartë. Rrjeti i lirë ende nuk ekziston, ndaj populli nuk ka para dhe nuk është i arsimuar të shfrytëzojë dhe të realizojë materiale të nevojshme.

### **ç. Përbajtja e përhapjes së mësimit islam nëpërmjet mediumeve**

Për prezantimin e përbajtjes së mësimit islam në media duhet të formohet një organ koordinativ-këshiillues, i cili do të përcaktonte përbajtjen, përparësinë dhe përhapjen e përbajtjes. Gazetarët do të njiheshin përmes kursesh me bazat e gazetarisë dhe të pedagogjisë

së mediumeve. Ky organ do të ndihmon te gjitha mediumet islame me materiale, këshilla etj. Në këtë përbajtje do të gjente vend: historia islame e botës dhe ajo islame vendore, kultura dhe civilizimi islam, lajmet mbi gjendjen, problemet, kërkesat dhe nevojat e muslumanëve në gjithë botën. Kjo do të realizohej me emisione të tipit popullor: kuize, seri popullore, lojëra me shpërblime, filma dokumentarë dhe artistikë etj.

## Fjala përfundimtare

Sendërtimit të projekteve për përhapjen e diturive islame duhet t'u vihen të gjithë: teologët, jursitët, ekonomistët. Studimet pasdisplomike duhet orientuar në të gjitha drejtimet me përparësi në: teologji, ekonomi, jurisprudencë, kulturë, histori, filozofi etj. Disa kushte ekzistojnë: objektet e medreseve, zyrat e këshillave të BI, por edhe ato shoqërore. Kemi edhe një pjesë të kuadrit. Pra, të fillojmë të mendojmë për ardhmërinë duke bashkuar mendimet dhe veprimet.<sup>316</sup>

---

<sup>316</sup> (Konsultimet kryesore për këtë shkrim janë bërë nga teksti i botuar në revistën boshnjake “Novi Mual-lim”, nr. 9/2002 në fq. 58-67, të autorit S. Beglerović).

## Literatura

Abduhu, Muhammed, *El-Kur'anu'l-hakim*, libri III, Sarajevë, 1932.

Ajvazoglu, Beshir, *Islamska estetika*, Shkup, 2002.

Al-Attas, *Islam and Secularism*, Kuala Lumpur, Malajzi, botimi II, 1993. (Al-Attas, Syed Muhammed al-Naqib, *Islam and Secularism'* (Islami dhe shekullarizmi), Kuala-Lumpur, 1978).

Al-Gazali, Ebu-Hamid Muhammed, *Znamenja u All-llahovim stvorenjima*, botimi II, Sarajevë, 2001.

Amin, Sayed Hassan, *Praimi sistemi srednjeg vijeka*, Sarajevë, 1998.

Amini, Ibrahim, *Etika bashkëshortore*, Tetovë, 2000.

Argumenti - časopis za društvenu teoriju i praksu, 2/1982, Rijeka.

Arnold, Thomas W., *The Preaching of Islam*, Third Reprint, Lahore, Pakistan, May 1968 (sipas botimit të vitit 1913).

Asad, Muhammed, *Islami në udhëkryq*, Prizren, 2002.

Asad, Muhammed, *Ruga për në Mekë*, Shkup, 2003.

Babinger, Franc, *Mehmet Pushtuesi dbe koha e tij*, Prishtinë, 1989.

Barleti, Marin, *Histori e Skënderbeut*, Prishtinë, 1982.

Baxhi, Hasan, *Dialogu, Kristiani dbe Muslimani*, Tiranë, 1993.

*Behar – List za pouku i zabaru*, 1902 – 1903, Sarajevo.

Behluli, Demir, *Arabeska origjinale në xhami të Kosovës Lindore*, Gjilan, 1995.

- Besëlidhja e Re*, Zagreb – Ferizaj, 1980.
- Bogdani, Pjetër, *Çeta e Profetëve*, I, Prishtinë, 1990.
- Bouhdiba, Abd Al-Wahab, *Seksualiteti në islam*, Gjilan, 2001.
- Bucaille, Maurice, *Biblja, Kur'an i Nauka*, botimi II, Sarajevë, 2002.
- Bulaç, Ali, *Islam i demokracija, teokracija i totalitarizam*, Sarajevë-Lubjanë, 1995.
- Bulaç, Ali, *Islami dhe demokracia, teokracia dhe totalitarizmi*, Shkup, 1998.
- Carlyle, Thomas, *Heroi si profet, Muhammedi dhe Islami*, Durrës, 1935.
- Corbin, Henry, *Historia e filozofisë islame*, I-II, Shkup, 1998.
- Çengiq, Hasan, *Temat islame*, Shkup, 1413/1993.
- Davutoglu, Ahmet, *Vetëperceptimet e qytetërimeve*, Prishtinë, 2002.
- Delo* – revistë mujore për teori, kritikë dhe poezi, Beograd, 7/ 1978.
- Dikën, Sejid Muhammed, *Studime mbi historinë e shtetit osman*, Shkup, 1413/1994.
- Dirkem, Emil, *Elementarni oblici religioznog života*, Beograd, 1982.
- Dituria islame* - revistë fetare, kulturore, shkencore, nr. 85/1996, Prishtinë.
- Duhovnost i mentalno zdravje*, grup autorësh, Sarajevë, 2002.
- Dozo, Husein, *Fetve – Pitanja i odgovori*, Novi Pazar, 1996.
- Dozo, Husein, *Prijevod Kur'ana s komentarom*, I, Sarajevë, 1966.
- Dzait, Hisam, *Europa i islam*, botimi II i plotësuar, Sarajevë, 1989.
- El-Amri, Es-Sejid Xhelaluddin, *El-Emru bi'l-ma'rufi ve'n-nehji ani'l-munker*, Bejrut, 1404/1984.

El-Amri, Es-Sejid Xhelaluddin, *El-Emru bi'l-ma'rufi ve'n-nehji ani'l-munker*, Bejrut, 1404/1984.

El-Behij, Muhammed *Imani – besimi në All-labun xh. sh.*, Botimi II, Prizren, 2000/1421.

El-Buhariu, *Sahibu-l-buharij, pa vend dbe vit botimi.*

El-Dzevzi, Ibn-Kajim, *Poslanikova medicina*, Sarajevë, 2001/1422 h.g.

El-Ehwani, Ahmed F., *Filozofia islamë*, Prizren, 2002.

El-Fahuri, Hana & El-Xherr, Halil, *Tarib'ul-felsefet'il-arabijeti*, I-II, botimi II, Bejrut, 1992.

El-Gazali, Esh-Shejh Muhammed, *Besimi musliman*, Shkup, 2001.

El-Gazali, Esh-Shejh Muhammed, *Tematski tefsir Kur'anskib sura*, Sarajevë, 1414/2003

El-Gazaliu, Shejh Muhammed, *Besimi i muslimanit*, Shkup, 1422 / 2001.

El-Kardavi, Jusuf, *Sabur*, Konjić, 2000.

El-Kardavi, Jusuf, *Surremene fetve (Izbor)*, Tuzla, 1997.

*El-Kur'an – Kur'ani dbe bija e tij shqip*, Përkthimi i F. Mehdiut, Shkup /Stamboll, 1999.

El-Muslimi, *Sahib'ul-muslim*.

En-Neveviu, Imam, *Rijadu's-salihin*, Shkup, 1998.

Engdahl, F. William, *Stoljeće rata – Anglo-američka naftna politika i novi sijetski poredak*, Zagreb, 2000.

En-Nesefij, Ebu Hafs Umer, *Besimi islam sipas Imam en-Nesefiut*, Prizren, 2003.

En-Neveviu, Imam, *Dyzet hadithe dbe shtojca e Ibni Rexhebit*, Shkup, 1413/1992.

En-Nexhxhar, Abdu'l-vehhab, *Kasas'ul-enbijai*, botimi III, Bejrut, pa vit botimi.

Escarpit, Robert, *Revolucija knjige*, Zagreb, 1972.

Esfak, Husein, *Suština islama – komentar Fatibe*, botimi II, Sarajevë, 1986.

Esh-Shafi'iij, Ebu Tahir Muhammed ibn Ja'kub El-Fejruz Abadi, *El-Kur'an'ul-kerim ve bishamishihi Tenvir'ul-*

*mikbasi min tefsiri ibn Abbasi*, botimi I, Bejrut, Lubnan, 1409 h./1988.

Esposito, John L., *Islamska prijetnja mit ili stvarnost*, Živinice, 2001.

Et-Tabatabai, El-Al-lameh Es-Sejid Muhammed Husejn, *El-Mizanu fi tefsir'il-Kur'an*, pjesa I, botimi III, pa vend botimi, 1393 h. / 1973.

Fanoni, Franc, *Të mallkuarit e botës*, Prishtinë, 1984.

Feraj, Hysamendin, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, Shkup, 1999.

Filipovič, Muhammed, *Islam i teror*, Sarajevë, 1423 / 2002.

Frashëri, Sami, *Përhapja e islamiçmit*, Prizren, 1411 / 1990

Frejzer, Xhorxh, *Zlatna grana*, Beograd.

Gams, Andrija, *Biblija i društvo*, Novi Sad, 1979.

Garaudy, Roger, *Mitorr utemeljitelji izraelske politike*, Zagreb, 1998.

Garodi, Rože, *Živi islam*, Sarajevë, 1990.

Garodi, Rozhe, *Islami dhe kultura - Dialogu i Rozhe Garodit me mendimtarët muslimanë*, Sarajevë, 1411/1991.

Gjozo, Husein, *Islami në kohë*, Shkup, 1993.

*Glas islama*, nr. 70, shtator dhe 71 tetor/ 2002/1423, Novi Pazar.

*Glasnik VIS-a*, në RSFJ, nr. 3/1982, Sarajevë.

*Glasnik VIS-a*, në RSFJ, nr. 4/1990, Sarajevë.

Grup autorësh, *Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu*, Sarajevë, 1987.

Grup autorësh, *Barbaria serbe mbi monumentet islame në Kosovë*, Prishtinë, 2000.

Grup autorësh, *Dijalog islamskikh i evropskikh učenjaka*, Sarajevë, 1979.

Grup autorësh, *Dosja Kuds*, Shkup, 1424/2003.

Grup autorësh, *O arapsko-islamskoj kulturi*, Prilozi za Orientalnu Filologiju, Sarajevë, 1976.

- Grup autorësh, *Svijet islama*, Beograd, 1978.
- Hafizović, Rešid, *Muslimani u dijalogu s drugima i sa sobom - Svetopovijesne i hijeropovijesne paradigmе*, Sarajevë, 1423/2002.
- Hafizović, Rešid, *O načelima islamske vjere*, Zenicë, 1996.
- Hamidull-llah, Muhammed, *Muhammed a.s. – život i djelo*, I-II, botimi II i plotesar, Sarajevë, 1983.
- Hamer, Joseph von, *Historija Turskog / Osmanskog / Cartsia*, I - III, Zagreb, 1979.
- Handžić, Mehmed, *Izabrana djela*, VI, Sarajevo, 1999, fq. 23.
- Hejkel, Muhammed Husejn, *Hajatu Muhammed*, botimi XIV, Kairo, 1977.
- Hersh, Zhane, *Habia filozofike – Një ide e filozofisë*, Tiranë, (-).
- Hiti, Filip, *Istoriya Arapa od najstarijih vremena do danas*, botimi II fototip, Sarajevo, 1988.
- Hivzi Muharremi, *Pasqyrë e shkurtër e historisë së artit*, Prishtinë, 1984.
- Hosein, Imran N., *Jerusalim u Kur'anu*, Sarajevë, 2003.
- Hysa, Mahmud, *Alamiada shqiptare*, I-II, Shkup, 2000.
- Ibn Hazmi, *Shërimi i shpirtrave*, Prizren, 2001.
- Ibn Kethir, Hafiz, *Kazivanja o vjeroijesnicima*, Zenicë, 1420/1999.
- Ibn Kethir, *Tefsir Ibn Kesir*, version i shkurtuar, botimi I, Sarajevë, 2000/1420.
- Ibrahim, Abdul Fadl Muhsin, *Biomedicina – islamski pogledi*, Sarajevë, 2001/1422 h.
- Ibrahimi, Nexhat, *Dimensione kur'anore*, Shkup, 2003.
- Ibrahimi, Nexhat, *Islami dhe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar (shekujt IX-XIV)*, Shkup, 2003/1424.
- Ibrahimi, Nexhat, *Islami kërcënues i botës – shpifje apo realitet, në përgatitje për botim*.

Ibrahimi, Nexhat, *Islami në Ballkan para shekullit XV*, botimi II, Prizren. (Ibrahimi, Nexhat, *Kontaktet e para të islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane*, Shkup, 1997.)

Ibrahimi, Nexhat, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, Shkup, 1998.

Ibrahimi, Nexhat, *Shkolla juridike hanefite dhe karakteristikat themelore të doktrinës së saj*, Shkup, 1998.

Ibrahimi, Nexhat, *Suzi prizrenasi – dijetar dhe bamirës i shek. XV- XVI*, Prizren, 1990/1411.

Ihsanoglu, Ekmeleldin, *Zapad i Islam ka dijalogu*, Sarajevë, 2001.

Ikbal, Muhammed, *Obnova vjerske misli u islamu*, botimi II i plotësuar dhe i ndryshuar, Sarajevë, 2000.

*Imam El-Maturidiu – Jeta, vepra dhe mësimi*, Prishtinë, 2003.

Imam En-Neveviu, *Dyzet hadithe dhe shtojca e Ibni Rexhebit*, Shkup, 1413/1992.

Imam En-Neveviu, *Rijad'us-salihin*, botimi II, Shkup, 1418/1998.

Inalxhik, Halil, *Perandoria Osmane*, Gjilan, 2001.

*Islamska misao*, revistë, nr. 88 – 89, Sarajevo, 1986.

*Islamski stijet danas*, Zbornik rada V medjunarodnog islamskog simpozija 1416/1995, Zagreb, 1995.

*Izbor poslanikovih hadisa*, përgatiti Jakup Memić, Sarajevë, 1985.

Izetbegoviq, Alija, *Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*, Prizren, 1990.

Izetbegović, Alija, *Islam izmedju Istoka i Zapada*, Beograd, 1989.

Janc, Zagorka, *Islamska minijatura*, Beograd – Zagreb – Mostar, 1985.

Jaspers, Karl, *Filosofija egzistencije*, Beograd, 1973.

*Jeta* nr. 10, shtojcë e Zërit të dt. 30.11.1996, Prishtinë.

- Kahteran, Nevad, *Perenijalna filozofija (Sophia Perennis)*, Sarajevë, 2002, fq. 320.
- Kalajić, Dragoš, *Smak sveta*, Beograd, 1979.
- Kaleshi, Hasan, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islamë*, bot II, Rijad, 1991/1412.
- Karahodžić, Mehmed, *Jerusalim – Bejtul-Makdis*, Visokë, Bosnjë, 2002.
- Karcić, Fikret – Karić, Enes (ed.), *Šerijatsko pravo u sаrremenim društima*, Sarajevë, 1998.
- Karcić, Fikret, *Društveno pravni aspekti islamskog reformizma*, Sarajevë, 1990.
- Karcić, Fikret, *Muslimani Balkana – Istočno pitanje u XX vijeku*, Tuzla, 2001.
- Karić, Enes, (ed.), *Kur'an u sаrremenom dobu*, I, Sarajevo, 1991.
- Karić, Enes, *Kur'an u sаrremenom dobu*, II, Sarajevë, 1997.
- Karić, Enes, *Semantika Kur'ana*, Sarajevë, 1998.
- Krasniqi, Milazim, *Fotografitë e kujtimeve*, Prishtinë, 2002.
- Kutub, Sejid, *Islami - fe e ardhmërisë*, Shkup, 1993 / 1413.
- Kutub, Sejid, *Kjo fe*, Shkup, 1414/1993.
- Lacaj, Henrik – Fishta, Filip, *Fjalor latinisht – shqip*, Prishtinë, 1980.
- Laost, Henry, *Raskoli u islamu*, Zagreb, 1989.
- Lari, Sayid Mujtaba Rukni Musawi, *Islam i západna civilizacija*, Sarajevë, 1998.
- Lewis, Bernard (ed.), *Svijet islama – vjera, narodi, kultura*, Beograd, 1979.
- Lings, Martin, *Drevna vjerovanja i moderna suvjetovanja*, Sarajevë, 1997.
- Mahmud Seid, Muhammed, *Islami dënon diskriminimin racor*, Shkup, 1994/1415.
- Makiaveli, Nikolla, *Sundimtari*, Prishtinë, 1977.

Maknoon, Al-Haj Mekaeel, *The Universal Significance of Adam*, Londër, pa vit botimi.

Mastnak, Tomazh, *Zoti i blasfemuar dhe demokracia perëndimore*, Prizren, 2001.

*Medical and Health Encyclopedia*, New York, (1978 ?).

Mejerović, Eva de Vitrej, *Antologija sufijskih tekstova*, Zagreb, 1990.

Mudevver, Taha, *Andaluzia dhe Perandoria Osmane*, Shkup, 1995/1415.

Muftić, Tewfik, *Arapsko - bosnaski rječnik*, I, Sarajevo, 1973.

Muhidin Ahmeti, *Përbledhje ligjëratash fetare*, Shkodër, 1417/1996

Muminović, Rasim, *Filozofija ideologije*, I-II, Sarajevë, 1421/2000.

Murtezai, Ekrem, *Fjalor i feve*, Prish-tinë, 2000.

*Naputak u nastavi filozofije*, Zagreb, (-).

Nasr, Sejid Husein, *Islami dhe brenga e njeriut modern*, Shkup, 2000 / 1421.

Nasr, Sejid Husein, *Srce islama*, Sarajevë, 1423/2002.

Nasr, Sejid Husein, *Susret čovjeka i prirode*, Sarajevë, 2001 / 1422.

Nasr, Sejid Husein, *Tradicionalni islam u modernom svijetu*, Sarajevë, 1994.

Nasr, Sejid Husein, *Vodič mladom muslimanu*, Sarajevë, 1998.

Nikolov, Nikola M., *Komploti botëror*, botimi IV, Tetovë, 2003.

*Novi Muallim* – časopis za odgoj i obrazovanje, nr. 9/2002, Sarajevë.

*Novi Mual-lim* – revistë për edukim dhe arsimim, nr. 6/2001, Sarajevë.

*Nur* - revistë për kulturë dhe tema islame, Beograd, 1/1991.

*Nur* – revistë për kulturë dhe tema islame, Beograd, 2/1992.

*Nur* – časopis za kulturu i islamske teme, nr. 11/1996, Beograd.

*Nur* – časopis za kulturu i islamske teme, nr. 12/1997, Beograd.

Nuri-Hadžić, Osman, *Muhamed a.s. i Kur'an - Osirt na Istoriju islamske kulture*, botimi III, Sarajevo, 1986.

Omerdić, Muharem, *Prilozi izučavanju genocida nad bošnjacima (1912-1995)*, Sarajevë, 1999.

Ozel, Ismet, *Shkenca, teknika dhe tēhuajësimi*, Shkup,

Pantić, Miroslav, *Humanizam i renesansa*, Cetinje, 1967.

Pavicević, Vuko, *Sociologija religije sa elementima filozofije religije*, botimi II, Beograd, 1980.

*Perla* - revistë shkencore-kulturore tremujore, 1/1996, Tiranë.

Pirraku, Muhamet, *Jo katedrale – në emër të shqiptarisë së imajinuar*, Prishtinë, 2003.

Pirraku, Muhamet, *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, Prishtinë, 1989.

*Pravna enciklopedija*, 1, Beograd, 1989.

*Prijevod Kur'ana sa tefsiron i komentarom na bosanskom jeziku*, 1, München, 2001. (fq. 3)

Prilozi o orientalnoj filologiji, (*O arapsko-islamskoj kulturi*), Sarajevë, 1976.

Qureshi, Sultan Ahmed, *Letters of the Holy Prophet*, (Lahore, Pakistan,).

Qutb, Sayyid, *U okrilju Kur'ana*, 1, Sarajevë, 1996. (fq. 19-20).

Rahman, Fazlur, *Duh islama*, Beograd, 1983.

Ramadan, Tarik, *Biti evropski musliman*, Sarajevë, 2002.

Ramadani, Naser, *Bioetika – Qasjet etike në mjekësinë moderne*, Prishtinë, 2002.

Redić, Husref, *Islamska umjetnost*, Beograd – Zagreb – Mostar, 1982.

- Said, Edward, *Orijentalizam*, Sarajevë, 1999.
- Saliba, Xhemil, *El-Mu'xhem'ul-felsefij*, I, Bejrut, 1414 / 1994.
- Salihu, Hajdar, *Poëzja e bejtexhinje*, Prishtinë, 1987.
- Schimel, Anemarie, *Odgonetanje Božjih znakova - Fenomenološki pristup islamu*, Sarajevë, 2001.
- Schuon, Frithjof, (Isa Nuruddin), *Dimenzije Islama*, Sarajevë, 1996.
- Sehibrahimbegović, Ismet U., *Snagom vjere do savršenstva duše*, Sarajevë, 1984.
- Selam* - revija za kulturu, vjeru i nauku, 6/1996, Prizren.
- Si ta njohim artin islam*, Prishtinë, 2000.
- Silajdić, Adnan, *40 Hadisa s tumačenjem*, Zenicë, pa viti botimi.
- Silajdić, Adnan, *Filosofjska teologija Abu al-Hasana al-As'arija*, Sarajevë, 1999.
- Silajdić, Haris, *Albanski nacionalni pokret*, Sarajevë, 1995.
- Smailagić, Nerkez, *Klasična kultura islama*, I, Zagreb, 1973.
- Smailagić, Nerkez, *Klasična kultura islama*, II, Zagreb, 1976.
- Smailagić, Nerkez, *Leksikon islama*, Sarajevo, 1990.
- Smajloviq, Ahmed, *Felsefet'ul-istishrak we etheruha fi 'l-edeb 'il-arabij 'il-measir*, Kairo, 1980.
- Spengler, Osvald, *Propast Zapada*, I-IV, botimi II, Beograd, 1990.
- Stipçeviq, Aleksandër, *Historia e librit*, Prishtinë, 1988.
- Stumpf, Samuel Enoch, *Filosofia – Historia & Problemet*, Tiranë, (-).
- Sufizam*, përgatiti I. Shop dhe D. Tanasković, Beograd, 1980.
- Supek, Rudi, *Ovajedina zemlja*, Zagreb, 1978.

Sharif, M. M., *Historija islamske filozofije*, I-II, Zagreb, 1988.

Sharif, M. M., *Historija islamske filozofije*, I-II, Zagreb, 1988.

Shelebij, Ahmed, *Mensuatu't-tarib'il-islamij*, vëllimi V, botimi IV, Kairo, 1979.

Sheriati, Ali, *Fatimeja është Fatime*, Tetovë, 1996.

Sheriati, Ali, *Kultura dhe ideologja*, Tetovë 1992.

Sheriati, Ali, *Njeriu dhe feja*, Tetovë, 1990.

Sheriati, Ali, *Njeriu dhe Islami*, Tetovë, 1991.

*Shkrimi i shenjtë*, përkthimi sipas: S. Filipaj, Ferizaj, 1994.

Shukrić, Nijaz, *Povijest islamske kulture i civilizacije*, Sarajevë, 1989.

*Takvim 1400 h.*, Sarajevo, 1980.

*Takvim 1423-1424 / Kalendar 2003*, Prishtinë, 2002.

Tanahil, Rej, *Čovek i seks*, Beograd, 1981.

*Tejsiru 'l-mesir ila ehadithi 'l-Xhami'i 's-sagir*, Përgatiti Salih Indžić, Travnik, 2001.

Testas, G. i J., *Inkrizacija*, Zagreb, 1982

*The Glorious Kur'an*, Translation and Comentary by Abdull-llah Jusuf Ali, Lubya, 1393 h./1973.

Toma, Luj-Vensan, *Antropologija smrti*, I-II, Beograd, 1980.

Toynbi, Arnold, *Istraživanja istorije*, Beograd, I - 1970, II – 1971.

Veljacić, Čedomil, *Razmedja azijskib filozofija*, I-II, Zagreb, 1978.

Vujaklija, Milan, *Leksikon stranih reči i izraza*, Beograd, 1980.

[www.balkantimes.com](http://www.balkantimes.com) (BalkanTimes).

[www.balkantimes.com](http://www.balkantimes.com) (Qentë e Bukureshtit mund të marrin frymë ndërsa Bardo vjen në qytet).

[www.crescentlife.com](http://www.crescentlife.com), (Mustafa Mahmud, Qur'anic Psychology).

[www.crescentlife.com](http://www.crescentlife.com), (Shahid Athar M. D., Modern Stres And Its Cure From Qur'an).

[www.ffzg.hr](http://www.ffzg.hr) (Donat Math, *Eutanazija*).

[www.ftidi.hr](http://www.ftidi.hr) (Valentin Pozaić, *Eutanazija* pred zakonom).

[www.hbk.hr](http://www.hbk.hr) (Ljubi bližnjega svoga kao samoga sebe).

[www.hbk.hr / katekizam](http://www.hbk.hr/katekizam).

[www.healthbosnia.com](http://www.healthbosnia.com) (Esmina Avdibegović, Osman Sinanović, Religijsko-etičko-pravni pogled na ljekarsku pomoć u samoubistvu i *eutanaziji*).

[www.horizonti.com](http://www.horizonti.com) (Revista elektronike – Horizonti, Shahid Athar, Euthanasia – Vdekja e Ndihamuar nga Mjeku.)

[www.islamnet.com](http://www.islamnet.com), (Ayhan Songar, (Turqī), Social-Psychiatric Institutions in Old Turks Under Islamic Tradition).

[www.islamnet.com](http://www.islamnet.com), (Mohamad Osman Najaty, Kuwait, The Concept of Mental Helth in the Holy Qur'an and the Hadeeth).

[www.prolife.sk](http://www.prolife.sk) (Veronika Lagova, Dobra smrt).

[www.rcc.sk](http://www.rcc.sk) (Holandsko a eutanazia).

[www.rytier.sk](http://www.rytier.sk) (Mudr. Stefan Grenda, Eutanazia je utok na život človeka).

[www.vaticanradio.org](http://www.vaticanradio.org). (Vijesti).

[www.xs4all.nl](http://www.xs4all.nl), (Vreme pravo (?) za ljudsko pravo 04.10.2002).

Nexhat S. Ibrahimini

LOGOS-A ■ ISLAMI DHE KRIZA E IDENTITETIT



ISBN 998958089-8



9 789989 580895